

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI XI (XXV) 2023, NR. 36 (189)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2023

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI XI (XXV), janar - qershor 2023 nr. 36 (189)

Nën kujdesin e: H. Bujar Spahiu

Drejtor: Dorian Demetja

Kryeredaktor: Andrin Rasha

Bordi editorial: Prof. Dr. Gjergj Sinani, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi, Universiteti Bedër
Dr. Skender Bruçaj, Universiteti Bedër
Dr. Brikena Smajli, Universiteti Bedër
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë
PHD. Cand. Elton Karaj, Universiteti Bedër
H. Jusuf Zimeri, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë së Veriut
MA. Ramadan Shkodra, Bashkësia Islame e Kosovës

Redaktor: Andrin Rasha
Mehmet Disha

Në anglisht: Redaksia

Bordi shkencor: Prof. Dr. Ayhan Tekines, Austri
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë
Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë
Prof. Dr. Sadije Bushati
Prof. Asc. Dr. Saimir Shatku, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Prof. Asoc. Tidita Abdurrahmani, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë
Prof. Asoc. Dr. Majlinda Peza-Perriu, Universiteti “Al. Xhuvani”, Elbasan
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti i Tiranës
Dr. Ana Uka, Universiteti Bedër
Dr. Agron Tufa, Zvicër
Dr. Ardian Muhaj, Instituti i Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike
Dr. Atakan Derelioglu, SHBA
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër
Dr. Ilirjana Kaceli, Universiteti Bedër
Dr. Matilda Likaj, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Dr. Xhemal Seferti, Universiteti Bedër
PhD. Cand. Ali Zaimi, Universiteti Bedër
PHD. Cand. Hysni Skura, Universiteti Bedër
MS/MA Fatos Kopliku, Washington DC, SHBA
MA. Sabri Bajgora, Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame, Prishtinë
Msc. Lorela Shehu, Universiteti Florida
H. Resul Rexhepi, Prishtinë
Xhemal Balla, Tiranë

Fushat: Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi / Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

Realizimi grafik: Erzen Carja

Fotoja në kopertinë: Xhamia e Sulejman Pashës, Tiranë, 1938

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Rr. “George W. Bush”, Nr. 50, Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zaninalte.al

Web: www.zaninalte.al

Përmbajtja

Editorial

1. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 100 vjet në dritën e dëshmime historike,
H. Bujar Spahiu 07

Shkenca Islame

2. Mesatarja kur'anore shërim i ekstremizmit, **Prof. dr. Hajredin Hoxha** .. 09

Kur'ani dhe Shkenca

3. El-Kurtubiu – Mufessir i njohur andaluzian, **Kurra hfz. doc. dr. Xhevad Shoshiq** 30

Studime

4. 100 vjet nga Themelimi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, **Dorian Demetja, Drejtorja e Kulturës, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë** 40

Shkenca Sociale

5. **Personat në moshë të shtyrë**. Rëndësia e pjesëmarrjes nëpër sisteme shoqërore - trajtuar nga pikëpamja e punëve sociale, **Skender Mustafi, bsc.**

Punët Sociale	55
6. Fëmijët dhe të drejtat e tyre, Mr. sc. Bahri Curri	70

Jurisprudencë

7. Zhvillimi juridik i së drejtës së pronësisë së Institucioneve Fetare në Shqipëri, Prof. asc. dr. Saimir Shatku, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës	81
--	----

Përkthime

8. Jeta e Ebu Mensur El-Maturidiut dhe konteksti socio-politik dhe teologjik në Azinë Qendrore në shekullin X – Pjesa e dytë, Aref Chaker	92
--	----

Personalitete

9. Haxhi Vehbi Dibra (Agolli)	109
--	-----

Retrospektivë

10. Njeriu dhe Gjithsia II	116
----------------------------------	-----

Abstracts in English	126
-----------------------------------	-----

Rregullat e shkrimit	132
-----------------------------------	-----



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë 100 vjet në dritën e dëshmime historike

H. Bujar Spahiu

Pavarësia e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë është ndër aktet më të rëndësishme kombëtare, pas pavarësisë së Shqipërisë. Kleri mysliman, në përgjithësi, por edhe dijetarë e hoxhallarë të spikatur, kanë rolin e tyre vendimtar në Pavarësinë e Shqipërisë. Në këtë vazhdë ata nuk u ndalën vetëm me pavarësimin e vendit, por, më 24 shkurt të vitit 1923, nisën rrugën e pakthyeshme për mëvetësinë e Komunitetit Mysliman.

Dijetarët myslimanë, të tillë si Daut efendi Boriçi, H. Ymer Prizreni, së bashku me bashkëkombës të tjerë, u prinë proceseve të tilla kohë më parë, qysh me kuvendin e Lidhjes së Prizrenit në xhaminë Bajrakli dhe Medresenë e Mehmet Pashës, që sot njihet si muzeu i Lidhjes së Prizrenit.

Pra, në çdo moment historik që i ka kontribuar pavarësisë, shtetformimit dhe konsolidimit të shtetit shqiptar, prijësit e Fesë Islame kanë qenë aty dhe kanë dhënë kontribut domethënës e definitiv në momente të caktuara.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është themeluar nga rilindës dhe firmëtarë të pavarësisë 100 vjet më parë, si një bashkësi që do të përfaqësonte zërin e besimtarëve myslimanë në Shqipëri, trojet shqiptare, madje, në mjaft raste, edhe zërin e mbarë shqiptarëve. Në këtë libër përkujtimor do të gjeni mjaftueshëm fakte dhe dokumente autentike, të cilat tregojnë se ky institucion është vazhdimësia e institucioneve islame, që ekzistonin prej shekujsh në vendin tonë nëpërmjet myftinive, trupave

gjyqësore të sheriatit me kadinjtë e famshëm, medreseve dhe mejtepeve, të shtrira pothuajse në çdo hapësirë shqiptare.

Në këtë shekull plot sfida, Komuniteti Mysliman i ka shërbyer Fesë Islame me besnikëri, përkushtim e devocion të lartë dhe, me po të njëjtën përkujdesje, i ka shërbyer kombit dhe çështjes kombëtare në tërësi. Ndërkohë, nga dijetari i madh H. Vehbi Dibra e deri në ditët e sotme, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka dhënë dhe jep një kontribut të paçmuar edhe për harmoninë fetare në Shqipëri.

Një kontribut tejtejetik për Fenë Islame dhe shoqërinë shqiptare në

tërësi, Komuniteti Mysliman ka dhënë edhe në fushën e arsimit e kulturës. Revistat kulturore e shkencore, institucionet arsimore si medresetë, hapja e Universitetit BEDËR, jeta edukative nëpër xhamitë e vendit, kanë qenë elementët bazë mbi të cilët, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, ka shtruar rrugëtimin e tij të suksesshëm në 100 vite.

Është nder dhe privilegj i jashtëzakonshëm për mua, si kryetari i 10-të i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, t'i shërbej fesë sime të bukur, besimtarëve dhe kombit tim në një moment të tillë historik, siç është 100-vjetori i pavarësisë së KMSH-së.

Mesatarja kur'anore shërim i ekstremizmit

Prof. Dr. Hfz. Hajredin Hoxha

Abstrakt

Tekstet kur'anore dhe ato profetike kanë shpjelluar në forma dhe mënyra të ndryshme çështjen e përqafimit dhe praktikimit të parimit të 'mesatares' dhe manifestimeve të saj në Kur'an dhe Sunet. Umeti pohon njëzëri detyrimin e rrokjes së mesatares në çështjet fetare. Një grup njerëzish, me bindjen se janë duke vepruar drejt, lajthitën dhe humbën për shkak të devijimit nga mesatarja dhe të kapurit pas saj.

Islami, feja jonë, është fe e paqes dhe sigurisë, është fe e jetës, fe e zhvillimit dhe kulturës. Kjo fe ka ardhur për të mirën e njerëzve në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe assesi nuk është fe e vdekjes, vrasjes, shkatërrimit, frikësimit e shqetësimit. Ky është sekreti i Islamit në luftën e tij kundër radikalizmit dhe ekstremizmit me mjete dhe metodologji të ndryshme. Bazuar në këtë të vërtetë historike, Islami na fton që t'i kthehemi mesatares, maturisë, t'i kthehemi bazave genësore për ne, Kur'anit dhe Sunetit, në mënyrë që ilaçin shërues ta marrim pikërisht aty, e kështu të realizojmë unitetin ideor, shoqëror dhe fetar të umetit.

Dijetarët kompetentë të këtij umeti, në të kaluarën dhe të tashmen, kanë konstatuar njëzëri se objektivat e legjislacionit të fesë sonë janë vënë për të ruajtur jetën njerëzore dhe gjërat nga të cilat varet ajo. Këto objektiva janë: ruajtja e fesë, qenies (trupit), mendjes, nderit e pasurisë, dhe si të tilla janë të shenjta, prandaj askush nuk ka të drejtë të cenojë shenjtërinë e tyre. Në fjalorin e dijetarëve të mëdhenj këto pesë objektiva njihen si "pesë gjërat e domosdoshme (ed-darurat el hams apo el kul-lijjat el hams.)"

Ky studim mëton të gjejë përgjigjen për pyetjet në vijim:

- 1. Ç'pozitë ka mesatarja dhe maturia në Islam?*
- 2. Cilat janë manifestimet e mesatares Kur'an dhe Sunet?*
- 3. Çfarë na flasin tekstet kur'anore dhe ato profetike për mesataren?*
- 4. Me ç'pasojë mund të përballë individit dhe shoqëria në rast të anashkalimit eventual të parimit të mesatares dhe maturisë?*
- 5. Si dilet nga kriza e ekstremizmit?*

Allahu i Madhëruar, në Kur'anin Fisnik, thotë: **“Ruajuni nga e keqja (nga dënimi) që nuk i godet vetëm ata që bënë mizori prej jush, (por edhe të mirët), dhe ta dini se Allahu është ndëshkues i rreptë.”**¹

“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në Allahun...”²

Bazuar në këto dhe në tekste të tjera kur'anore, ne detyrohemi të urdhërojmë për të mirë dhe të ndalojmë nga e keqja, ta pengojmë tiranin dhe mëkatarin nga dhuna e mëkatet, sepse, përndryshe, Allahu, për shkak të disa njerëzve të paktë që luajnë me sigurinë e njerëzve dhe bëjnë shkatërrime në tokë, do të na ndëshkojë të gjithëve, ngase ndëshkimi i Allahut ashtu siç nuk shtyhet, po ashtu as nuk dallon të mirin nga i keqi, myslimanin nga jomyslimani; ai i përfshin të gjithë.

Sot, umeti islam sa vuan nga armiqet e jashtëm, të cilët i janë vërsulur për t'ia thithur gjakun, për t'i grabitur pasurinë, për të shkaktuar dyshime në besim e fe, duke u ndihmuar edhe nga globalizmi e shekullarizmi, dhe kjo nëpërmjet mjeteve të informimit, të shkruara apo elektronike qofshin, me pretekst të përhapjes së të “mirës”,

1. Enfal, 8:25.

2. Al 'Imran, 3:110.

kulturës, civilizimit, globalizmit dhe demokracisë, ai, po aq, në mos më shumë, vuan edhe nga plasaritjet e brendshme të strukturës së tij. Divergjencë në të menduar e të besuar, ndarje në lëvizje, grupe, medh'hebe e parti, vrasje dhe dëbim nga shtëpitë të njerëzve të pafajshëm dhe të shtyrë në moshë, pleq, gra apo fëmijë të jenë ata. Të gjitha këto janë pjellë fatzezë e kësaj divergjence, përçarjeje dhe fatkeqësie fetare e njerëzore që ka sulmuar rëndë Botën Islame.

Në disa vende të Botës Arabe dhe Islame, po ashtu edhe në disa vend perëndimore, janë shfaqur disa të rinj myslimanë, të cilët bëjnë thirrje për rikthimin në Islam. *“Xhibad, Xhibad!”*, *“Vdekje kolaboracionistëve dhe hipokritëve”*, *“Kujdes, kjo lagje është zonë e Sheriatit Islam”*, etj., janë moto të tyre.

Po të analizojmë dhe të shtjellojmë çështjen e tyre, do të shohim se ata janë bartës të ideve të prapambetura dhe ekstreme që shpien në terrorizëm. Ata prej Islamit kanë marrë vetëm emrin dhe asgjë prej udhëzimeve të tij. Ata shkaktojnë trazira, rrëmujë, kaos dhe skandale, por mendojnë se janë duke vepruar drejt. Tronditin dhe trazojnë thellë qetësinë shpirtërore, ideore dhe politike të myslimanëve. Bëjnë thirrje për të mos respektuar prijësit, kundërshtojnë dhe ngrenë krye ndaj tyre, dhe jo vetëm kaq, ata edhe nxisin rininë që, krahas kësaj

kryengritjeje, të luftojnë edhe të gjithë ata që gjenden përkrah këtyre liderëve, pa marrë parasysh se a janë dijetarë, persona të organit të sigurisë, etj.

Fatkeqësisht, e tërë kjo marrëzi kryhet në emër të urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja, për përhapjen e së mirës dhe luftimin-pengimin e së keqes. Predikojnë dashurinë për vlera e virtyte, për mirëkuptim mes njerëzve, kurse realiteti i tyre dëshmon të kundërtën.

Ne, duke studiuar tekstet kur'anore dhe ato profetike, me lejen e Allahut, do të arrijmë të rrënjët e këtij problemi shoqëror dhe fetar. Do të njihemi edhe me ligjet e Allahut nën kupolën e këtij kozmosi dhe me mënyrën e pengimit dhe largimit të së keqes. Do të bindemi se rekomandimet kur'anore janë shërimi më adekuat! Fillimisht, kujtojmë disa të vërteta dhe rregulla themelore fetare në Jurisprudencën Islame (القواعد الفقهية), të cilat janë të një rëndësie shumë të veçantë, si p.sh.: **“Nuk ka dëm reciprok, mos e dëmto veten as tjetrin”** (لا ضرر ولا ضرار); **“E keqja largohet sipas mundësisë”** (الضرر يزال بقدر الإمكان); **“E keqja nuk largohet me një të keqe identike apo më të madhe se ajo”** (الضرر لا يُزال بالضرر مثله أو بضرر أكبر منه); **“E keqja e vogël përballohet për të larguar të keqen të madhe”** (يُحتمل الضرر) (الأدنى لدفع الضرر الأعلى), etj.³

3. Hafidh, Usame Ibrahim & Muhamed,

Bazuar në rregullat që përmendëm, çdo e keqe, lëndore apo kuptimore qoftë, si: terrorizmi dhe radikalizmi bashkëkohor, frikësimi dhe shqetësimi i njerëzve të pafajshëm, nga pikëpamja islame konsiderohen vepra të urryera e të refuzuara, të ndaluara me të gjitha format e llojet e tyre, dhe pikërisht nga këtu, Islami na fton të ndërtojmë qëndrimin tonë karshi kësaj sfide ideore dhe besimore të shtrembëruar, prej së cilës ka vuajtur dhe vazhdon të vuajë njerëzimi dhe bota përreth. Fatkeqësisht, disa kanë devijuar dhe kanë lajthitur nga ky parim, kështu që në fund kanë përjetuar dëshpërim, edhe pse ata vazhdimisht kanë menduar se janë duke bërë mirë dhe duke vepruar drejt.

Islami është fe e paqes dhe sigurisë, është fe e jetës, e ndërtimit dhe kulturës. Misioni i tij është krijimi i një ambienti të qetë dhe të mirë për njerëzit. Vdekja, vrasja, shkatërrimi dhe shqetësimi nuk janë pjesë të tij. Këtu mbase qëndron dhe sekreti i luftës së pa-kompromis të Islamit kundër këtyre dukurive shkatërruese, pra ekstremizmit dhe radikalizmit në ide, drejtime dhe besim, duke mos marrë parasysh një besim të veçantë. Kësisoj, Islami na fton te mesatarja, ekuilibrimi

Asim Abdu-l-Mexhid, *Mubaderetu uakfi-l-unfi – ru'jetun uaki'ijjetun ue nadbretun sher'ijjetun*, recensuar nga një grup ekspertësh, 2004. Rijad: Mektebetu-l-Ubejkan, f. 29-31.

dhe matura, sikurse na fton që t'i referohemi bazës apo kriterit të qendrës⁴, Kur'anit dhe Sunetit, në mënyrë që prej tyre të marrim udhëzimet e rekomandimet e duhura për trajtimin adekuat e të suksesshëm të kësaj dukurie, si dhe për ndjekjen e rrugës, e cila të shpie drejt kënaqësisë së Allahut në këtë botë dhe në botën tjetër.

Dijetarët kompetentë të umetit, si në të kaluarën ashtu edhe tani, konstatojnë njëzëri se qëllimet dhe objektivat e fesë sonë të pastër janë vënë për të realizuar gjërat madhore që kanë bëjnë me njerëzimin dhe jetën e tij. Këto të mira (interesa), ruajtjen e të cilave e ka marrë përsipër feja jonë islame, janë të shenjta dhe në asnjë mënyrë nuk lejohet që ato t'i ekspozohen së keqes. Këto interesa konsistojnë në: ruajtjen e fesë, qenies (jetës), mendjes, nderit dhe pasurisë. Këto pesë interesa njihen nga dijetarët si *el-kul-lijât el hams ed darurijeh* (pesë gjërat e mëdha) apo (të domosdoshmet.)

Kështu, dukuria e terrorizmit, vrasjes, shqetësimit, dëmtimit dhe shkatërrimit të pronave dhe shkeljes së nderit bie ndesh me këto mësimë hyjnore dhe ideale (objektiva) të larta njerëzore.

Mesatarja dhe baraspeshimi

Zgjidhja dhe opsioni, të cilin do t'ia propozojmë të rinjve dhe institucioneve tona shkencore dhe fetare, përmbledhet në përvetësimin e parimit të mesatares dhe maturisë në besimin, adhurimin, sjelljet, mendimet dhe të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ne, në njërën anë, dhe largimin nga radikalizmi, ekstremizmi dhe ashpërsia me të gjitha format dhe llojet e tyre, në anën tjetër.

E për vlerën dhe rëndësinë e këtij opsioni apo kësaj alternative, të ofruar për jetën dhe besimin tonë, dhe për atë se feja jonë është në mes të dy ekstremeve, flet më së miri Shejhu-l-Islam Ibn Tejmije, Allahu e mëshiroftë, në *El Uesijetu-l-Kubra*, i cili në fakt sjell para nesh ajkën e kësaj të vërtete të madhe, rezymeja e së cilës - si parafrazim - do të shprehej kështu:

"...dhe kejo palë e shpëtuar është Ehlul Suneti, që ndjek mesataren ndërmjet sekteve dhe feve; myslimanët janë mesatarë në çështjen me të dërguarit e Allahut, ngase nuk i tejkalojnë kufijtë në lëvdata siç bënë të krishterët, të cilët Isanë (alejhi's-selam), priftërinjtë dhe murgjit i morën për zot, ndërsa ishin urdhëruar të adhuronin vetëm një Zot. Po kështu nuk ndoqën as ekstremizmin tjetër të çifutëve, të cilët, nga mosrespektimi ndaj të dërguarve, disa i vranë e të tjerët i përgënjeshtroan. Myslmanët ndoqën mesataren përkitësisht me Isanë (alejhi's-selam) ngase nuk e

4. Fettah, Irfan Abdu-l-Hamid, *Muhadarat an kadaja esasijeh fi edjani-l-alem*, (Lectures on Major Themes in World Religions), botuar nga Universiteti Islam Ndërkombëtar në Malajzi, Kuala Lumpur, 2000.

quajtën zot, as bir të Zotit dhe as trini, por as nuk e mobuan; ata thanë se Isai (alejhi's-selam) është rob dhe i dërguar i Allahut, fjalë e Tij e hedhur në Merjemen e virgjër dhe shpirt prej Tij...

Myslimanët po kështu janë mesatarë edhe në ligjet e fesë së Zotit, kështu që ata nuk e kanë mobuar mundësinë që Allahu të anulojë ato ligje të fesë që Ai do dhe të lërë apo vërtetojë ato që do, ashtu siç bënë çifutët. Po kështu, ata nuk ia dhanë të drejtën askujt prej dijetarëve dhe fetarëve të tyre të mëdhenj që të bëjnë ndryshime në ligjet e Allahut, ashtu siç vepruan të krishterët.

Myslimanët shfaqen mesatarë edhe në lidhje me cilësitë dhe atributet e Allahut. Nëse çifutët ia përshkruan Zotit atributet e dobëta të krijesave, e përshkruan me mangësi dhe të meta, se kinse Ai është i varfër ndërsa çifutët janë të pasur, se kinse Zoti është dorështrenguar dhe se Ai është lodhur nga krijimi, kështu që e mori pushim ditën e shtunë, atëherë të krishterët iu dhanë krijesave veçori që janë ekskluzive vetëm për Krijuesin. Ata thanë se krijesa (Jezusi) krijon, furnizon, fal, mëshiron, e pranon pendimin, shpërblen dhe ndëshkon... Ndërsa Myslimanët e besuan Allahun ashtu siç shpalli Ai, se nuk ka adash (emnak), të ngjashëm, të njëjtë, askush nuk është sikurse Ai, Ai është Zoti dhe Krijuesi i qiejve dhe tokës, ndërsa të gjithë të tjerët janë krijesa të Tij dhe rrjedhimisht kanë nevojë për Të...

Ehlu-s-Suneti nuk janë mesatarë vetëm në raport me fetë e tjera, por edhe me fraksionet brendapërbrenda Islamit. Përkitësisht me emrat dhe cilësitë e Allahut

ata janë ndërmjet Ehlu Ta'tilit, që e zhveshin Zotin nga cilësitë e Tij dhe përshkrimet që Ai ia bëri Vetes dhe e ngjasojnë me diçka të pagënë apo të vdekur, dhe ndërmjet Ehlu Temthilit që sjellin shembuj dhe e ngjasojnë Allahun me krijesat. Ehlu-s-Suneti besojnë në atë që Allahu e përshkroi Vetën apo në atë që i Dërguari i Tij e përshkroi Atë, pa shtrembërime, zhvlefësime, ngjasime a shëmbëllime...

Po kështu, ata janë mesatarë edhe në çështjet e krijimit dhe urdhërimit ndërmjet atyre që e përgënjeshtrojnë fuqinë dhe forcën e Allahut dhe ndërmjet atyre që e zhveshin robin nga vullneti, fuqia dhe vepra, me çka i zhvlefësojnë urdhëresat, ndalesat, shpërblimin dhe ndëshkimin e Allahut, duke marrë trajtën e idhujtarëve, të cilët thanë se po të kishte dashur Allahu ne nuk do të bënim shirk (idhujtari)...

Ehlu-s-Suneti janë mesatarë edhe në vlerësimin e shokëve të Profetit (alejhi's-selam). Ata nuk shfaqin fanatizëm për Aliun dhe nuk e vlerësojnë atë ndaj Ebu Bekrit dhe Omerit, por nuk pajtohen as me ata që i cilësojnë si heretikë dhe të dalë nga feja, jo vetëm Aliun por edhe Osmanin... Ehlu-s-Suneti janë mesatarë në të gjitha çështjet e fesë, ngase ata i përmbahen rreptë Librit të Allahut, Kur'anit dhe Sunetit të të Dërguarit të Allahut, si dhe nuk i ndahen traditës së të parëve nga mubaxhirët dhe ensarët (mekasit dhe medinasit)."⁵

Pikërisht kjo mesatare do të jetë në fokusin tonë në këtë punim.

5. Ibn Tejmije, *Mexhmuu-l-fetava*, kap: *El-Uesijetu-l-kubra*, pj.32, f. 363. Shih edhe: *Hurmetu-l-gulu'ui fi-d-din ue tekfiri-l-muslimine*, f. 73-83.

Kjo veçori islame ka një ndikim jashtëzakonisht të madh dhe të padiskutueshëm kur bëhet fjalë për ruajtjen e rinisë islame nga devijimi dhe pështjellimi ndërmjet lëvizjeve të humbura dhe të çmendura në këtë kohë⁶. Qasjet materialiste kanë shfaqur përkushtim dhe interesim vetëm për aspektin material të jetës, duke anashkaluar tërësisht aspektin shpirtëror, apo i janë përkushtuar individit duke neglizhuar kolektivin.

Baraspeshimi, mesatarja dhe maturia në qasje dhe ide, baraspeshimi ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve, baraspeshimi ndërmjet kërkesave të shpirtit dhe trupit, nuk është diçka e lehtë, ngase njeriu, nga vetë natyra e tij, është i prirë që të veprojë gjithnjë diçka në llogari (dëm) të diçkaje tjetër, gjë kjo që ka si pasojë kaosin dhe shkatërrimin, si për individin ashtu edhe për shoqërinë. Myslimanit nuk i lejohet kurrë që të anojë ndaj ndonjë aspekti në dëm të aspektit tjetër.

Islami, fe e natyrshmërisë, ka ardhur për ta ruajtur këtë balancim në të gjitha porët e jetës, në adhurim dhe në çdo gjë tjetër. Edhe pse jemi urdhëruar të adhurojmë Allahun, prapë feja na porosit të gjejmë vend e kohë edhe për familjen, fëmijët dhe veten tonë. Puna për ahiret dhe përgatitja për të nuk nënkuptojnë se

6. Për më shumë rreth rrezikut të qasjeve dhe ideve të devijuara për rininë shih: Gufeji, Fehd b. Abdu-l-Aziz, *Hinuarun meal irhab*, f. 115-123.

duhet ta braktisim tërësisht botën në të cilën jetojmë. Ne na janë ndaluar ushqimet e dëmshme por jo edhe ato të mirat e të dobishme. Po kështu, e kemi të ndaluar edhe shmangien nga martesat me pretekstin e adhurimit. Dhe të gjitha këto sipas një metodologjie e programi edukativ të përsosur⁷.

Le të meditojmë dhe t'i analizojmë pak ajetet kur'anore, në të cilat Allahu i Madhëruar i qorton 'ithtarët e Librit' dhe i ndalon ata nga ekstremizmi.

“O ithtarët e librit, mos e teproni në fenë tuaj dhe mos thoni tjetër gjë për Allahun, përveç asaj që është e vërtetë. Mesihu, Isa, bir i Merjemes, ishte vetëm i dërguar i Allahut. Ishte fjalë e Tij (bëhu) që ia drejtoi Merjemes dhe ishte frymë (shpirt) nga Ai. Besojeni pra Allahun dhe të dërguarin e Tij e mos thoni: ‘Tre’ (trini). Pushoni (së thëni), se është më mirë për ju. Allahu është vetëm një Allah; larg qoftë asaj që Ai të ketë fëmijë. Ç’ka në qiej dhe ç’ka në tokë është vetëm e Tij. Mjafton që Allahu është planifikues i pavarur.”⁸

Ndërsa nëse lexojmë shkrimet e ‘shenjta’ të çifutëve, në të pesë librat/pjesët aktualë të Teuratit⁹ (*Dhiatës së*

7. Shih edhe punimin e Dr. Muhammed Seid Ramadan el-Buti, *Nabve menbexhin terbeviijn ferid*, 1988. Damask: Daru-l-fikr.

8. Nisa’, 4:171.

9. Për më shumë shih: Fetah, Irfan Abdu-l-

Vjetër), nuk do të mund të gjejmë gjurmë të shpirtërores dhe as vend ku përmendet ahireti, madje edhe premtimi dhe kërcënimi (*shpërblimi dhe ndëshkimi*) janë të lidhura kryesisht me këtë botë.

Ndryshe nga Teurati, në Ungjill hasim në një ftesë të fuqishme për të braktisur të gjitha vlerat e kësaj bote. Njeriu duhet të arratiset nga kjo botë, pasi shpëtimi është vetëm në botën tjetër. Thuaje njeriut nuk i ka mbetur vend dhe hise në dunja. Të mirat e saj nuk janë për të, trupi nuk ka të drejta, ndërtimi i botës nuk është punë e tij. Në Ungjill, Mesihu citohet t'i ketë thënë një të riu: “Nëse dëshiron të jesh i kompletuar (përsosur), atëherë shko dhe shite tërë atë që zotëron, e pastaj eja dhe më paso mua!” Ndërsa, një ditë, nxënësve të tij iu pat thënë: “Mos kërkonin ushqim dhe pije dhe mos u interesoni fare për to, ngase vetëm ata që nuk janë besimtarë interesohen për to.”¹⁰

Në këtë kontekst ata që në emër të fesë, ndërmarrin sulme terroriste ndaj myslimanëve apo jomyslimanëve, janë njerëz që vuajnë nga probleme dhe që kanë defekte në besimin dhe mendësinë e tyre. Ata janë njerëz që përjetojnë kriza mendore dhe probleme kulturore. Kjo, për shkak se ata i janë shmangur rrugës së qëlluar, e kanë injoruar

rrugën e drejtë, të cilën Kur’ani e përmend në shumë vende. Ajo rrugë në fakt është rruga e mesatares, maturisë e drejtpeshimit.

Në Kur’an e gjejmë shumë qartë aludimin për këtë botëkuptim të cilin po synojmë, pra çështjen e mesatares. *Por cili është qëllimi i saj? Cilat janë dimensionet e domethënies dhe kuptimeve të kësaj shprehje (Seua’-us Sebîl) (سواء السبيل). Le të shohim tani në bazë të tefsirit tematik të shkurtër disa ajete kur’anore dhe komente përkatëse të dijetarëve klasikë dhe bashkëkohorë, për të zbuluar sa madhështor është Kur’ani dhe sa i suksesshëm është ai në aspektin që po diskutojmë. Allahu xh.sh thotë:*

﴿أَمْ تُرِيدُونَ أَنْ تَسْأَلُوا رَسُولَكُمْ كَمَا سُئِلَ مُوسَىٰ مِنْ قَبْلُ ۚ وَمَنْ يَتَّبِعِ الْكُفْرَ بِالْإِيمَانِ فَقَدْ ضَلَّ سَوَاءَ السَّبِيلِ﴾
 “A doni ta pyetni të

Dërguarin tuaj sikurse u pyet më parë Musai. Ai që e ndërron besimin me mosbesim, ai tanimë e ka **humbur rrugën e drejtë**.”¹¹

﴿وَلَقَدْ أَخَذَ اللَّهُ مِيثَاقَ بَنِي إِسْرَآئِيلَ وَبَعَثْنَا مِنْهُمُ اثْنَيْ عَشَرَ نَقِيبًا وَقَالَ اللَّهُ إِنِّي مَعَكُمْ لَئِنْ أَقَمْتُمُ الصَّلَاةَ وَآتَيْتُمُ الزَّكَاةَ وَآمَنْتُمْ بِرُسُلِي وَعَزَّرْتُمُوهُمْ وَأَقْرَضْتُمُ اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا لَأُكَفِّرَنَّ عَنْكُمْ سَيِّئَاتِكُمْ وَلَأُدْخِلَنَّكُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ فَمَنْ كَفَرَ بَعْدَ ذَلِكَ مِنْكُمْ فَقَدْ ضَلَّ سَوَاءَ السَّبِيلِ﴾

“Në të vërtetë Allahu pat marrë zotimin e beni israilëve. Dhe prej tyre dërguam (caktuam) **dymbëdhjetë** prijës. Allahu tha:

11. Bekare, 2:108.

Hamid, *El jehudijjetu – arduñ taribijjun – ue-l-harekat el baditheb fi-l-jehudijjeh*, 2002, Amman: Daru Ammar. F. 135-168.

10. Po aty. Shih edhe: *Bazat e Biblës për myslimanët*, Surrey-England, 2004.

‘Unë jam (mbrojtës) me ju!’ Në qoftë se falni namazin, e jepni zeqatin, u besoni të dërguarve të Mi dhe u ndihmoni atyre, huazoni për hir të Allahut hua të mirë, Ai patjetër do t’ua shlyejë mëkatet tuaja dhe do t’ju shtie në xhenete nën të cilët rrjedhin lumenj. E kush kundërshton pas këtij (zotimi) prej jush, ai e ka humbur rrugën e drejtë.¹²

﴿قُلْ هَلْ أُنَبِّئُكُمْ بِشَرٍّ مِّنْ ذَلِكَ مَثُوبَةً عِنْدَ اللَّهِ مَن لَعَنَهُ اللَّهُ وَغَضِبَ عَلَيْهِ وَجَعَلَ مِنْهُمْ الْقِرَدَةَ وَالْخَنَازِيرَ وَعَبَدَ الطَّاغُوتِ أُولَٰئِكَ شَرٌّ مَّكَانًا وَأَضَلُّ عَن سَوَاءِ السَّبِيلِ﴾

“Thuaj: ‘A t’ju lajmëroj për një të keqe (të zezë) më të dëmshme (nga ajo e metë që na e shihni) si dënim nga Allahu? (Ajo është) Mallkimi i atij që e mallkoi Allahu dhe hidhërimi ndaj tij, që disa prej tyre i shndërroi në majmunë e në derra, e i bëri adhures të djallit. Të tillët janë në pozitë më të keqe dhe më të humburit prej rrugës së drejtë.’¹³

﴿قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ لَا تَغْلُوا فِي دِينِكُمْ غَيْرَ الْحَقِّ وَلَا تَتَّبِعُوا أَهْوَاءَ قَوْمٍ قَدْ ضَلُّوا مِنْ قَبْلُ وَأَضَلُّوا كَثِيرًا وَضَلُّوا عَن سَوَاءِ السَّبِيلِ﴾

“Thuaju: ‘O ithtarë të librit, mos e teproni në fenë tuaj jashtë të vërtetës dhe mos shkoni pas epsheve të një populli të mëparshëm që ka humbur, që ka shkaktuar humbjen e shumë të

tjerëve dhe që u largua në tërësi prej rrugës së drejtë.’¹⁴

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّخِذُوا عَدُوِّي وَعَدُوَّكُمْ أَوْلِيَاءَ تَلْقَوْنَ إِلَيْهِم بِالْمَوَدَّةِ وَقَدْ كَفَرُوا بِمَا جَاءَكُمْ مِنَ الْحَقِّ يُخْرِجُونَ الرَّسُولَ وَإِيَّاكُمْ أَن تُؤْمِنُوا بِاللَّهِ رَبِّكُمْ إِن كُنتُمْ خَرَجْتُمْ جِهَادًا فِي سَبِيلِي وَابْتِغَاءَ مَرْضَاتِي تُسِرُّونَ إِلَيْهِم بِالْمَوَدَّةِ وَأَنَا أَعْلَمُ بِمَا أَخْفَيْتُمْ وَمَا أَعْلَنْتُمْ وَمَن يَفْعَلْهُ مِنكُمْ فَقَدْ ضَلَّ سَوَاءَ السَّبِيلِ﴾

“O besimtarë, mos e konsideroni armikun Tim dhe tuajin për dashamir; ju po shprehni dashuri ndaj tyre, kurse ata, me të vërtetë, kanë mohuar të drejtën që u ka ardhur juve, e dëbuan Profetin dhe juve, vetëm se besonit në Perëndinë, Zotin tuaj (mos i bëni ata dashamirë), në qoftë se jeni (keni dalë) luftëtarë në rrugën Time dhe për kënaqësinë Time. Ju fshehurazi i shfaqni atyre dashuri, por Unë di edhe atë që fshini dhe atë që punoni haptazi. Ai prej jush, i cili armikun e bën dashamir, ai ka devijuar rrugën e drejtë.’¹⁵

Imam Ibn Kethiri, në komentin e pjesës së ajetit “ai tanimë e ka humbur rrugën e drejtë” (Bekare, 2:108), ka thënë: “...ai e ka humbur rrugën më të mirë, më të drejtë, më të qëlluar.” Ndërsa në komentin e pjesës së ajetit “...dhe që u largua në tërësi prej rrugës së drejtë” (Maide, 5:77) ka thënë: “...kanë devijuar nga rruga e drejtë dhe

12. Maide, 5:12.

13. Maide, 5:60.

14. Maide, 5:77.

15. Mumtehine, 60:12.

maturia për në rrugën e lajthitjes dhe humbjes”.¹⁶

Në Tefsiru-l-Xhelalejni, pjesa e ajetit **“ai tanimë e ka humbur rrugën e drejtë”** (Bekare, 2:108) është komentuar: *“...e ka gabuar rrugën e së vërtetës”*. Në fakt, *“e drejtë”* (ar. Es-seua) nënkupton mesin (el-uesat)...¹⁷

Imam Kurtubiu, në tefsirin e tij, ajetin në fjalë e komenton me *‘gabim dhe shmangie nga rruga e Muhamedit (alejhi’s-salam)’*.¹⁸

Ngjashëm e komenton edhe Imam Taberiu, i cili thotë: *‘e ka gabuar rrugën e qartë dhe ka devijuar nga metoda e rrugës së drejtë... rruga e drejtë është poenta, caku, destinacioni i së vërtetës...’*¹⁹.

Nga ajo që pamë mund të konstatojmë se Kur’ani dhe ajetet e tij lënë të kuptohet për shërimin më efektiv të mundshëm, shërim të cilin në fakt e kemi harruar. Kjo është mesatarja, maturia dhe ekuilibri, ilaçe këto për shërimin e dukurisë së ekstremizmit dhe radikalizmit fetar. Por, a thua vallë kemi përfituar nga Kur’ani dhe i jemi kthyer atij për t’i zgjidhur problemet tona?!

Kur’anina fton qetë përmbahemi parimit të mesatares, ngase Allahu na ka bërë umetin më të mirë të dalë

ndonjëherë në sipërfaqen e dheut; urdhërojmë për të mirë, ndalojmë nga e keqja dhe besojmë tek Allahu, gjëra këto që na bëjnë të aftë për të dëshmuar për të gjitha umetet në Ditën e Kiametit. Kjo gradë dhe ky privilegj janë të fshehura pikërisht te mesatarja, ekuilibrimi, maturia dhe drejtpeshimi fetar i umetit. Umeti islam është umet i drejtësisë, mirësisë dhe paqes. Këto janë gjërat me të cilat edhe u dërgua (shpall) kjo fe:

“Dhe ashtu (siç ju udhëzuam në fenë islame) Ne u bëmë juve një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në ditën e gjykimit) ndaj njerëzve, dhe për të qenë i dërguari dëshmitar ndaj jush...”²⁰

Kur’ani na fton të jemi mesatarë dhe të matur madje edhe në shpenzime, dhe këtë për t’iu shmangur luksit dhe ekstravagancës. Le të meditojmë pak për këto fjalë të bukura hyjnore:

“Edhe ata që kur shpenzojnë nuk e teprojnë e as nuk janë dorështrënguar, por mbajnë mesataren e janë të matur.”²¹

“Dhe mos e bëj dorën tënde të lidhur për qafe (mos u bë koprrac), e as mos e shtrij në tërësi, e të mbetesh i qortuar dhe duarthatë (nga shpenzimi i tepërt).”²²

16. Po aty, f. 213.

17. Mahal-liu dhe Sujuti, *Tefsiru-l-Xhelalejni*, Kajro: Daru-l-hadith. Pj. 1, f. 23, 510.

18. Kurtubiu, *El xhamiu li abkami-l-Kur’an*, 1372. Kajro: Daru-sh-Sha’b. Pj. 6, f. 114, 252.

19. Taberiu, *Xhamiu-l-bejan fi te’uili aji-l-Kur’an*, 1405. Bejrut: Daru-l-fikr. Pj. 6, f. 316 & pj. 14, f. 84.

20. Bekare, 2:143.

21. Furkan, 25:67.

22. Isra’, 17:29.

Mendoj se për çështjen në fjalë është shumë me interes të përmendim disa komente të dhëna nga dëshmori dhe mufesiri Sejjid Kutubi, i cili, duke komentuar ajetin e sipërcituar, thotë:

“Ekuilibri është një ndër rregullat e mëdha të metodës islame, ndërsa ekstremizmi, në kuptimin e ekstravagancës, shkakton çekuilibrim. Stili kur’anor e sjell këtu çështjen në formë figurative: koprracinë e përshkruan si dorë të lidhur pas qafe, ndërsa shpenzimin (e pakontrolluar) si dorë të shtrirë që nuk mban gjë, ndërsa fundin e këtyre dy ekstremeve e përshkruan si bllokim, sikurse të atij që ngel i qortuar për humbje. Gjuhësisht fjala ‘hasiir’ (humbje) nënkupton kafshën e lodhur që nuk mund të ecë. Kësisoj, edhe koprracin e humb dhe e bllokon koprracia e tij, sikurse e bllokun edhe atë që shpenzon pa vetëdije, derisa kjo e fundit t’i kthehet në humbje dhe të ngelë si i falimentuar. Pra, ngelet i qortuar në të dyja rastet, për koprraci dhe shpenzim, sepse ‘gjërat më të mira janë mesataret.’ Pastaj, vazhdon me atë se Allahu është Furnizues dhe se Ai i jep kujt të dojë aq sa të dojë dhe se Ai që furnizon është pikërisht Ai që urdhëron për të qenë mesatarë në shpenzime: **“S’ka dyshim se Zoti yt është Ai që furnizon me bollëk atë që do dhe ia kufizon atij që do. Ai hollësisht e di për robërit e vet**

dhe i vështron.”²³ I jep shumë kujt të dojë, me përvojë dhe vizion, dhe ia ngushton furnizimin kujt të dojë, me përvojë dhe vizion (dije). Urdhëron për të qenë të matur dhe mesatarë, ndërsa ndalon nga koprracia dhe shpenzimi i tepërt. Allahu e njeh në detaje atë që është më e mira për të gjitha rastet dhe rrethanat, ndërsa këtë Kur’an e shpalli si udhëzues për atë që është më e mira, absolutisht.”²⁴

Kjo metodologji ishte prezent edhe tek të gjithë Profetët e tjerë të Allahut, madje edhe në adhurim e raport me Allahun. Ata jetonin ndërmjet *frikës* dhe *shpresës*, frikës nga ndëshkimi e hidhërimi i Allahut dhe shpresës për të mirat, kënaqësinë dhe mëshirën e Tij. Asnjëri prej tyre nuk mashtrohej kurrë. Ja se si i përshkruan Allahu të dërguarit e Tij:

“...Ata përpiqeshin për punë të mira, Na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar, ishin respektues ndaj Nesh.”²⁵

Në rast se shpalosim citatat Profetike, që kanë të bëjnë me jetën dhe metodologjinë e të dërguarit të fundit, Muhamedit (alejhi’s-selam), do të gjejmë se ai ishte promotori më i sinqertë i kësaj metodologjie hyjnore dhe i këtij detyrimi të harruar e të braktisur, gjëra këto që i kanë sjellë umetit vërtet shumë pasoja. Muhamedi (alejhi’s-selam)

23. Isra’, 17:30.

24. Kutub, Sejjid, *Fi dhilali’l Kur’an*, pj. 4, f. 2223.

25. Enbija, 21:90.

agjëronte dhe hante, ishte i martuar dhe e adhuronte Allahun shumë, por edhe pushonte, i vizitonte të afërmit dhe kujdesej për fqinjët, qofshin këta edhe çifutë a të krishterë. Edhe hipokritët i trajtonte mirë, edhe pse e dinte se ata fshihnin urrejtjen në zemrat e tyre. Ai nuk ishte i izoluar nga shoqëria dhe rrethi ku jetonte. Kështu, bazuar në sjelljet e tij, për myslimanin mbetet detyrim që: “të ndjekë vijën mesatare ndërmjet atyre që anashkalojnë citatet rrënjësore fetare, me pretekstin e ruajtjes së objektivave fetare, dhe ndërmjet atyre që neglizhojnë objektivat e përgjithshme fetare, me pretekstin e ruajtjes së teksteve. Po kështu, duhet të jetë mesatar edhe ndërmjet atyre që janë zhytur në jetën politike në llogari të edukatës së mirëfilltë islame dhe ndërmjet atyre që e kanë anashkaluar tërësisht politikën, me arsyetimin e marrjes me edukatë islame, aq sa nuk janë të vetëdijsëm për gjërat që ndodhin rreth tyre dhe për komplotet që i bëhen Islamit në çdo vend. Këta, në fakt, e neglizhojnë misionin mbarë botëror të Islamit..., -myslimani i singertë duhet të jetë - mesatar duhet të jetë edhe ndërmjet atyre që e përvetësojnë kulturën perëndimore në përgjithësi, pa ndarë të mirën nga e keqja, dhe ndërmjet atyre që e refuzojnë paraprakisht atë, pa ndarë po kështu të dobishmen nga e dëmshmja. Mesatar duhet të tregohet edhe ndërmjet thirrësve konservatorë, që refuzojnë madje

edhe mjetet bashkëkohore të thirrjes, si kompjuterin dhe internetin, dhe atyre që ndjekin një ekstremitet tjetër, atë të reformave dhe ndryshimeve rrënjësore...”²⁶

Mesatarja, ekuilibri dhe maturia si hapat e duhur të trajtimit të terrorizmit

Për të luftuar dukurinë e shëmtuar të terrorizmit, të rinjve tanë dhe të gjitha instituteve akademike e shkencore, u ofrojmë “mesataren, ekuilibrin dhe maturinë” si ilaç dhe bar konkret. Në fakt, ne i ftojmë ata që të përvetësojnë parimin e mesatares në besim, adhurim, sjellje, raporte, mendime dhe në të gjitha gjërat që kanë të bëjnë dhe lidhen me to, ashtu siç iu propozojmë t’i shmangen tërësisht radikalizmit, ekstremizmit dhe vrazhdësisë, me të gjitha format dhe ngjyrat që kanë.

E se ç’rëndësi ka ky ilaç shërues dhe se ç’pozitiv ka në jetën dhe besimin tonë e mësuam pak më parë nga fjalët e Shejhul Islam Ibn Tejmijes, ashtu siç mësuam nga libri i Tij el-Uesijjetu-l-Kubra rreth asaj se si Islami shquhet për ruajtjen e mesatares në të gjitha ligjet dhe normat e tij. Ndërsa në vijim do të vazhdojmë me metodologjinë Profetike përkritësisht me mesataren dhe prezencën e saj në të gjitha poret e jetës, në mënyrë që të jemi të vetëdijsëm për veprimet tona.

26. Hurmetu’l gulu’ui fi’d dini ue tekfiri’l muslimine, f.78-79.

Profeti (a.s.) na fton në metodologji mesatare dhe të moderuar

Shprehjet dhe frazat, që Profeti (a.s.) dhe dijetarët e gjeneratave të para i kanë përdorur për të shprehur nevojën e mbajtjes së parimit të mesatares janë të ndryshme dhe të shumta.

Në Sunet ne gjejmë raste dhe forma të ndryshme. Për shembull:

“...të butë, të lehtë²⁷”,

“...por mëtojeni të qëlluarën dhe afrohuni (mos shfaqni ekstravagancë në adhurim)²⁸”,²⁹

“...Rrugën e mesme (maturinë)”,³⁰

“...Përmbajuni një udhëzimi (qëndrimi fetar) të maturi”,³¹

“...ngase atij që i thyhet udha, - duke e munduar/dhunuar mjetin/kafshën përgjatë udhëtimit, - as rrugën s’e mbaron dhe as kafsha (udhëtuese) nuk i mbetet gjallë (ngordh nga lodhja)”,³²

“Janë shkatërruar ekstremistët (e tha tri herë)!”³³

“...faluni sa ta ndieni veten se keni vullnet dhe jeni aktivë”,³⁴

“...Nuk do ta sfidojë askush fenë e të

*mos sfidohet*³⁵”,

“...por unë agjëroj dhe ha...”³⁶, e hadithe të tjera të shumta që janë thënë në kontekst të zbatimit të mesatares dhe maturisë në fjalë dhe vepra.

Ndërsa nga ato rregulla dhe përkufizime që kanë përmendur të parët tanë në fushën e jurisprudencës islame (القواعد الفقهية) e që kanë të bëjnë me ruajtjen e mesatares, veçojmë:

“Nuk ka tejkalim kufijsh të asnjëres anë (as në veprim dhe as në neglizhencë)”,

“Ideja e ekezagjervuar”,

“Zemërmirë dhe i butë (sjellshëm)”,

“Maturi në adhurim”,

“Largimi i vështirësisë nga ky umet”,

“Baraspeshimi dhe maturia”,

...e fraza të tjera të ndryshme që frymëzojnë për nevojën e zbatimit të parimit të mesatares dhe maturisë në adhurim e në marrëdhëniet (raportet) me njerëzit.

Imam Buhariu transmeton nga Ebu Hurejre se Profeti (alejhi’s-salam) ka thënë:

“Pastaj, feja është e lehtë dhe askush nuk do ta sfidojë atë (të mundohet të bëjë shumë adhurim) e të mos sfidohet, por ju mbajuni të vërtetës, (pa tejkalim kufijsh³⁷), (e nëse nuk mundeni ta bëni atë më të mirën,) atëherë – të

27. Buhariu, pj. 5, f. 2373.

28. Për më shumë shih kuptimin e këtij hadithi në fusnotën 43 në këtë punim.

29. Buhariu, pj. 1, f. 23.

30. Buhariu, pj. 5, f. 2373.

31. Sunen Ibni Maxheh, pj. 1, f. 240, nr. i hadithit: 3348.

32. Buhariu, pj. 3, f. 377.

33. Muslimi, pj. 4, f. 2055, nr. i hadithit: 2670.

34. Buhariu, pj. 1, f. 386, nr. i hadithit: 1099.

35. Buhariu, pj. 1, f. 23.

36. Buhariu, pj. 5, f. 1949, nr. i hadithit: 4776.

37. Këtë domethënie lënë të kuptohet edhe ajetet kur’anore: Ahzab, 33:70 dhe Nisa, 4:9.

paktën – *mundohuni të jeni afër saj. Dhe përgëzohuni!*³⁸

Bejhekiu, në Sunenin e tij, përmend një hadith tjetër nga Xhabir Ibn Abdullahu, ku thuhet se Profeti (alejhi's-selam) ka thënë se:

*“...Pastaj, kjo fe është e fortë, andaj hyj në të me butësi, dhe mos ia bëj të urryer vetes adhurimin për Zotin, ngase atij që i thyhet udha, as udhën s’e përfundon dhe as kafsha s’i shpëton.”*³⁹

Domethënia e: *ولن يشاء الدين أحد* askush nuk do ta sfidojë këtë fe” ka kuptimin: nuk ndodh që dikush të krijojë marrëdhënie me fenë me të fortë e të mos e mundë atë feja (ai të mos mundet t’ia dalë adhurimit në fund). Përfundimisht, domethënia e hadithit është: Askush të mos i tejkalojë kufijtë e normales dhe të mos dalë nga suazat e maturisë!⁴⁰

Sahabët e Resulullahit (a.s.) tërhoqën vërejtjen për ekstremizmin

Imam Hejthemiu, në Mexhmeu’z-Zeuaid, përmend se Abdullah Ibn Mes’udi ka thënë: “Për Atë, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër, nuk kam parë dikë më të ashpër ndaj ekstremistëve sesa Profeti (alejhi's-selam). Pas tij, nuk kam parë dikë më të ashpër ndaj tyre sesa Ebu Bekri dhe unë mendoj se Omeri ka qenë njeriu që ka pasur më së shumti frikë

për ta në sipërfaqen e dheut.”⁴¹

Profeti (alejhi's-selam) na tërheq vërejtjen që të ruhem nga ekstremizmi dhe vrazhdësia si dhe na ofron modelin mesatar: *“Fundi i ekstremistit është shkatërrimi”*

Imam Muslimi, në Sahihun e tij, transmeton se Profeti (alejhi's-selam) ka thënë: *“Janë shkatërruar mutenettiunët* (ekstremistët, ata që kalojnë kufijtë) – *duke e përsëritur tri herë këtë gjë.”*⁴²

Edhe Ebu Davudi shënon ngjashëm në Sunenin e tij: *“Vini re! Janë shkatërruar mutenettiunët* (ekstremistët, ata që kalojnë kufijtë) – *tri herë* (e përsëriti këtë gjë).”⁴³

Imam Neueuii, në komentin e këtij hadithi, ka thënë: Shprehja “Vini re!” është për vigjilencë, për të tërhequr vëmendjen, ndërsa “mutenettiune” nënkupton ekstremistët, ata që i kalojnë suazat e normales në fjalët dhe veprat e tyre.

Mesatarja në çështjet e adhurimit

Imam Buhariu, në Sahihun e tij, sjell rrëfimin e Zejnebes (Allahu i Madhëruar qoftë i kënaqur me të), të transmetuar nga Enes Ibn Malik, i cili thotë:

41. Hethemiu, *Mexhmeu’z-zeuaid ve menbeu-l-fenaid*. Bajrut: Daru-l-kitabi-l-arabijj. Pj. 10, f. 251.

42. Muslimi, pj. 4, f. 2055, nr. i hadithit: 2670.

43. Sunen Ebu Davud, pj. 4, f. 201, nr. i hadithit: 4608.

38. Buhariu, pj. 1, f. 23.

39. Buhariu, pj. 3, f. 377.

40. Fet’hu-l-Bari sherhu Sahihi-l-Buhari, pj. 8, f. 122.

“...Pastaj Profeti (alejhi’s-selam) hyri në xhami, kur ja një litar i shtrirë ndërmjet dy shtyllave. Si është puna e këtij litari?!, - pyeti me habi. Është litari i Zejnebes, e cila kur përgjimet lidhet (mbahet) pas tij. Jo, zgjidheni!, - urdhëroi Profeti (alejhi’s-selam). (kjo nuk kërkohet, por) Le të falet ndonjëri prej jush për aq kohë sa ndien gjallëri, është aktiv, e kur të përgjimet, le të ulet (të mos falet).”⁴⁴

Imam Buhariu, po kështu, transmeton edhe hadithin e Hisham Ibn Urue-s, i cili e ka dëgjuar atë nga babai i tij, e ky i fundit e ka dëgjuar Aishen të thotë:

“...Ishte tek unë një grua nga fisi Beni Esed. Kur erdhi Profeti (alejhi’s-selam) dhe e pa, pyeti për të. I thashë: Filania, nuk fle gjatë natës dhe namazi i saj përmendet. Profeti (alejhi’s-selam) tha: Le të heqë dorë nga kjo formë adhurimi! Kryeni ato punë që mundeni, ngase Allahu nuk lodhet (ndien monotoni⁴⁵) derisa ju të lodheni (ndieni monotoni) nga adhurimi....”⁴⁶

Mesatarja në çështjet civile

Imam Buhariu, në Sahihun e tij, shënon nga Enes Ibn Malik:

“Pastaj erdhën tri vetë të shtëpitë e grave të Profetit (alejhi’s-selam) të pyesnin për adhurimin e tij (a.s.). Kur u njoftuan

ndien disi se ata sikur e kishin anashkaluar adhurimin dhe nuk kishin bërë shumë. E ku jemi ne në raport me Profetin (alejhi’s-selam) të cilit Allahu ia ka falur të gjitha mëkatet, të hershmet dhe të vonshmet’, – thanë ata. Njëri prej tyre tha: Sa më përket mua, do të falem gjatë tërë natës. Tjetri tha: Unë do të agjëroj gjithmonë dhe nuk do të ha! Ndërsa i treti tha: Unë do të izolohem nga gratë dhe nuk do të fle me to kurrë! Kur erdhi Profeti (alejhi’s-selam) tha: A ju jeni ata që keni vendosur kështu e kështu? Për Allahun, unë më së shumti prej jush ia kam frikën dhe drojën Allahut, por megjithëkëtë agjëroj dhe ha, falem dhe pushoj, dhe fle me gratë (e mia). Kjo është tradita ime, e kush beq dorë nga tradita ime ai nuk është prej meje.”⁴⁷

Në disa transmetime, që Ibni Haxheri i ka përmendur në Fet’hu’l Bari, thuhet se tre të përmendurit në këtë hadith janë: Ali Ibn Ebi Talibi, Abdullah Ibn Amr el-‘Asi dhe Uthman Ibn Medh’uni. Këta u pajtuan që të agjëronin ditën, të faleshin natën, të mos flinin në shtrat, të mos hanin mish, të mos iu afroreshin grave dhe të tridheshin⁴⁸.

Mesatarja në marrëdhëniet bashkëshortore

Në Sahihun e Ibni Hibbanit është regjistruar rrëfimi i Ebu Derdasë me Selman Farisiun (Allahu qoftë i kënaqur me ta), rezymeja e të cilit është: Profeti (alejhi’s-selam)

47. Buhariu, pj. 5, f. 1949, nr. i hadithit: 4776.

48. Po aty.

44. Buhariu, pj. 1, f. 386, nr. i hadithit: 1099.

45. Në koment të këtij hadithi dijetarët kanë tërhequr vërejtjen se ai është tekst që vërteton këtë cilësi të Allahut, por asnjëherë dhe me asnjë kuptim a domethënie të krijesave. Ajo nuk është cilësi që shpreh mangësi, të metë; ajo është ashtu siç i ka hije Madhërisë së Allahut Fuqplotë.

46. Buhariu, nr. i hadithit: 1100.

kishte vëllazëruar Selmanin dhe Ebu Derdanë. Një ditë Selmani e kishte vizituar Ebu Derdanë, me ç'rast e kishte parë Ummu Derdanë (gruan e tij) disi si të larguar nga jeta martesore. - Çfarë ke?, - e kishte pyetur. - Vëllai yt nuk ndien më nevojë për dynjanë (i është larguar jetës bashkëshortore), - iu përgjigj gruaja. Ebu Derdaja u kthye në shtëpi. Selmani i uroi mirëseardhjen dhe i ofroi ushqim. Ha!, - i tha Selmani. Unë jam agjërueshëm, - iu përgjigj Ebu Derdaja. Të betohem që të hash, ngase unë nuk do të ha derisa të hash edhe ti. Ai u pajtua dhe e hëngrën ushqimin bashkë. Atë natë Selmani bujti. Kur Ebu Derdaja u ngrit natën të falej, Selmani e pengoi dhe më pas i tha: O Ebu Derda! Vërtet, ti ke detyrim ndaj Zotit, detyrim ndaj familjes, detyrim ndaj trupit tënd, andaj jepja çdokujt të drejtën e vet. Ha dhe agjëro, falu dhe fli, dhe fli me bashkëshorten tënde. Kur erdhi mëngjesi, Selmani i tha: Ngrihu tash! U ngritën dhe u falën që të dy (namaz nate). Pastaj shkuan në xhami ta falnin sabahun. Ebu Derdaja e lajmëroi Profetin (alejhi's-selam), për rastin e tij me Selmanin dhe mori të njëjtat fjalë edhe prej tij (alejhi's-selam)⁴⁹.

Mesatarja në marrëdhëniet shoqërore

Imam Bejhekiu, në *Shuabu'l Iman*, transmeton nga Zejd Ibn Eslem, e ky nga babai i tij, se Omeri

49. Sahihu Ibni Hibban, 1414. Bejrut: Muessesetu-rr-Risaleh. Pj. 2, f. 20.

(Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: “O Eslem! Le të mos jetë dashuria jote ngarkesë dhe as urrejtja jote dëmtim!” E si kështu?, - e pyeti. “Kur të duash, mos e ngarko veten shumë me të (mos u lidh shumë me të), mu ashtu siç lidhet fëmija me një send kur e do, por edhe kur të urresh, mos krijo urrejtje të atillë që të bënë të dëshirosh dëmtimin e shokut tënd apo shkatërrimin e tij.”⁵⁰

Imam Bejhekiu përmend, po kështu, edhe Muammerin që citon disa ta kenë dëgjuar Hasanin duke thënë: “Duani lehtë dhe urreni lehtë, ngase disa njerëz e kanë tejkaluar normalen në dashurinë ndaj disa të tjerëve dhe janë shkatërruar, sikurse që janë shkatërruar disa të tjerë që i kanë kaluar kufijtë në urrejtje. Andaj ju as mos doni tepër, por as mos urreni tepër.”⁵¹

Rast tjetër që Imam Bejhekiu përmend është ai i Hammad-it nga Thabiti, nga Mutrifi, i cili ka thënë: “Gjërat më të mira janë ato mesataret.”⁵²

Merueziu, në librin *Es-Sunneh*, përmend Ebu Kilaben të ketë cituar Ibni Mes'udin duke thënë: “... Mbahuni pas diturisë e kini kujdes rrisitë, tenettuin (ekstremizmin) dhe thellimin!”⁵³

50. Bejhekiu, *Shuabu-l-Iman*, 1410. Bejrut: Daru-l-kutubi-l-ilmijeh. Pj. 5, f. 261, nr. i hadithit: 6598.

51. Po aty, nr. i hadithit: 6599.

52. Po aty, nr. i hadithit: 6601.

53. Merueziu, *Es-Sunneh*, 1408. Bejrut: Muessesetu-l-kutubi-eth-thekafijeti, pj. 1, f.

Imam Ibn Maxheh, në Sunenin e tij, në kapitullin e *El-iktisadu fi'l ekl*, sqaron se *el-iktisad* rrjedh nga *el-keas*, që nënkupton: vendosmërinë në rrugë (qëndrimin drejt në rrugë – ar. *el-istikametu fi't tarik*), ashtu siç ka ardhur në ajetin kur'anor:

“Udhëzimi për në rrugë të drejtë i takon Allahut e ka edhe rrugë që është e shtrembër...”⁵⁴

Më pas, kjo fjalë është huazuar për t'u përdorur me kuptimin e mesatares në gjëra e çështje të ndryshme, siç ka ardhur p.sh. në hadithin që e transmeton Buhariu:

*“Ndiqni rrugën e mesme (mundobuni në mënyrë të arsyeshme në rrugën tuaj) se do të arrini (cakun)!”*⁵⁵

Pra, mbani një rrugë mesatare, një qëndrim të peshuar në thëniet dhe veprat tuaja. Le të mos ketë ekstremitetet të asnjërit pol. Me këtë kuptim kanë ardhur edhe hadithet:

“Përmbajuni udhëzimit (qëndrimit fetar) mesatar?”, dhe

“Nuk do të varfërohet ai që shpenzon me maturi?”

Pra, ndiqni një rrugë mesatare (në kuptimin e hadithit të parë) dhe mos shpenzoni tepër, por as mos u

bëni koprracë (në kuptimin e hadithit të dytë).⁵⁶

E lusim Allahun që, përkatësisht me çështjen e parimit të mesatares dhe maturisë, të na ketë dhënë sukses për mësimin dhe kuptimin e Librit të Tij dhe Sunetit të Profetit të Tij, Muhamedit (alejhi's-selam)!

Rinia dhe personat me kompetenca dhe përgjegjësi le ta kuptojnë mirë këtë realitet, ngase vërtet nevoja për të është shumë e madhe!

Dhe Allahu xh.sh, di më së miri!

Disa rrugë dhe metoda të suksesshme për shërimin e dukurisë së radikalizmit dhe të ekstremizmit

Analistët kanë arritur në përfundimin se dukuritë shoqërore që nuk shërohen apo nuk trajtohen në rrënjët e tyre dhe as nuk luftohen shkaqet e shfaqjes së tyre, rishfaqen përsëri. Radikalizmi, ekstremizmi nuk mund të zhduket derisa të mos zhduken shkaqet e tij të vërteta dhe rrënjët e tij ideore. Ne nuk do të mund ta zhdukim dukurinë e dhunës dhe terrorizmit përderisa të mos zhytemi në beteja ideologjike dhe kulturore me këta njerëz, ngase kultura është ajo që nën vallon e fesë u lejon dhe sikur arsyeton vrasjet që bëjnë. Në vijim, do të përmendim rrugët më të rëndësishme që ndihmojnë në çrrënjësien e kësaj dukurie të egër shoqërore:

56. Sunen Ibni Maxheh, pj. 1, f. 240, nr. Hadithit: 3348.

30, nr. i hadithit: 85.

54. Nahl, 16:9.

55. Ky hadith e krahason besimtarin, në raport me adhurimin, me një udhëtar, i cili vetëm nëse udhëton pandërprerë ka gjasa që ta humbë fuqinë dhe kursesi të mos arrijë te caku. E nëse udhëton me pushime, pra ndjekur një masë të caktuar gjatë ecjes, herë ecën e herë pushon, atëherë ka mundësi ta përshkojë rrugën pa probleme.

- Patjetër duhet bërë riformulimi-rihartimi i botëkuptimeve fetare në shoqëritë arabe dhe islame. Parimet fetare duhet të zhvishen nga çdo element i dhunës, ekstremizmit dhe urrejtjes.

- Përforcimi i parimeve të dialogut, tolerancës dhe pranimi të tjetrit, qoftë me të menduar, qoftë edhe me qenien e tij.

- Siguria shoqërore nuk mund të garantohet përderisa të mos garantohet edhe siguria dhe ruajtja e së drejtës së të menduarit, të dijes, lirisë dhe barazisë.

- Radikalizmi, ekstremizmi është pjellë e lëshimeve të mëdha në çështjet ekonomike dhe shoqërore, si dhe e dhunës, prandaj duhet arritur një drejtësi për të gjitha shtresat e shoqërive tona.

- Dallimet në mendime, nuk shkaktojnë edhe ndarjen nga kolektivi dhe jeta e përbashkët.

- Islami na urdhëron që individët dhe shoqërinë t'i pastrojmë nga urrejtja që buron nga zilia dhe shpirt-vrazhdësia dhe të gjithë, të bashkuar, të qëndrojmë stoikë përballë çdo shtrëngate që fryn nga kulturat që ushqejnë dhe rrisin urrejtjen, zilinë, mërinë dhe përçarjen ideore apo fetare.

- Mjetet e informacionit (mediat) duhet të tregojnë dhe të shfaqin një transparencë të ekspeditave perëndimore karshi plan-programeve fetare në shoqëritë tona islame, në mënyrë që kjo të mos

bëhet shkak që këta të rinj, si kundër-reagim, të kryejnë gjëra-vepra të tilla.

- Një trajtim mjekësor dhe psikologjik i madh u duhet bërë atyre luftëtarëve që janë kthyer nga vatra të luftës. Ata atje janë ushqyer me idetë se xhihadi është bazë e jetës, kurse paqja është përjashtim nga rregulli, dhe se jeta pa xhihad humb domethënien e saj.

- Nuk duhet të nënvlerësojmë rolin negativ që luajnë disa teatro, kinema dhe klube të natës në vendet dhe shoqëritë islame. Disa hotele janë të njohura për imoralitetin që ushtrohet në to dhe, në mënyrë a në një tjetër, mund të bëhen shkak që të jenë pre e sulmeve të të rinjve myslimanë, të cilët nuk mund ta përmbajnë veten para dukurive të tilla. Që të mos i fryjmë zjarrit më shumë, duhen penguar zhvillimi dhe ushtrimi i lirë i veprimeve të tilla famëkeqe në hotelet tona.

- Dukuritë negative që janë shfaqur në shoqëritë tona, si: papunësia, kamata, ngritja e çmimeve, kushtet e rënda të jetesës, ndihmat e ulëta sociale, varfëria e skajshme, etj., shpeshherë bëhen shkaqe që viktimat e tyre të ngrihen kundër dhe të shkaktojnë trazira e rrëmuja në vend. Andaj, për të mos ndodhur më e keqja, duhet të krijohen kushte më të mira për jetesë, të ofrohen mundësi punësimi, shkollimi, shërimi, etj.

- Duhet luftuar racizmi në të gjitha format dhe ngjyrat e tij.

Njerëzit duhen pajtuar duke flakur mosmarrëveshjet në marrëdhëniet prind-fëmijë, burrë-grua, vëlla-vëlla, etj.

- Rregull bazë për këtë mbetet koncepti se zjarri nuk shuhet me zjarr, dhuna nuk ndalet me dhunë, kështu që mbetet shërimi i mendimit me mendim, i idesë me ide, çfarëdo

që të jetë ajo; e devijuar apo e pabazë.

“Në të gjitha këto, për atë që ka mendje të shëndoshë dhe që i ka vënë veshin me vëmendje, ka argumente”.⁵⁷ Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

57. Kaf, 50:37.

Literatura në gjuhën arabe

- أبو العباس، أحمد بن عبد الحليم بن تيمية الحراني: مجموع الفتاوى- باب الوصية الكبرى، المملكة العربية السعودية - الرياض، ١٤٠٠ هـ.
- أبو الفداء، إسماعيل بن عمر بن كثير الدشقي: تفسير القرآن العظيم، دار الفكر، بيروت، ١٤٠١.
- أبو جعفر، محمد بن جرير بن يزيد بن خالد الطبري: جامع البيان في تأويل آي القرآن، دار الفكر، بيروت، ١٤٠٥.
- أبو سليمان، عبد الحميد: أزمة العقل المسلم، من مطبوعات المعهد العالمي للفكر الإسلامي، ١٩٩٦، كوالا لمبور - ماليزيا.
- أبو عبد الله، محمد بن أحمد بن أبي بكر بن فرح القرطبي: الجامع لأحكام القرآن، دار الشعب- القاهرة، ط ٢، ١٣٧٢، تحقيق: أحمد عبد العليم البردوني.
- أبو فرحة، جمال الحسيني: الخروج على الحاكم في الفكر السياسي الإسلامي، ط ١- القاهرة- ٢٠٠٤، مركز الحضارة العربية.
- أسامة إبراهيم حافظ؛ عاصم عبد الماجد محمد: حرمة الغلو في الدين و تكفير المسلمين. مكتبة العبيكان، ط ١-٢٠٠٤، الرياض - المملكة العربية السعودية.
- أسامة إبراهيم حافظ؛ عاصم عبد الماجد محمد: مبادرة وقف العنف - رؤية واقعية ونظرة شرعية، أقره و راجعه: كرم محمد زهدي-علي محمد علي الشريف - ناجح إبراهيم عبد الله - محمد عصام الدين درباله - فؤاد محمود الدواليبي - حمدي عبد الرحمن عبد العظيم، مكتبة العبيكان، ط ١-٢٠٠٤، الرياض - المملكة العربية السعودية.
- أسامة إبراهيم حافظ؛ عاصم عبد الماجد محمد: تسليط الأضواء على ما وقع في الجهاد من من أخطاء، أقره و راجعه: كرم محمد زهدي-علي محمد علي الشريف - ناجح إبراهيم عبد الله - محمد عصام الدين درباله - فؤاد محمود الدواليبي - حمدي عبد الرحمن عبد العظيم، مكتبة العبيكان، ط ١-٢٠٠٤، الرياض - المملكة العربية السعودية.
- الاشقر، عمر سليمان عبد الله: نحو ثقافة إسلامية أصيلة، دار النفائس للنشر و التوزيع، عمان، ٢٠٠٢، ط ١٢.
- أمل يازجي & محمد عزيز شكري: الإرهاب الدولي و النظام العالمي الراهن، دار الفكر، دمشق- سوريا، ط ١، ٢٠٠٢.
- إيضاح القواعد للإمام علاء الدين محمد بن أحمد السمرقندي (ت ٥٤٠ هـ).
- البستي، محمد بن حبان بن أحمد أو حاتم التميمي: صحيح ابن حبان، مؤسسة الرسالة- بيروت، ١٤١٤، ط ٢، تحقيق الشيخ: شعيب الأرنؤوط.
- بكار، عبد الكريم: عصرنا والعيش في زمانه الصعب، دار القلم، دمشق، ط ٢، ٢٠٠٤.
- البوطي، محمد سعيد رمضان نحو منهج تربوي فريد، دار الفكر، ط ٢، دمشق- سوريا، ١٩٨٨.
- بول آر. بيلار، سبل مكافحة الإرهاب، ضابط الاستخبارات القومية للشرق الأدنى و جنوب آسيا في المجلس القومي للاستخبارات - وكالة الاستخبارات المركزية.
- البيهقي، أبو بكر أحمد بن الحسين: شعب الإيمان، دار الكتب العلمية-بيروت، ١٤١٠، ط ١، تحقيق: محمد السعيد بسيوني زغلول.
- الجعفي: محمد بن إسماعيل أبو عبد الله البخاري: صحيح البخاري، دار ابن كثير، اليمامة، بيروت، ط ٣، ١٤٠٧، تحقيق: د. مصطفى ديب البغا.
- الحسيني، إبراهيم بن محمد: البيان والتعريف، دار الكتاب العربي، بيروت، ١٤٠١ هـ، تحقيق: سيف الدين الكاتب.
- الحقيل، سليمان بن عبد الرحمن: حقوق الإنسان في الإسلام وتطبيقاتها في المملكة العربية السعودية، ط ١، ٢٠٠٠.
- خليل، إبراهيم: تشريح الإسرائيلي- رؤية توراتية لجسد إسرائيلي، مكتبة التراث الإسلامي، القاهرة- ١٩٩٧.
- الدريويش، أحمد بن يوسف بن أحمد: طاعة ولي الأمر وأثرها في تحقيق أمن الوطن - دراسة شرعية، ط ١، ٢٠٠٥، دار كنوز إشبيلية للنشر و التوزيع، الرياض.

- الدوسري، فهد بن مبارك محمد الدوسري: الغلو في الدين ووسطية الإسلام، مدار الوطن للنشر و التوزيع، ط ١، ٢٠٠٥، الرياض، ص: ٢٢-٦١
- ديوك، ديفيد: ترجمة: سعد رستم: أمريكا - إسرائيل و ١١ أيلول ٢٠٠١، الأوائل للنشر و التوزيع ٢٠٠٢، ط ١، دمشق-سوريا
- الريبعة، عبد العزيز عبد الرحمن: صور من سماحة الإسلام، ط ٤، ٢٠٠١، الرياض.
- سانو، قطب مصطفى، الإرهاب بين الشريعة الإسلامية و أف بي أي FBI، محاضرة علمية ألقاها في الندوة الأسبوعية في الجامعة الإسلامية العالمية في كوالا لمبور بماليزيا، بتاريخ ٢٠٠٣ ر ١٥
- السجستاني، سليمان بن الأشعث أبو داود: سنن أبي داود، دار الفكر، تحقيق: محمد محي الدين عبد الحميد.
- السحمراني، أسعد: لا للإرهاب نعم للجهاد، دار النفائس، ط ١، ٢٠٠٣، بيروت-لبنان، خليل إبراهيم: تشريح الإسرائيل - رؤية توراتية لجسد إسرائيلي، مكتبة التراث الإسلامي، القاهرة-١٩٩٧.
- السحمراني، أسعد: لا للإرهاب نعم للجهاد، دار النفائس، ط ١، ٢٠٠٣، بيروت
- سلطان، جمال: جهادنا الثقافي - مواقف وإشارات، مركز الدراسات الإسلامية، برمنجهام - بريطانيا، ط ١، ١٩٩٣.
- ضميرية، عثمان جمعة: مدخل لدراسة العقيدة الإسلامية، مكتبة السوادي للتوزيع، جدة، ط ٤، ٢٠٠٣.
- الطلاع، رضوان بن طاهر: نحو أمن فكري إسلامي، ط ٢، ١٤٢٠، الرياض.
- ظاهرة العنف الديني.. لماذا؟، المركز العالمي للاستشارات الاستراتيجية، ط ٢، ٢٠٠٤، مكتبة العبيكان، الرياض، المملكة العربية السعودية.
- عبد الحميد، محسن: أزمة المثقفين تجاه الإسلام في العصر الحديث، دار الصحوة للنشر و التوزيع، ط ١، ١٩٨٤
- عبد الله، ناجح إبراهيم: تفجيرات الرياض - الأحكام والآثار، الناشر: مكتبة التراث الإسلامي، ١٤٢٥/٧/١٥ هـ،
- العسال، أحمد محمد: الإسلام و بناء المجتمع، ط ٥، دار القلم، الكويت، ١٩٨٢.
- علوان، عبد الله ناصح: الشباب المسلم في مواجهة التحديات، دار القلم، دمشق، ط ٤، ٢٠٠٢
- العودة، سلمان بن فهد: مقولات في فقه الموقف، ط ٢، ٢٠٠٢، مؤسسة الجريسي للتوزيع، الرياض.
- الغفيلي، فهد بن عبد العزيز: حوار مع الإرهاب، ط ١، ١٤٢٥، الرياض
- الغنوشي، راشد: ضرورة المراجعة الذاتية في ضوء القرآن و الحرية الدينية، في إحدى محاضراته العلمية، حينما زار الجامعة الإسلامية العالمية في ماليزيا عام ٢٠٠٢ م.
- فتاح، عرفان عبد الحميد: اليهودية - عرض تاريخي - والحركات الحديثة في اليهودية، دار عمار، ط ١، ٢٠٠٢، عمان - الأردن
- فتاح، عرفان عبد الحميد: محاضرات عن قضايا أساسية في أديان العالم - Lectures on Major Themes in World Religions، من مطبوعات الجامعة الإسلامية العالمية بكوالا لامبور- ماليزيا، ٢٠٠٠.
- القرضاوي، يوسف: الخصائص العامة للإسلام، مؤسسة الرسالة، ط ١، ١٩٩٧، بيروت، لبنان.
- القرضاوي، يوسف: الصحوة الإسلامية بين الجحود و التطرف، مكتبة وهبة، ١٤١٢، بيروت، لبنان.
- القرضاوي، يوسف: المسلمون و العنف السياسي - نظرات تأصيلية، ٢٠٠٤ ر ٦٠٦، <http://www.alqaradawi.net>
- قطب سيد: في ظلال القرآن، دار الشروق، ط ٥، ١٩٩٤، القاهرة
- قطب، سيد: لماذا اعدموني، من مطبوعات الشرق الأوسط للإعلام، ط ١، ١٩٩٠، القاهرة.
- قواعد الأحكام في مصالح الأنام؛ للإمام عبدالعزيز بن عبد السلام السلمي (ت ٦٦٠ هـ)
- الكواكبي، عبد الرحمن: طبائع الاستبداد و مصارع الاستعباد - تقديم و دراسة: د. أسعد السحمراني، دار النفائس، بيروت-لبنان، ط ٢، ٢٠٠٣.
- المحلي، محمد بن عبد الرحمن بن أبي بكر، والسيوطي: عبد الرحمن: تفسير الجلالين دار الحديث-القاهرة ط ١.
- المروزي، محمد بن نصر بن الحجاج أبو عبد الله: كتاب السنة، مؤسسة الكتب الثقافية، بيروت،

- ١٤٠٨، ط ١، ت سالم أحمد السلفي.
 مهلاً هنتنغتون.. مهلاً فوكوياما - نظرية الشبكة التصفوية في صراع الثقافات و المادة، اعداد: المركز العالمي للاستشارات الاستراتيجية، ط ٢، ٢٠٠٤، مكتبة العبيكان، الرياض- المملكة العربية السعودية.
- الموافقات في الشريعة الإسلامية، للإمام الشاطبي
 الموجان، أحمد بن حسين بن عبد الله: الإرهاب.. روافده.. أسبابه الفكرية... علاجه.. أقوال العلماء فيه، ط ١، ٢٠٠٤، سنا الفاروق للنشر، جدة، المملكة العربية السعودية
- النووي، أبو زكريا يحيى بن شرف: آداب الفتوى، دار الفكر- دمشق، ط ١، ١٤٠٨، تحقيق: بسام عبد الوهاب الجنابي.
- النيسابوري: مسلم بن الحجاج أبو الحسين القشيري: صحيح مسلم دار إحياء التراث العربي- بيروت، تحقيق: محمد فؤاد عبد الباقي
- النيسابوري، محمد بن عبد الله أبو عبد الله الحاكم: المستدرك على الصحيحين، دار الكتب العلمية، بيروت، ١٩٩٠، ط ١، تحقيق: مصطفى عبد القادر عطا، ج ٣، ص: ٤٧٦، الرقم: ٥٧٧٨، الهيثمي، علي بن أبي بكر: مجمع الزوائد ومنبع الفوائد، دار الكتاب العربي- بيروت.
- الوجيز في إسلامية المعرفة، المعهد العالمي للفكر الإسلامي، ١٩٨٧ هـ، لندن، فيرجينيا، الولايات المتحدة الأمريكية.
- الياسين، لواء عبد الرحمن أبكر: الإرهاب سرطان المجتمعات المعاصرة، ط ١، ٢٠٠٣، دار طويق للنشر والتوزيع، الرياض، المملكة العربية السعودية.
- ياغي، إسماعيل أحمد: الإرهاب والعنف في الفكر الصهيوني، مكتبة العبيكان، ط ١، ٢٠٠٣، الرياض- المملكة العربية السعودية.
- يالج، مقداد: الطريق إلى العبقريّة، دار الهدى للتوزيع و النشر، الرياض، ط ١، ١٩٨٧.
- يالج، مقداد: طريق السعادة، ط ١، ١٩٨٧، مطابع البكيرية، الرياض.
- يالج، مقداد، الرحلات العلمية من الشرق إلى الغرب، رحلة د. مقداد يالج- الحاصل على جائزة الملك فيصل العالمية. دار عالم الكتب- الرياض، ط ١- ١٩٩٢.

El-Kurtubiu Mufessir i njohur andaluzian

Kurra hfz. doc. dr. Xhevad Shoshiq

Abstrakt

Dijetari i njohur i Andaluzisë, Ebu Abdullah Muhammed b. Ahmed el-Kurtubi, pasuesi i shkollës juridike malikite, ka dhënë kontribut të njohur në zhvillimin e shkencave të ndryshme islame, posaçërisht zhvillimit të komentit kur'anor. Vepra e tij 'El-Xhami'u li 'abkamil'- Kur'an', e shkruar në më shumë se njëzet vëllime, konsiderohet një nga arritjet më të vlefshme të tefsirit. Në të trajtohet jo vetëm aspekti normativ i Kur'anit (fikhu), por edhe aspekte të tjera të angazhimit të tekstit kur'anor, siç janë: linguistika, stilistika, semantika, kiraeti, hadithi, etj. Përveç Tefsirit, Kurtubiu ka shkruar edhe vepra të tjera, nga të cilat vepra më e njohura është 'Et-Tedbkire bi 'abuali'l-menta ue 'umuri'l-'abire.'

Fjalët kyçe: *El-Kurtubi, tefsir, aspekti normativ, kiraetet, komentimi juridik, analiza gramatikore, teksti kur'anor, gjuha arabe.*

Tefsiri voluminoz dhe gjithëpërfshirës i Kurtubiut *El-Xhami' li 'abkamil'- Kur'an*, i cili ofron gati tekstin e kompletuar interpretues për kuptimin e drejtë të Fjalës së Allahut, meriton vëmendje dhe respekt të posaçëm. Gati të gjitha metodat dhe burimet e komentimit të Kur'anit, të së ashtuquajturës periudhë klasike, nga koha e Pejgamberit (a.s.) e deri në shekullin

e shtatë pas Hixhretit, do t'i gjejmë në tefsirin e tij.

Përveç vëzhgimeve të hollësishme sheriato-juridike, ky tefsir i dhuron vëmendje të mjaftueshme transmetimeve tradicionale, shkaqeve të zbritjes së Shpalljes, ajeteve të shfuqizuara dhe shfuqizuese, kiraeteve¹, gramatikës,

1. Mënyrat e ndryshme të leximit të Kur'anit Fisnik, prej të cilave shtatë janë të konfirmuara dhe tre janë plotësuese, pra

morfologjisë dhe stilistikës së gjuhës arabe, e jo rrallëherë do të takohemi me poezinë arabe të cilën El-Kurtubiu e shfrytëzon në argumentimin e rregullave gramatikore dhe zbulimin e prejardhjes etimologjike të fjalëve jo të zakonshme kur'anore.

Edhe pse El-Kurtubiu në tefsirin e tij, në masë të madhe, u mbështet në veprat e tefsirit të autoriteteve të mëhershëm nga lëmi e tefsirit, linguistikës arabe dhe së drejtës islame, siç ishin Ibn 'Atijeh, Ebu Xha'fer en-Nehhas, El-Mauerdi, Et-Taberi, Ibnu'l-'Arabi, etj., shpirti i tij shkencor shpërfaqet në komente të ndryshme, analiza gjuhësore, rishikime kritike, qëndrime dhe mendime të argumentuara.

Duke u bazuar në veçoritë e përmendura, është e vështirë të gjendet një mufesir serioz, i cili, në librat e tij, të mos i referohet Tefsirit të El-Kurtubiut. Fakti se dijetarët e mëdhenj të shkencës së tefsirit, si Ibn Kethiri, Ebu Hajjani dhe Esh-Sheukani, kanë qenë të mahnitur me El-Kurtubiun, dhe se në veprat e tyre, në masë të konsiderueshme, e kanë shfrytëzuar tefsirin e tij *El-Xhami' li 'abkamil-Kur'an*, flet mjaftueshëm se për çfarë gjeniu të interpretimit kur'anor bëhet fjalë.

në total dhjetë, janë të përcjella nga Profeti (a.s.) dhe janë transmetuar brez pas brezi në tekstin kur'anor të grumbulluar nga Osman bin Affani (r.a.), e deri në ditët tona. (shën. red.)

1. Biografia

Emri i plotë i Kurtubiut ka qenë Ebu Abdullah Muhammed b. Ahmed b. Ebu Bekr b. Ferh El-Ensari El-Hazrexhi El-Kurtubi. Data e saktë e lindjes së tij nuk është e njohur. Dihet se ka ndërruar jetë më 9 Shevval 671. H., ose 28. prill 1273, në Egjipt. Emërtimin El-Kurtubi e ka marrë sipas vendit të lindjes – Kurtubi (Kordoba).²

Lindi gjatë kohës së qeverisjes së dinastisë së muchidëve, më saktësisht gjatë kohës së kalifit Ja'kub b. Jusuf 'Abdu'l-Mu'min (vdiq në vitin 595/1163). Për mbikëqyrjen dhe edukimin e tij u kujdes babai i tij, Ahmedi. Në burimet historike dhe biografike nuk ka detaje për fëmijërinë e tij. Dihet se babai i tij i është vrarë në njërën nga betejat e kryqëzatave ndërkohë që lëvronte me disa myslimanë në tokën e tij në afërsi të Kordobës.³

Kurtubiu, qysh në fëmijëri, arriti të bëhej hafiz i Kur'anit. Kishte prirje për gjuhën dhe poezinë arabe. Edukimin e mori në xhamitë e Kordobës, duke dëgjuar ligjërata prej autoriteteve më të shquar të asaj kohe. Qarqet edukative ishin të organizuara edhe në qendra të tjera të Andaluzisë së atëhershme. Në vise rurale ishin hapur shkollat fillore,

2. Ebu Bekr Abdur-Rahman es-Sujuti, *Tabakat el-mufessirin*, Darul-kutub el-ilmije, Bejrut, pa vit botimi, vëll. II, f. 69-70.

3. Shih: *El-Xhami' li abkam el-Kur'an*, Dar el-Hadith, Kajro, bot. II, 1996, vëll. IV, f. 282.

kurse në qytete shkolla të larta dhe biblioteka. Institucione të tilla kanë qenë kultivuese të diturisë jo vetëm për Andaluzinë, por edhe për pjesë të tjera të Evropës së atëhershme, duke parë se, studentë nga vendet evropiane, kishin ardhur në qytete të Andaluzisë dhe kishin studiuar shkenca të ndryshme. Nuk dihet me saktësi se cilat shkolla ndoqi Kurtubiu, por mund të thuhet se klima fetare, shoqërore dhe kulturore favorizoi zhvillimin e tij intelektual dhe shoqëror.⁴

Kurtubiu përfitoi nga dituria e shumë mësuesve. Më të përmendurit janë: Ebu Xhafer Ahmed b. Muhammed el-Kajsi, i njohur si Ibn ebi Huxhxhe (vdiq në vitin 643 h.) dhe Rebi' b. Abdurr-Rahman b. Ahmed b. Abdurr-Rahman b. Rebi' el-Esh'ari (vdiq në vitin 633 h.), ekspertë në lëmin e kiraetit dhe linguistikës arabe, dhe të dy ishin nga Kordoba. Përveç mësuesve, ai kishte në dispozicion edhe vepra të shkruara, që janë ruajtur në bibliotekat e vendit, nga fusha të ndryshme shkencore: tefsir, hadith, gjuhë arabe, poezi, histori, letërsi, etj. Falë mundit dhe interesimit të gjithanshëm shkencor, Kurtubiu u bë një dijetar i ri i diapazonit të gjerë dhe kërkues i madh. Me kalimin në Egjipt, penda e tij do të shndritë me fuqinë e plotë; aty e shkroi veprën

4. Shih: El-Kasabi Mahmud Zalat, *El-Kurtubi ue menhexhuhu fi et-tefsir*, Darul-kelam, Kuvajt, 1981, f. 9-10.

e tij jetësore - tefsirin *El-Xhami' li 'abkamil'-Kur'an*.⁵

Kur erdhi në Egjipt, sigurisht pas rënies së Kordobës në duart e të krishterëve, në vitin 633 h., Kurtubiu fillimisht qëndroi në Aleksandri, pastaj kaloi në Kajro dhe, nga fundi i jetës së tij, u vendos në qytetin El-Munja, ku edhe vdiq.⁶

2. Përqendrimi në mundësitë shoqërore-historike të periudhës së Kurtubiut

Kurtubiu jetoi në kohën e dinastisë së muehidëve. Me shfaqjen dhe punën e reformatorit mysliman, Berberit, Ahmed b. Abdullah b. Tumart (1078-1130), i njohur me emërtimin El-Mehdi, u arrit deri te bashkimi i fiseve të ndryshme marokene. Ky ishte fillimi i shfaqjes së dinastisë së muehidëve, themeluesi i së cilës ishte Abdul-Mu'min b. Ali (vdiq në vitin 1163). Kështu u formua kjo perandori, e cila, nën komandën e tij, prej vitit 1144 deri në vitin 1147, do ta shkatërronte deri në themele dinastinë qeverisëse të murabitëve, ndërsa prej vitit 1145 e deri në vitin 1150 ushtria e tij do të çlironte tërë pjesën myslimane të gadishullit spanjoll. Pas kësaj, çlirimet e tij do të zgjeroheshin në Algjeri, Tunizi dhe Tripoli, duke bërë të mundur që i tërë bregdeti i Atlantikut, deri në Egjipt, së bashkë me Andaluzinë, të bashkohej në një perandori.

5. Po aty, f. 12.

6. Po aty, f. 12.

Pas vdekjes së Abdul-Mu'minit, në fron ishin ndërruar pasardhësit e tij, nga të cilët më i njohuri ka qenë Ebu Jusuf Jakub El-Mensur (1184-1199). Pas ardhjes në pushtet të djalit të tij Muhammed En-Nasirit, në vitin 1212, kishte ndodhur beteja gjykuese në lindje prej Kordobës, e quajtur El-Ukab, në të cilën, aleatët e të krishterëve, me në krye Alfonsin VIII, i kishin shkaktuar humbje të madhe ushtrisë myslimane, pas së cilës pasoi edhe rënia e dinastisë së muehidëve. Spanja ndodhej në gjunjë para pushtuesve. Kordoba ra në vitin 1236, kurse Sevilja në vitin 1248. Dy shekuj pas kësaj vijmë deri te dobësimi i Grënadës, në të cilën kishte qeverisur dinastia e Nasridëve, si pasojë e grindjeve dhe kacafytjeve të emirëve të tyre, e që e përshpejtoi rënien e shpejtë të Grënadës në vitin 1492. Pas kësaj, qeverisja e myslimanëve në Spanjë mori fund dhe pasoi me largimin e myslimanëve nga Gadishulli, ndërsa popullata e mbetur u asimilua dhe konvertua me dhunë.⁷

Në Egjipt dhe Siri myslimanët po ashtu kishin zhvilluar luftëra kundër ushtrive të kryqëzatave. Të udhëhequr nga udhëheqësi ushtarak Salahuddin Ejjub (1138-1193) myslimanët i shkaktuan humbje të rënda ushtrisë franceze. Në vitin

1187 u çlirua Tiberijada dhe, po në të njëjtin vit, pas luftës në Hittin, u çlirua edhe Kudsi (Jerusalemi i sotëm). Nga fundi i vitit 1189, francezët gati sa nuk ishin dëbuar nga territori i shtetit të tyre. Menjëherë pas kësaj, sundimtarët e Evropës perëndimore u bashkuar dhe e dërguan “ushtrinë e tretë të kryqëzatave” (1189-1192), që rezultoi në rikthimin e qyteteve që kishte çliruar Slahuddini, nën pushtetin e sundimtarëve francezë, duke përfshirë edhe Kuds (Jerusalemin e sotëm).

Konfliktet e para mes francezëve dhe myslimanëve kanë ndodhur në tokën egjiptiane, gjatë kohës së sundimit të El-Kamil Muhammed (1218-1238). Në luftën kundër francezëve, nga viti 1219 deri në vitin 1221, El-Kamili e kishte çliruar Dimjatin, të cilin e kishin zënë më herët.

Kur në fron erdhi pasardhësi i El-Kamilit, Es-Salih Nexhmud-din Ejjub (1240-1249) mbreti francez Louis IX dërgoi “ushtrinë e gjashtë të kryqëzatave” duke e marrë përsëri Dimjatin. Synimin e kryqtarëve për marrjen e Egjiptit e ndaloi murtaja, e cila e shkatërroi ushtrinë franceze në prill të vitit 1250.

Pas vdekjes së Es-Salihut, në vitin 1249, qeverisja kaloi në duart e memlukëve. Memluku i katërt Malik Edh-Dhahir Bejparsi (1260-1277) e filloi serinë e luftërave të cilat i dhanë goditjen vendimtare qëllimeve kryqtare. Përveç kësaj, është meritë e

7. Më shumë për ndodhitë e përmendura shih: Filip Hiti, *Istoria Arapa od najstarijih vremena do danas*, Veselin Maslesa, Sarajevë, 1988, f. 493-497.

Bejarsit që Mongolët nuk arritën të depërtojnë në Egjipt dhe ta merrnin atë, duke pasur parasysh disfatën e rëndë që iu shkaktoi tek Ajni Xhalutë, me 3 shtator 1260.⁸

3. Ambienti shkencor i periudhës së Kurtubiut

Jeta kulturore dhe shkencore në Andaluzi përjetoi zgjerim në kohën e shtetit të muehidëve (514-668 v.h.). Kjo është periudha e lindjes dhe arritjes kulmore fizike, shpirtërore dhe intelektuale të Kurtubiut.

Muhammed b. Tumart (1078-1130), themeluesi i dinastisë së muehidëve dhe dijetar i njohur i asaj kohe, u përpoq për ngjalljen e lëvizjes shkencore, duke përkrahur të gjitha aktivitetet shoqërore të cilat nxisnin zhvillimin e shkencës dhe jetës kulturore në përgjithësi.⁹ Të njëjtin qëndrim kanë mbajtur edhe pasardhësit e tij politikë e shtetërorë. Posaçërisht kanë qenë të interesuar për zhvillimin e gjuhës arabe, letërsisë dhe poezisë. Kanë themeluar shkolla, biblioteka, institute dhe universitete, kurse mbledhja e koleksioneve private të dorëshkrimeve të vlefshme, dokumenteve dhe librave, ka qenë fiksism si i elitës qeveritare, ashtu edhe i njerëzve të thjeshtë. Janë

zgjeruar dhe përhapur shkenca të ndryshme, siç janë: tefsiri, e drejta islame, hadithi, kiraetet, gramatika e gjuhës arabe, stilistika, letërsia, poezia, historia, filozofia, etj. Shumë emra të dijetarëve të asaj kohe duhet të përmenden, si Davud b. Sulejman El-Ensariu (522-621 h.) dhe Muhammed b. Muhammed El-Jahsabi (561-631) nga fusha e hadithit; Muhammed b. Abdullah El-Abderij (vdiq në vitin 567 h.) dhe Ebu Bekr Muhammed b. Ahmed El-Andalusij (vdiq në vitin 599) nga tefsiri; Ahmed b. Alij El-Ensarij, i njohur si El-Hassar (vdiq në vitin 609 h.) dhe Muhammed b. Hasan b. Halef El-Ensarij, i njohur si Ibnul-Haxh (vdiq në vitin 609 h.) nga kiraeti; Is'hak b. Ibrahim El-Xhaberij (vdiq në vitin 609 h.) dhe Muhammed b. Muhammed b. Seid El-Ishbilij, i njohur si Ibn Zerkun (vdiq në vitin 621 h) nga fikhu; Muhammed b. Alij b. Harufa (vdiq në vitin 609) dhe Abdullah b. Muhammed b. Sa'dun El-Ezedij (vdiq në vitin 622 h.) nga linguistika arabe; Ebu Bekr b. Tufejl (vdiq në vitin 581 h.) dhe Ebul-Uelid b. Rushd (vdiq në vitin 594) nga filozofia, e shumë të tjerë.¹⁰

Kur Kurtubi u vendos në Egjipt, në pushtet ishte dinastia Ejjubije. Biografët i karakterizojnë prijësit e kësaj dinastie si njerëz të virtyteve morale dhe shumë të interesuar për shkencën dhe

8. Po aty, f. 583-590.

9. Muhammed Uthman, *Asr el-murabbitin ue el-muhabiddin fi el-Magrib uel-Andas*, Laxhnetu et-te'lif ue et-terxhume ue en-neshr, Kajro, pa vit botimi, f. 65.

10. Shih: *El-Kurtubi ue menbexhubu fi et-tefsir*, op. cit., f. 65-81.

letërsinë. Vetë Salahuddin Ejjubi ishte dashamirës i shkencave islame. Së bashku me fëmijët e tij ai i vizitonte xhamitë në të cilat mbanin ligjëratat dijetarët më të shquar të kohës. Pasardhësit e tij, si El-Aziz Uthmani (vdiq në vitin 595 h.) dhe El-Kamil Muhammed b. Melik El-Adil (vdiq në vitin 635 h.), janë interesuar për të drejtën islame, hadithin, gramatikën e gjuhës arabe dhe disiplina të tjera shkencore. Kanë ndërtuar xhami, shkolla dhe biblioteka me qëllim që të avancohej jeta fetare, arsimore dhe kulturore në shtet. E njëjta gjendja ka vazhduar edhe në kohën e sultanëve Memlukë të cilët kanë qeverisur në Egjipt pas dinastisë Ejjubije.

Prej dijetarëve të asaj periudhe mund të përmendim: Ebul-Hattab Umer b. Hasan El-Andalusij (vdiq në vitin 633 h.) dhe Zekijuddin Abdul-Adhim El-Mundhirij (vdiq në vitin 656 h.) nga hadithi; Ibnul-Munir Ahmed b Muhammed (vdiq në vitin 683 h.) dhe Ebu Abdullah Muhammed b. Sulejman El-Mukaddesi El-Hanefij (vdiq në vitin 608 h.) nga tefsiri; Ebu Umer Uthman b. Umer El-Malikij, i njohur si Ibnul-Haxhib (vdiq në vitin 646 h.), dhe Ebu Muhammed Abdullah b. El-Barrij El-Mukaddesij El-Masrij (vdiq në vitin 582 h.) nga linguistika arabe; Ebu Muhammed El-Kasim b. Firruh Esh-Shatibij (vdiq në vitin 590 h.) dhe Ali b. Muhammed Es-Schauij (vdiq në vitin 643 h.) nga kiraeti; Ebul-Hassan Alij b. Muhammed, i njohur si Ibnul-Ethir (vdiq në vitin

630 h.) dhe Abdurrahman b. Ismail El-Mukaddesij (vdiq në vitin 665 h.) nga historiografia, etj.¹¹

Ishte kjo kohë e shfaqjes së veprave të ndryshme të shkruara, enciklopedive dhe arritjeve shkencore nga fusha të ndryshme. Në këtë periudhë edhe Kurtubiu e shkroi komentimin e madh të Kur'anit *El-Xhami' li 'abkami'l- Kur'an*.

4. Veprimtaria shkencore e Kurtubiut

Dr. Muhammed Husejn Edh-Dhehebi, në veprën e tij *El-Xhami' li 'abkami'l- Kur'an*, thotë për Kurtubiun: “Ka qenë - Allahu e mëshiroftë - rob i mirë i Allahut, dijetar i shquar, i pa interesuar në jetën e kësaj bote, i merakosur me brenga të Ahiretit, i matur në fjalët dhe qëndrimet e tij; ecte në të njëjtat rroba, kurse në kokë mbante sarëk; jeta e tij ishte e mbushur me ibadet dhe krijimtari shkencore; njerëzve u la vepra shumë të vlefshme...”¹²

Historiani i mirënjohur mysliman, biograf dhe dijetar i hadithit, Shemsuddin Edh-Dhehebi, duke e lavdëruar Kurtubiun, shprehet: “Imam Kurtubiu zotëronte dituri të respektueshme dhe aftësi gjithëpërfshirëse shkencore.”¹³

11. Po aty, f. 83-98.

12. Dr. Muhammed Husejn edh-Dhehebi, *Et-Tefsir uel-mufessirun*, Mektebetu el-Uehbeti, Kajro, bot. IV, 1989, vëll. II, f. 437-438.

13. Cituar sipas: Muhammed b. Alij Ed-Davudi, *Tabekat el-mufessirin*, Daru el-kutub

Edhe pse për figurën morale dhe shkencore burimet biografike nuk paraqesin kurrfarë hollësie, për aktivitetin e tij kërkimor afatgjatë dhe erudicionin e theksuar shkencor flasin mjaftueshëm veprat e tij shkencore, të cilat ofrojnë një kontribut të madh për zhvillimin e shkencave islame.

Vepra më e rëndësishme e Kurtubiu gjithsesi është komentimi i tij i Kur'anit. Emërtimi i plotë i kësaj vepre është: *El-Xhami' li 'abkamil'-Kur'ani uel-mubejjin lima tedammenehu mines-sunneti ue ajil-Furkan*. Përveç *Tefsirit*, Kurtubiu shkroi edhe këto vepra:

1. *Et-Tedhkire fi abualil-menta ue umuril-abire*, e njohur edhe me emërtimin *Et-tedhkire el-Kurtubijje*. Në literaturën e shumë historike dhe biografike, Kurtubiu është i identifikuar me pseudonim Sahibu-Tedhkire. Në të Kurtubiu përmbledhi transmetime tradicionale për tema eskatologjike, siç janë vdekja dhe jeta pas vdekjes, parashenjat e Ditës së Gjykimit dhe shfaqja e saj, Xheneti dhe Xhehenemi, etj. Vepra përmban shumë kapituj; secili kapitull përmban pjesën e veçantë në të cilin shpjegohen çështjet e paqarta dhe më pak të njohura. Në *Tefsirin* e tij Kurtubiu përdor shpesh citate nga kjo vepër.

2. *Et-Tidhkar fi efdalil-edhkar*. Në të Kurtubiu flet për vlerat e të mësuarit dhe të dëgjuarit të Kur'anit, el-ilmijje, Bejrut, pa vit botimi, vëll. II, f. 69.

për mënyrën e shqiptimit të saktë të tij, për vërtetet e atyre që praktikojnë dispozitat e tij, etj. *Et-Tidhkar* është e konceptuar në dyzet kapituj, është botuar dhe shpërndarë.

3. *Kitabul-Esna fi Sherhi Esmail-labi el-Husna*. Libri përmban 41 pjesë për emrat e bukur të Allahut dhe dispozitat në lidhje me ta, pastaj katër pjesë në të cilat Kurtubiu polemizon me mbrojtësit e *et-Texhsimit* dhe *et-Teshbihut*. Në *Tefsirin* e tij shpesh i drejton lexuesit në shtjellime të përmbajtura në këtë libër.

4. *El-Misbah fi el-xhem'i bejne el-ef'al ue es-sibah*. Libër për linguistikën arabe në të cilin Kurtubiu bashkoi librin *El-Ef'al* të Ibnul-Katta'as dhe fjalorin *Es-Sibah* të El-Xheuhierut.

5. *El-Ilam bima fi din en-nesara minel-mefasidi uel-euham ue idh'har mehasin din el-islam*. Vetë titulli flet për përmbajtjen e kësaj monografie. Në të në mënyrë krahasuese, nga pikëpamja e parimeve të besimit islam, paraqiten idetë e gabuara të cilat janë të pranishme në doktrinën fetare të krishterë.

Përveç atyre që u përmendën, Kurtubiu është autor edhe i veprave të mëposhtme:

- *El-Muktebes fi sherh Muata' Malik b. Enes*,

- *Menhexbul-ibad ue mebachxhetu es-salikin ue ez-zuhad*,

- *El-Lumeu el-lu'lujje fi sherh el-isbrinat en-nebeuijje*,

- *El-Ilam fi menlid el-Mustafa*, s.a.v.s.,

- *El-Urxhuze*,
- *Sherh et-Tekassi*,
- *Risale fi el kabil-hadith*,
- *Et-Takrib li kitab et-Temhid dhe*
- *Ihtisar et-Temhid*.

5. Koncepti komentues i Kurtubiu

Kurtubiu, në tefsirin e tij, fokusohet në aspektin normativ të tekstit kur'anor, por, duke marrë shembull nga paraardhësit e tij, Ibn Atijeh, Et-Taberi, Mekij b. Ebi Talib, etj., është marrë edhe me disiplina të tjera të komentit, si: kiraetet, shkaqet e zbritjes së Kur'anit, poezia arabe, hadithi, semantika e Kur'anit dhe gramatika e stilistika arabe. Kjo do të thotë se Kurtubiu i përkiste atyre mufesirëve të cilët, në tefsirin e tyre, anonin drejt harmonizimit të qasjes tradicionale dhe racionale të komentimit të Kur'anit. Tradita kishte shërbyer si “busull” në qëllime të ndryshme dhe si burim i çmuar i qëllimeve komentuese, kurse ana racionale kishte dhënë impuls të çmuar në të kuptuarit e hapur, të gjerë dhe të detajuar të tekstit kur'anor.

Në planin tradicional, Kurtubiu diku kënaqet me citimin e haditheve të Pejgamberit (a.s.), duke mos hyrë në komentim; ndonjëherë, krahas haditheve, përmend mendimet e tabiinëve, duke preferuar tekstin e hadithit si argument të pakundërshtueshëm në përfitim të normave juridike dhe caktimin e

kuptimit juridik të fjalës tematike ose të ajeteve. U përpoq, kur ajo ishte e mundur, për të harmonizuar mendime të ndryshme të komentuesve, duke zbuluar kuptimin e lidhjes së përbashkët të tyre, e cila, në bazë të kriterëve të përcaktuara, kishte argumentim më të fortë.

Sa i përket komentimit racional, Kurtubiu mendonte se me koment mund të merret çdo person që përmbush kritere të përgjithshme siç janë, p.sh., njohja e disiplinave pa të cilat nuk mund të kuptohet drejtë mesazhi Kur'anor. Për të vërtetuar saktësinë e qëndrimit të tij, Kurtubiu bazohet në ajete që nxisin njerëzit drejt kuptimit, të menduarit dhe mësuarit të Kur'anit. Një nxitje e tillë do të ishte absurde, mendon Kurtubiu, nëse do të gjykohej interpretimi i mesazhit kur'anor të bazuar në njohjen njerëzore. Përmbajtja e disa sahabëve krahas interpretimeve të kuptimeve të tekstit kur'anor nuk është e detyrueshme për myslimanë të tjerë, posaçërisht nëse kihet parasysh se shumë prej sahabëve dhe tabiinëve, me diturinë, kuptimin dhe komentimin e tyre të Kur'anit, ishin ndriçues të njerëzve, duke zbuluar mesazhet dhe kuptimet e tij. Nëse kuptimi i mesazheve kur'anore do të kufizohej në atë që është thënë në transmetimet nga Pejgamberi (a.s.) dhe sahabët e tij, kjo do të thotë se askush nuk ka të drejtë të flasë rreth Kur'anit përveç asaj që ka dëgjuar dhe

lexuar. Komentimi racional mund të kontestohet në dy raste: Rasti i parë - kur komentimi i Kur'anit është paracaktuar me qëndrime njerëzore, paragjykime, nevoja dhe qëllime ideologjike, siç është rasti i shumë lëvizjeve ideologjike dhe sekteve fetare, ndërsa rasti i dytë - kur komentimi i Kur'anit bazohet në kuptimin sipërfaqësor gjuhësor, pa pasur parasysh transmetime tradicionale në lidhje me komentimin e fjalëve kur'anore jo normale dhe vështirë të kuptueshme, ose pa njohje të stilit të shprehjes kur'anore siç është: thukëtia, përmbysja e fjalëve, rënia e fjalive kuptimi i të cilave nënkuptohet, etj. Para së gjithash, komentimi i Kur'anit duhet patjetër të fillojë me transmetim, aty ku është e domosdoshme, me qëllim të shmangies së gabimeve dhe lëshimeve të mundshme në interpretimin e kuptimeve. Më pas, hapet mundësia për *ixhtihadin* njerëzor. Janë të shumta fjalët kur'anore të cilat nuk mund të kuptohen në mënyrë të drejtpërdrejtë pa transmetim, kështu që nuk duhet të anohet drejt komentimit ezoterik (të brendshëm) para se të shqyrtohet ana ekzoterike (e jashtme) e tekstit kur'anor, shpjegon Kurtubiu.¹⁴

Kurtubiu, në tefsirin e tij, në mënyrë të vazhdueshme është marrë me analizën gramatikore dhe semantike të fjalëve kur'anore, duke

i kombinuar qëndrimet linguistike të Basrës dhe Kufës. Është përpjekur që, parimet gramatikore, t'i argumentojë me vargje të poezisë arabe, pastaj me tekste kur'anore, e aty-këtu me tekste të hadithit, duke mos hyrë në hollësi të analizës gramatikore të fjalive të plota dhe natyrës së tyre stilistike.

Krahas analizave gramatikore, Kurtubiu trajtoi edhe kiraetet, duke shpjeguar aspektin morfologjik, sintaksor ose semantik të divergjencës së tyre.

Te komentimet juridike, Kurtubiu përdori të gjitha instrumentet në dispozicion të tefsirit, duke përfshirë analizën gramatikore të fjalëve të caktuara në ajete tematike, si dhe rikonstruksionin sintaksor në dritën e aplikimeve të ndryshme të kiraeteve.

Përfundim:

El-Xhami'u i Kurtubiut, pa kurrfarë dyshimi, bën pjesë në arritjet më të rëndësishme në kulturën dhe historinë e përgjithshme. Rëndësi e veçantë e këtij tefsiri, përveç atyre që kemi përmendur në këtë punim, është edhe mundësia e ofrimit të prezantimit të përmbajtjes së tij. Komentimet janë të ndara në të ashtuquajtura *mes'ele* (çështje, pyetje tematike). Numri i *mes'eleve* (ndonjëherë mbi njëzet) është i renditur sipas përmbajtjes dhe mesazhit të ajetit. Në një *mes'ele*, për shembull, shqyrtohet aspekti gramatikor i ajetit tematik, në tjetrën

14. Shih: *El-Xhami' li abkam el-Kur'an*, op. cit., vëll. I, f. 47-50.

ai normativ, në të tretën semantik, në të katërtën ai i kiraetit, në të pestën ai i besimit, në të gjashtë të tradicional, etj. Çdonjëri nga këto aspekte, të cilat shfaqen në tefsirin e Kurtubiut, paraqet fushën e posaçme shkencore me rëndësi për kërkim shkencor. Do të përmendim se aspekti i kiraetit të Tefsirit të Kurtubiut ka

qenë temë kërkimore e temës sonë të disertacionit me titull: *Kiraetet në tefsirin El-Xhami' li 'abkamil-Kur'an*. Besoj dhe shpresoj që ky lloj studimi të jetë lëndë e interesimit të hulumtuesve tanë të ri.

Përktheu nga gjuha boshnjake:

Dr. Azmir Jusufi, Prizren

100 vjet nga Themelimi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Abstrakt

Shpallja e pavarësisë i gjeti udhëheqësit e dijetarët myslimanë shqiptarë në krye të momenteve historike të vendit tonë dhe ishin pikërisht këta prijës, të cilët do të unifikonin institucionet islame në vendin tonë nëpërmjet zhvillimit të disa kongreseve kombëtare. Kështu, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë u themelua nga rilindës dhe firmëtarë të pavarësisë, si një bashkësi që do të përfaqësonte zërin e besimtarëve myslimanë në Shqipëri, trojet shqiptare, madje, në mjaft raste, edhe zërin e mbarë shqiptarëve.

Për të pasur një përfytyrim më të saktë rreth marrëdhënieve fetare midis Shqipërisë dhe Kalifatit Osman, e sidomos rreth procesit të mëvetësisë së xhamisë shqiptare, është e nevojshme që të hedhim një vështrim retrospektiv, sepse ky proces në të vërtetë ka nisur shumë më herët nga kongresi i parë i myslimanëve.

Ai që shënoi edhe pikënisjen drejt institucionalizimit të Bashkësisë Islame, ishte Kongresi i Parë i mbajtur më 24 shkurt deri më 12 mars 1923, që hodhi edhe themelet në formimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Qysh prej asaj kohe, besimtarët myslimanë shqiptarë do të përfaqësoheshin vetë dhe do t'i dilnin vetë për zot përhapjes e ruajtjes së traditës së bukur të besimit Islam.

Lëvizjet e para për Mëvetësinë e Xhamisë Shqiptare

Për të pasur një përfytyrim më të saktë rreth marrëdhënieve fetare midis Shqipërisë dhe Kalifatit Osman, e sidomos rreth procesit të mëvetësisë së xhamisë shqiptare, është e nevojshme që të hedhim një vështrim retrospektiv, sepse ky proces në të vërtetë ka nisur shumë më herët nga kongresi i parë

i myslimanëve. *De facto* ai është kryer më 28 nëntor 1912, atëherë kur Shqipëria u shkëput përfundimisht nga Perandoria Osmane. Kështu, krahas Shpalljes së Pavarësisë dhe formimit të qeverisë së Ismail Qemalit, Kuvendi Kombëtar i Vlorës caktoi në krye të Senatit, hoxhën dhe patriotin Haxhi Vehbi Dibra, i cili do të mbante njëkohësisht edhe detyrën e Kryemyftiut të Shqipërisë.

Shpalljen e Pavarësisë më 28 nëntor 1912 sinjë akt politiko-historik për shqiptarët, do ta përshëndeste në cilësinë e kryetarit të senatit të parë shqiptar dhe kryemyftiut të vendit H. Vehbi Dibra (Agolli)¹, firmëtar i deklaratës së pavarësisë, i cili sipas sheriatit, dha fetvanë e njohur për Shpalljen e Pavarësisë dhe për flamurin. Me këtë fetva, ai legjitimoi fetarisht pavarësinë dhe i mbylli rrugën deformimeve e ligësive antikombëtare.

Për organizimin e brendshëm të fesë islame, qeveria e Vlorës aplikoi status kuonë e trashëguar, por duke likuiduar *de facto* varësinë institucionale nga Shejhul Islami me qendër në Stamboll, dhe, për herë të parë, Shqipëria kishte Myftiun e vet të Përgjithshëm, të emëruar nga qeveria shqiptare. Administrata fetare u ndërtua nën shembullin e asaj shtetërore, prefekturës i përgjigjej myftinia, nënprefekturës-nëmyftinia, etj. Kjo administratë ishte nën varësi të qeverisë.

Menjëherë pas marrjes së detyrës në maj të vitit 1913, Haxhi Vehbi Dibra filloi një veprimtari intensive për organizimin dhe reformimin e institucioneve të bashkësisë islame, të institucioneve të kadilerëve e myftilerëve, të rolit e detyrave të tyre, të ngritjes e organizimit të sherive, etj. Këto probleme ai arriti t'i bëjë

1. Qazim Xhelili, *Vehbi Dibra-personalitet dhe veprimtar i shquar i Lëvizjes Kombëtare*, Tiranë: albin 1998.

objekt diskutimi e trajtëse edhe në mbledhjet e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës.²

Kur analizojmë rrugën që ka ndjekur procesi i realizimit të mëvetësisë së Komunitetit Mysliman Shqiptar, duhet theksuar se pas vitit 1912 ai nuk ka pasur më asnjë kontakt zyrtar me Kalifatin Osman. Në fondin e Komunitetit Mysliman që gjendet në Arkivin Qendror të Shtetit, të paktën deri tani, nuk është gjetur qoftë edhe një dokument që të dëshmojë lidhjet me Shejhul Islamin në Stamboll.³

Duhet theksuar se, për shkak të rrethanave politike që u krijuan në këtë periudhë, nuk pati ndonjë veprimtari konkrete për organizimin dhe strukturimin e Bashkësisë Islame. Në kohën e qeverisë së Princ Vidit (1914), Komuniteti Mysliman në Shqipëri ishte po aq sovran sa edhe Komuniteti Mysliman në Bosnje-Hercegovinë, Bullgari, Rumani dhe Greqi. Në krye të strukturës myslimane qëndronte kryemyftiu, i cili ishte njëkohësisht prijësi i të gjithë ulemave dhe i administratës së sheriatit.

Formimi i Gjyqit të Naltë të Sheriatit

Në tetor të vitit 1916, me urdhër të komandës ushtarake austro-hungareze, u formua në Shkodër

2. Qazim Xhelili, *Vehbi Dibra-personalitet dhe veprimtar i shquar i Lëvizjes Kombëtare*, po aty, f. 200.

3. Qazim Xhelili, po aty, f. 204.

Gjyqi i Naltë i Sheriatit i përbërë nga Myftiu i Përgjithshëm H. Vehbi Dibra dhe dy anëtarë, kryesekretari dhe dy shkrues.⁴ Në vitin 1917, komanda ushtarake austro-hungareze miratoi “Parashkresën e përkohshme për organizimin e Sherisë në Shqipëri”⁵, e cila përbëhej nga 43 nene dhe deri në vitin 1923 luajti rolin e një statuti. Sipas Parashkresës në krye të bashkësisë islame dhe të organizimit të Sherisë ishte Myftiu i Përgjithshëm. Nën kryesinë e tij ishin të gjithë hoxhallarët dhe gjyqtarët e sherisë, sikurse dhe të gjithë zyrtarët e tjerë. Myftiu i Përgjithshëm kishte drejtimin dhe kontrollin e epërm mbi të gjitha çështjet e myslimanëve dhe të instituteve bamirëse dhe të arsimit të myslimanëve. Bashkë me Myftiun e Përgjithshëm, pranë tij si ndihmës qëndronin dhe dy ulema. Këta të dy, bashkë me Myftiun e Përgjithshëm përbënin Këshillin e Naltë ose Gjyqin e Naltë të Sheriatit. Ky Këshill ishte shkalla më e lartë për çështjet e besimit dhe të gjyqësisë. Ai kishte të drejtë të zgjidhte gjyqtarët e sherisë, imamët, hatibët,

hoxhallarët në përgjithësi, mësuesit e besimit dhe nëpunësit e tjerë. Në Parashkresë përcaktoheshin edhe detyrat e Myftiut të Përgjithshëm dhe të Këshillit të Naltë të Sheriatit, të myfti-kadive, të naibëve, të vaizëve, etj.⁶

Në bazë të nenit 9 të kësaj rregulloreje, gjykatat e sheriatit, që ishin nën drejtimin e një myfti-kadiu, quheshin gjykata të shkallës së I, ndërsa ato që ishin nën drejtimin e një naibi, gjykata të shkallës së II. Në marrëveshje me Këshillin e Naltë të Sheriatit, komanda ushtarake austro-hungareze, për t’i kontrolluar më lehtë të gjitha çështjet e kultusit islam, bashkoi postin e kadiut me atë të myftiut dhe ngriti gjykata në të gjitha kryeqendrat e qarqeve. Gjykata sheriatit u ngritën në Shkodër, Tiranë, Elbasan, Berat Lezhë, Pukë, Krujë, Mat, Durrës, Shijak, Kavajë, Peqin, Lushnjë, Gramsh, Fier, Ballsh, Skrapar, Peshkopi, Lumë, Gorë, Has dhe Krasniq.⁷

Në sajë të kujdesit të H. Vehbi Dibrës, puna për organizimin e sherive dhe vakfeve në Shqipëri kishte shënuar hapa

4. AQSH, fondi 882, viti 1917, dosja 19, fleta 30, Urdhër i Komandës Ushtarake Austro-Hungareze; Arkivi i Institutit të Historisë, Materiale të Arkivit të Vjenës, viti 1916, dosja 116, dok. 2189, f. 735.

5. Rregullore provizore e organizimit të çështjeve të sheriatit në Shqipëri, Shkodër, 25 qershor 1917. Kjo rregullore u botua edhe në formën e një broshure nën emërtesën “Parashkresë e përkohshme për organizimin e Sherisë në Shqipëri”, Shkodër 1917.

6. Hasan Bello (Dr.) *Shkëputja e Shqipërisë nga Kalifati Osman dhe përpjekjet për pavarësinë e xhamisë shqiptare*, revista “Zani i Naltë”, nr. 15 (168), janar, shkurt, mars, 2016, viti i IV (XVIII) i botimit, f. 83-84.

7. Hasan Bello (Dr.) *Roli i Austro-Hungarisë për organizimin e institucioneve të fesë islame në Shqipëri në vitet 1916-1918*, revista “Zani i Naltë”, nr. 3 (156), prill, maj, qershor, 2013, viti i II (XVI) i botimit, f. 46-47.

të rëndësishëm. Sipas raporteve administrative të Korparmatës XIX, dërguar Vjenës më 14 qershor 1918, rezulton se organizimi i gjyqeve të sheriatit kishte kohë që kishte përfunduar dhe se ato, në pjesën më të madhe të vendit, ishin bërë tani një institucion i njohur që çmohej e respektohej nga popullsia.⁸

Në këtë kohë, Komuniteti mbante emrin Gjyqi i Naltë i Sheriatit dhe përbëhej prej një Këshilli të Naltë të Sheriatit me pesë anëtarë, në krye të të cilëve qëndronte Myftiu i Përgjithshëm. Këshilli i Naltë zgjidhej për pesë vjet, ndërsa Kongresi studionte veprimet fetare dhe financiare të Këshillit të Naltë e të qarqeve. Vartësit e Këshillit të Naltë të Sheriatit ishin: 1) Myftinj të qarqeve; 2) Sekretarët e vakfeve, që merreshin me administrimin e të ardhurave vakfnore, 3) Sekretarët e sherisë, të cilët merreshin me martesat, shkurorëzimet, etj. 4) Mytevelijtë (administratorët), që administronin dhe kujdeseshin për mirëmbajtjen e pasurive vakfnore dhe të faltoreve. Detyra e Këshillit të Naltë të Sheriatit ishte emërimi i myftinjve dhe i klerikëve të tjerë, si: imamë, vaizë, myderrizë, si dhe emërimi i sekretarëve të qendrës dhe të qarqeve. Këshilli i Naltë kontrollonte veprimet e myftinjve dhe të administratës financiare, në krye të së cilës qëndronte një drejtor vakfi. Para Kongresit të 1923 kjo

8. Arkivi i Institutit të Historisë. Materiale të Arkivit të Vjenës, dosje 28 - 68.

administratë ishte Drejtori e veçantë pranë Ministrisë së Financave.⁹

Përdorimi i gjuhës shqipe në institucionet islame

Me interes në këtë periudhë është dhe një qarkore e Myftiut të Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra, që u dërgon të gjithë Kryetarëve të Gjyqeve të Sheriatit. Ai i urdhëroi ato se duke qenë se Shqipëria ishte një shtet i pavarur dhe nuk kishte ndonjë lidhje shtetërore me qeverinë osmane, lutjet të mos bëheshin në turqisht, por në gjuhën e besimit mysliman dhe sultani të mos përmendej më si mbret i Shqipërisë. *“Tue qenë që sot Shqipëria asht një shtet në vedi e nuk ka ndonji të përpyjekun shtetnuer me qeverinë turke, të lutunat duhen ba në gjuhë të besimit mysliman d.m.th. arabisht, e edhe Naltmadhnija e Tij Sulltani duhet përmend si halifja i myslimanvet e jo, sikurse në kohë të Turkis si Mbret i vendit.”*¹⁰

Sipas nenit 18 të “Parashkresës...”, ligjëratat në xhami duhet të mbaheshin në shqip dhe arabisht, t’u përgjigjeshin nevojave të kohës dhe urdhrave të qeverisë. Vendimeve gjyqësore duhej t’u ngjitej përherë edhe një shkurtim në gjuhën shqipe.¹¹

9. AQSH, fondi 482, viti 1917, dosja 5; Ali M. Basha, *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë 2011, f. 23-24.

10. AQSH, fondi 482, viti 1917, dosja 39, fleta 23. Urdhër i Kryemyftiut të Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra, dërguar sherive të vendit, 26.06.1917.

11. Hasan Bello (Dr.) *Roli i Austro-Hungarisë për organizimin e institucioneve të fesë islame në*

Përdorimi i gjuhës shqipe në institucionet e fesë islame ishte një detyrë që Këshilli i Naltë i Sheriatit i kishte vënë vetes për të futur elementet kombëtare në administrimin e fesë. Këshilli i Naltë i Sheriatit ngulte këmbë që të gjithë nëpunësit dhe prijësit myslimanë që ishin në shërbim të popullit, ta mësonin gjuhën shqipe me shkrim e lexim dhe ta përdornin atë në kontaktet, predikimet dhe korrespondencën, që mund të kishin në çështjet e përditshme. Kjo kërkesë pasqyrohet në shumë dokumente, si: qarkore, urdhra e udhëzime, dërguar zyra të sheriatit në qarqe, prefektura e nënprefektura dhe shtypit të kohës. “Sot protokollet e zhvillimit të gjyqeve, sipas udhëzimeve të Këshillit të Naltë të Sheriatit mbahen në gjuhën shqipe. Gjithashtu edhe fjalimet dhe kundërfjalimet, paditë, petitionet e palëve, si: lutjet, paditë, ankesat etj., duhet të përpilohen në gjuhën shqipe.”¹²

Prijësit myslimanë shqiptarë, të ndërgjegjshëm për rrugën që duhej ndjekur, nënvizuan si prioritet përdorimin e gjuhës shqipe. Këtu në radhë të parë vlen të theksohet roli i Myftiut të Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra, i cili, më 14 dhjetor 1920, u shpërndau një qarkore tjetër zyra të sherive në prefektura dhe nënprefektura ku i urdhëroi ato se

në të gjitha zyrat e sheriatit, duhet të përdornin gjuhën kombëtare. “Prandaj, jeni të urdhëruem mos me përdorë gjuhën turqishte ndër akte zyrtare, sikurse e kemi përdorë gjer më sot. Nga ky shkak, sekretarët, ashtu dhe shkruesat e gjyqeve sheri, janë të detyruem me ditë gjuhën kombëtare mirë, si me shkrim ashtu edhe me këndim. Veç kësaj, ilameve (shpalljeve) sheri, përherë do t’u ngjitet një shkurtim në gjuhën shqipe”.¹³ Për të përmbushur këtë qëllim, ai njoftoi se, të gjithë nëpunësit do t’i nënshtroheshin një kontrolli nga Gjyqi i Naltë i Sheriatit.

Realizimi i përdorimit të gjuhës shqipe në aktet e institucioneve fetare islame nuk ishte një proces i lehtë, prandaj kjo çështje u ndoq në vijimësi. Insistimi i H. Vehbi Dibrës për këtë çështje ishte i vazhdueshëm dhe këmbëngulës. Kështu, në një korrespondencë me gjyqin e sheriatit të Tiranës, Haxhi Vehbi Dibra shkruante: “Njitun u kthehet shkresa nr. 37, me 21 shkurt 1922, dërgue Gjyqit të Naltë të Sheriatit, si pyetje shkruet në gjuhën turqishte. Meqenëse korrespondenca lypset me e ba në shqipen zyrtare, jeni të porositun për të dytën herë që të mos i sillni këtij gjyqi shkresa të shkrueme në gjuhë të tillë, se nuk do shofin formalitet e duhura”.¹⁴ Në mars të vitit 1921, Haxhi Vehbi Dibra porosiste gjyqin e sherisë së Vlorës që në shkresat dhe aktet

Shqipëri në vitet 1916-1918, po aty, f. 46.

12. Arkivi i Institutit të Historisë. Materiale të Arkivit të Vjenës, dosje 28 - 68.

13. AQSH, fondi 882, viti 1921, dosja 9, fleta 1.

14. AQSH, fondi 482, viti 1922, dosja 7, fleta 3.

zyrtare të mos përdorte vulat turke, por të merrte sa më shpejt që të ishte e mundur një vulë me shqiponjë.¹⁵

Në dokumente rezulton se krahas punës për ndërtimin dhe organizimin e institucioneve dhe të dikastereve të Fesë Islame pas Shpalljes së Pavarësisë, H. Vehbi Dibra i kushtoi vëmendje edhe punës me simbolet e fesë, me qëllim që edhe ato të kishin tipare krejtësisht kombëtare. Këtë e konstatojmë qysh në krijimin e Gjyqit të Naltë të Sheriatit më 1916, për të cilën u përdor një vulë, e cila në fillim ishte e thjeshtë, por që ndryshonte dhe nuk shëmbëllente aspak me vulat e përdorura në kohën e sundimit osman. Ndërsa në vitin 1921, vula do të përsosej dhe do të fitonte tipare të reja kombëtare, si në përmbajtje ashtu dhe në formë, me vendosjen aty të shkabës dy krenare të flamurit tonë kombëtar. Në këtë mënyrë, H. Vehbi Dibra futi praktikisht edhe në institucionet fetare, simbole të marra nga flamuri kombëtar.¹⁶

Në vigjilje të Kongresit të Parë Mysliman

Pas mëvetësimit të teqesë bektashiane dhe përpjekjeve të para të mëvetësisë së kishës ortodokse, u shtrua konkretisht edhe çështja e organizimit fetar të shumicës së shqiptarëve, pra të myslimanëve, mbi baza kombëtare. Shtypi shqiptar

i asaj kohe ishte i vetëdijshëm se domosdoshmëria e marrjes së masave për organizimin e bashkësisë islame të Shqipërisë mbi baza kombëtare dhe sa më përparimtare, kushtëzohej nga pozita gjeopolitike e vendit tonë: “Një ndryshim të tillë, - shkruhej ato ditë nëpër faqet e tij, - neve shqiptarët duhet ta ndjejmë më shumë për nevojë, sesa turqit; se duhet të marrim parasysh që ndodhemi në mes të Evropës dhe nuk mund të qëndrojmë indiferentë përpara ndryshimeve sociale, se është frika që armonia qytetnore na hedh jashtë rrethit të saj dhe kështu fati ynë do të qëndrojë në errësirë dhe demoralizim.”¹⁷

Mbledhja e një kongresi të myslimanëve të Shqipërisë ka qenë dëshirë konsensuale e shprehur vazhdimisht nëpër qarqet islame. Për mënyrën e organizimit të këtij kongresi ka pasur mendime të ndryshme dhe është bërë edhe një lloj përgatitje nga vetë prijësit myslimanë. Por çështja u shty për shumë shkaqe, vendi ishte i okupuar, nuk gjendej zgjidhje ekonomike për zhvillimin e punimeve të Kongresit, po ashtu, edhe për probleme të tjera si: zgjedhja e delegatëve, koha, vendi, etj.

Nismëtarët, organizatorët dhe pjesëmarrësit e Kongresit qenë veprimtarë të dalluar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në periudhën e fundit të sundimit osman. Ata kishin

15. AQSH, viti 1921, dosja 14, fleta 2.

16. Ali M. Basha, *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)*, f. 27.

17. Gazeta “Zëri i popullit”, (gazetë politike, ekonomike dhe letrare), viti I, nr. 28, 21.3.1923.

marrë pjesë aktivisht në lëvizjen për organizimin e klubeve atdhetare, për hapjen e shkollave kombëtare, për përhapjen e mësimit të gjuhës shqipe me alfabetin latin. Për të ilustruar sa u tha më sipër, mjafton të kujtojmë qëndrimin atdhetar dhe të vendosur që Haxhi Vehbi Dibra, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu e të tjerë mbajtën në Kongresin e Dibrës, të vitit 1909. Ata u imponuan qeveritarëve të rinj xhonturq futjen në programin e Kongresit, kërkesa të cilat çonin në sendërtimin e programit autonomist të Rilindjes. Ata u imponuan organizatorëve të Kongresit edhe kërkesën për hapjen e

shkollave shqipe dhe mësimin e gjuhës shqipe me alfabetin që dëshironte populli. Kjo kërkesë e tyre përputhej plotësisht me vendimin e Kongresit të Manastirit.¹⁸

Drejtuesit fetarë atdhetarë të sipërpërmendur, u gjendën në këto pozicione jo vetëm në sajë të atdhetarizmit, por edhe për shkak të formimit të tyre intelektual. Ata përfaqësonin në të njëjtën kohë

18. Gazmend Shpuza (Prof. Dr.), *Kongresi i Parë Mysliman Shqiptar (1923), sanksionim i mëvetësisë së Bashkësisë Islame të Shqipërisë dhe themel i zhvillimit kombëtar dhe bashkëkohor të saj*, revista “Zani i Naltë”, nr. 26 (179), janar, shkurt, mars 2019, viti VII (XXI) f. 75-76.



Fig. 1 Foto nga ceremonia e Kongresit të Parë

personalitete të shquara të kulturës islame. Shumë prej tyre qenë njohës të thelluar të kësaj kulture: të gjuhëve të Lindjes, të filozofisë, të moralit, të së drejtës e, në mënyrë të veçantë, të letërsisë. Me këtë formim ata dëshmuuan një shkallë të lartë vetëdijesimi atdhetar.

KONGRESI I PARË MYSLIMAN

(24 shkurt – 12 mars 1923)

Vitet '20 veçohen për një meritë të dyanshme. Për meritë të Komunitetit Mysliman Shqiptar, i cili, krahas mëvetësimit, kuptoi drejt rolin dhe pozicionin e vet në një shtet multifetar, duke ndërtuar një fizionomi të vetën, ngritur mbi postulatën “Dashuria për atdheun rrjedh nga besimi”. Po ashtu, për meritë të shtetit shqiptar të asaj kohe, i cili në kushte kur i duhej të vetë-ndërtohej, diti t'i hapte rrugë ndërtimit të komuniteteve fetare, të afta për mbijetesë dhe ndërtimit me to të marrëdhënieve të drejta e ligjore, në pozitat e një shteti laik, i cili është i ndërgjegjshëm për vendin dhe rolin e religjionit në ngjizjen e një kombi vital dhe për të cilin të gjitha fetë janë njëloj të respektueshme.¹⁹

Nga gjysma e dytë e dhjetorit 1922, Haxhi Vehbi Dibra, i paraqiti qeverisë për miratim projektin

e statutit të Xhematit Mysliman Shqiptar, për hartimin e të cilit kishte punuar nën kryesinë e tij, një komision i posaçëm i përbërë nga intelektualët më në zë të drejtuesve fetarë.²⁰ Kongresin e parë të vitit 1923, do ta quanin Kongresi i themelimit të Komunitetit apo Bashkësisë Islame, i organizuar nga Gjyqi i Naltë i Sheriatit me ndihmën aktive të qeverisë, duke filluar nga zgjedhja e delegatëve deri te shpenzimet e tyre.

Gjyqi i Naltë i Sheriatit i drejtohet Kryeministrit me një shkresë nr. 51, datë 28.01.1923 dhe e njofton se, meqë e shikon të nevojshme një Këshill të Myslimanizmit (Xhema'ati Islamiye), për të cilin është folur e kërkuar shumë herë verbalisht edhe nga ana e popullit mysliman, ka caktuar që të bëhet një mbledhje për formimin e këshillit në fjalë me 20 shkurt 1923. “Kemi nderin me e lajmerue e me iu lut asaj te Naltes Kryesi me dhane urdhnat e duhura te gjith prefekturave e nenprefekturave per me dergue nga nji perfaqesues te zgjedhun rregullisht nga ana e popullit me anën e Bashkive. Perfaqesuesat e nalt-thanun, te jene te gjith qe te dijn me kendue e me shkrue mire gjuhen zyrtare dhe te jene te ditun. Bashke me kete te

19. Siri Hoxha, *Veprimtaria e Komunitetit Mysliman Shqiptar në vitet '20 të shek. XX, në plan kombëtar e shoqëror*, gazeta “Drita Islame”, nr. 4 (135), shkurt-mars 1998, revista “Zani i Naltë”, nr. 9, tetor, nëntor, dhjetor 2014, f. 122-123.

20. AQSH, fondi 882, viti 1922, dosja 668, fleta 48. Parashtrësë e Myftiut të Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra, dërguar Kryesisë së Këshillit të Ministrave për formimin e Xhematit Mysliman Shqiptar, 16.12.1922.

jene besimtare feje te plote dhe me moral te mire. Mbledhja do te bahet ne Kryeqytet ne vend qe ka me u shenue ku ka marre pjese dhe nje përfaqësues i Qeverise. Me lutje te na lajmerohet përfundimi.”²¹

Këshilli Ministror me vendim nr. 57, datë 29.01.1923 i jep lejen e kërkuar Gjyqit të Naltë të Sheriatit për të bërë mbledhjen e përgjithshme më 20 shkurt 1923 për formimin e Këshillit të Myslimanizmes (Xhema’ati Islamije) e kërkuar shumë herë prej popullit shqiptar mysli-man.²² Kurse Ministria e Punëve të Brendshme njofton me datë 24.02.1923 Gjyqin e Naltë të Sheriatit që si përfaqësues i Qeverisë do të jetë z. Qerim Çelo, sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë.²³

Edhe vetë Gjyqi i Naltë i Sheriatit njofton me telegram prefekturat e nënprefekturat se me 20 shkurt 1923 do të bëhet në kryeqytet një mbledhje e përgjithshme prej delegatëve mysli-manë për formimin e Xhema’ati Islamijes. Me këtë mbledhje çdo prefekturë do të dërgojë një përfaqësi, e cila do të zgjidhet nga përfaqësuesit e krahinave të lagjeve mysli-manë, të cilët do të jenë zgjedhë me anë të pleqësive të tyre dhe pastaj do të votojnë nën kontrollin e bashkive. Delegatët që

do të dërgohen këtu duhet të dinë mirë gjuhën zyrtare shqipe, të jenë besimtarë feje me dijeni të plota, si dhe me moral të mirë. Zgjedhjet të bëhen me një shpejtësi të madhe që t’ia mbërrijë mbledhjes në kohën e caktuar. Çështja e shpenzimeve u njoftohet më vonë.”²⁴

Më 7 shkurt 1923, ministri i Brendshëm, Ahmet Zogu, njoftoi të gjitha prefekturat se, me vendim të Këshillit të Ministrave, i jepej leja Gjyqit të Naltë të Sheriatit për të bërë më 20 shkurt 1923, mbledhjen e përgjithshme për formimin e Këshillit të Myslimanizmes (Xhema’ati Islamijes) të kërkuar shumë herë prej popullit mysli-man.²⁵

Gjyqi i Naltë i Sheriatit u dërgon më vonë letër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bashkisë së Tiranës dhe shoqërisë Djelmnia Dibrane, ku u bën të ditur që mbledhja e planifikuar për datën 20 shkurt do të shtyhet në datën 24 shkurt në orën 09.00, për arsye se disa delegatë nuk arrijnë dot në kohë. Kongresi i filloi punimet në Tiranë, më 24 shkurt 1923, në ndërtesën e shoqërisë “Djelmnia Dibrane”, kryetar i së cilës ishte patrioti Dervish Hima.²⁶

21. AQSH, fondi 482, viti 1923, dosja 4, fleta 2.

22. AQSH, fondi 482, viti 1923, dosja 4, fleta 3.

23. AQSH, fondi 482, viti 1923, dosja 4, fleta 14.

24. AQSH, fondi 482, viti 1923, dosja 4, fleta 6.

25. Libri i Qarkoreve i Ministrisë së Punëve të Brendshme i vitit 1922-1923, Tiranë 1923, nr. 5, f. 222.

26. AQSH, fondi 482, viti 1923, dosja 4, fleta 11. Disa ditë më parë Myftiu i Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra, i dërgonte Dervish Himës një shkresë ku ndër të tjera



Fig. 2 Pamje nga delegatet e Kongresit 1923

Zhvillimi i Kongresit të parë Mysliman Shqiptar

Kongresi u përgatit dhe u hap me fjalën e H. Vehbi Dibrës, kryemyftiu i parë i Shqipërisë, emëruar nga qeveria e Ismail Qemalit menjëherë pas Shpalljes

e njoftonte se: *“Gjyqi i Naltë i Sheriatit, ka pas shpallun për një mbledhje të përgjithshme këtu në kryeqytet prej përfaqësuesve të popullit mysliman, të dërguar nga çdo prefekturë e nënprefekturë. Kjo mbledhje, qe caktuar të hapet me 20 shkurt 1923, por tue mos muejt me mbritë në kohë disa prej delegatëve, u shty dhe u vendos që të hapet me 24 shkurt në orën nëntë, para dite, në ndërtesën e shoqërisë “Djehmnia Dibrane”, e cila kryesohet nga ana e z. suaj. Pra lutemi që ndërtesa në fjalë të stoliset e të rregullohet sikurse duhet, tue caktua posaçërisht vendet e delegatëve, të dëgjuesve, të sekretarisë dhe të përfaqësuesit të qeverisë”*.

së Pavarësisë. Në fakt, pavarësia e xhamisë shqiptare fillon qysh me këtë vendim, me idenë e qeverisë së Ismail Qemalit për ta emëruar vetë kryemyftiun e vendit. Kongresi vetëm do t'i jepte karakter traktateve të kësaj pavarësie. Rishfaqja e H. Vehbi Dibrës në këtë rol, që e kish marrë përsipër që më 1912, si detyrë dhe përgjegjësi kombëtare, shpreh një vijimësi përpjekjesh për një qëllim të lartë. *“Dera e mejtimit të ixhtihadit (pikëpamjeve) nuk asht mbyllun dhe jemi gati për me i mejtue disa çështje fetare, se me ndërrimin e kohës, ndërrojnë edhe gjykimet”*, - u shpreh në fjalën e hapjes H. Vehbi Dibra.²⁷

27. Shaban Sinani (Prof. Dr.), *Pavarësia e xhamisë, 75 vjet nga kongresi që kërkoi një besim islam me fytirë evropiane*, gazeta “Drita

Siç vihet re, një nga nismëtarët, organizatorët dhe drejtuesit kryesorë të këtij Kongresi e kishte ideuar dhe konceptuar këtë tubim në përputhje të plotë jo vetëm me interesat e bashkësisë islame, por dhe me interesat e shtetit dhe të kombit shqiptar. Kjo detyrë e rëndësishme, sa fetare aq dhe atdhetare, mendohej të realizohej, çka është e kuptueshme, pa cenuar shtyllat e besimit islam. Pra, ky tubim nuk do të ishte një mbledhje e zakonshme e organizmave të bashkësisë islame në Shqipëri. Kryetari i këtij Kongresi vinte në këtë mbledhje me një koncept të qartë dhe të gjerë të detyrave që qëndronin përpara bashkësisë islame në Shqipëri, me një koncept bashkëkohor të masave dhe të vendimeve që duheshin marrë nga delegatët e zgjedhur.

Në vijim të fjalës së tij të hapjes, Kryemyftiu i Shqipërisë, duke marrë parasysh gjendjen fetare të vendit, shtronte para mbarë besimtarëve myslimanë detyrën për të vënë mbi gjithçka bashkimin dhe vëllazërimin kombëtar të mbarë shqiptarëve, pa dallim besimi. “*Sikurse e dini zotëria e juaj, popullsia e Shtetit tonë përmbahet prej tre elementësh d.m.th. Mysliman, Katolik dhe Ortodoks, po në pikëpamje të Kombësisë në mest kemi një vllaznie të plotë e të patundëshme, e nuk mund të thohet e të kuptohet asnjë send qi e tund atë vllaznie të plotë. Çashjja e fesë asht*

Islame”, nr. 17 (148), viti i VII i botimit, shtator 1998.

*nji çashjje e posaçme e sejcilli asht i lirë për me e sigurue forcimin e fesë së vet. Ky organizim i fesë sonë asht vendosun qysh në Kongres të Dibrës. Fatzezë, po luftat ballkanike etj., e ndaluen këtë qëllim.”*²⁸

Në seancën e dytë, Kongresi zgjodhi një komision që do të punonte për hartimin e statutit, i cili ishte dokumenti më i rëndësishëm i mbledhjes së myslimanëve shqiptarë. Komisioni që u ngarkua me përgatitjen e projekt-statutit i vazhdoi bisedimet dhe formuloi projektin e paraqitur, ku ndër të tjera shkruhej: “Sikurse shihet në këtë projekt-statut, duke u marrë parasysh qëllimet esenciale të organizimit, Statuti merr emrin Statuti i Trupit Xhematit Mysliman Shqiptar, në të cilin jemi munduar të përmbledhim disa themele për sigurimin e mbarëvajtjen e organizimit të këtij trupi për sa i përket sigurimit të një morali të pastër e zhvillimit lëndor e ekonomik, duke u larguar kryekëput nga politika. Përbërja e trupit mysliman shqiptar për sigurimin e qëllimeve të sipërsënuara e forcimin vëllazëror ndërmjet shqiptarësh, i ngarkohet Këshillit të Naltë të Xhematit e ndihmës plot me vullnet të patundshëm të shqiptarëve myslimanë.”²⁹

28. Gazmend Shpuza (Prof. Dr.), *Kongresi i Parë Mysliman Shqiptar (1923), sanksionim i mëvetësisë së Bashkësisë Islame të Shqipërisë dhe themel i zhvillimit kombëtar dhe bashkëkohor të saj*, po aty, f. 79-80.

29. AQSH, fondi 482, viti 1923, dosja 4,

Në nenin 1 të këtij statuti shkruhej: *“Për përmisimin e rregullimin e trupit Mysliman, u formue Xhema-ati Islamija në Shqipëri. Xhema-ati Islamija përmbahet me këto Këshilla: a) Këshill i Naltë i Sheriatit, b) Këshillat e Xhema-atit.”*³⁰

Në statut, titulli i kadillikut e i nijabetit dhe fjala gjyq u hoqën, kryetarët e zyrave sheri, tani e tutje do të përmbajnë titullin myfti. Ndërsa Gjyqi i Naltë i Sheriatit merr titullin Këshilli i Naltë i Sheriatit. Organi më i lartë mysliman në Shqipëri, po sipas këtij Statuti, ishte Kryesia e Këshillit të Naltë të Sheriatit. Kryesia e Këshillit të Naltë të Sheriatit drejtohej nga Myftiu i Përgjithshëm.

Rëndësi të madhe kishte fakti se Statuti Mysliman përjashtonte dhe ndalonte çdo autoritet shpirtëror jashtë Shqipërisë, çka e shihte atë kundër idealit kombëtar. Personi që do të vendosej të drejtonte Kryesinë e Këshillit të Naltë të Sheriatit duhet të kishte këto cilësi: Së pari, të ishte nënshkret shqiptar dhe të dinte gjuhën shqipe; së dyti, të gëzonte të drejtat civile e politike; së treti, të ishte prej racës shqiptare ose me origjinë shqiptare prej tre brezash. Këtë post nuk mund ta zinin ata persona të cilët, duke filluar nga data 28 nëntor 1912 kishin luftuar kundër çështjes

kombëtare.³¹ *“Myftiu i Përgjithshëm do të ketë marrë ixhazet ose të ketë mbaruë shkollën e neyv-vabit, do të ketë zotsi të plotë në dijeni fetare e moral Kombtar, do të dijë me shkrue Shqip e do të ket mbush 35 vjeçë e t’mos jetë i dënuë prej një gjyqit ordinerë.”*³²

Në përfundim të punimeve më 12 mars 1923, Kryetari i Kongresit Mysliman Shqiptar Haxhi Vehbi Dibra i drejtoi Kryeministrit një letër ku e vinte në dijeni se Kongresi i kishte mbyllur punimet me sukses të plotë, duke zgjedhur në bazë të neneve 6 dhe 7 të statutit edhe anëtarët e Këshillit të Naltë të Sheriatit. Zgjedhjet u përfunduan si vijon: Z. Vehbi Dibra, vota 30 – dijetar (zgjidhet Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar); z. Hafiz Ali Korça, 29 vota – dijetar; z. Vejsel Nailiu 27 vota – dijetar; z. Haxhi Adem Bab 28 vota – tarikat; z. Sheh Ibrahim Karbunara 26 vota – tarikat. Nga civilët: Qamil Bala, vota 28 – civil; Reshat Kokalari 20 vota – civil; Drejtor i Përgjithshëm i Vakfeve u zgjodh z. Salih Vuçiterni me 32 vota.³³ Me vendimet që mori, ai shënon një ngjarje të rëndësishme historike, jo vetëm për besimtarët e

fleta 195-197. Projekt Statuti i Xhematit Mysliman Shqiptar.

30. Statuti i Trupit Xhema-atit Mysliman Shqiptar, shtypshkronja “Tirana”, Tiranë 1923, neni 1, f. 1.

31. AQSH, fondi 882, viti 1923, dosja 1, fleta 3.

32. Statuti i Trupit Xhema-atit Mysliman Shqiptar, 1923, neni 5, f. 2.

33. AQSH, fondi 482, viti 1923, dosja 4, fleta 28, Letër dërguar Kryeministrit në Tiranë nga Kongresi Mysliman Shqiptar, nr. 4, datë 12.03.1923; Nasuf T. Dizdari, *Njohuri me karakter historik*, gazeta “Drita Islame”, nr. 4 (135), shkurt-mars 1998.

fesë islame, por për mbarë popullin shqiptar.

Në Statutin e vitit 1923, jo vetëm që nuk bëhej fjalë për ndonjë lidhje me kalifatin, por, konfirmoheshin ‘de jure’ vendimet e vitit 1913, kur si Myfti i Përgjithshëm i Shqipërisë ishte zgjedhur Haxhi Vehbi Dibra. Ky ishte dhe Kongresi i shpalljes së pavarësisë së xhamisë shqiptare, duke shkëputur kështu zyrtarisht çdo marrëdhënie me Turqinë. Një akt i tillë u prit me entuziazëm dhe u komentua gjerësisht në faqet e shtypit të kohës. Deri më sot nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë dokument mbi qëndrimin që mbajti Stambolli ndaj pavarësisë së xhamisë shqiptare. Ndonëse kjo ngjarje nuk mund të ketë kaluar pa u vënë re nga qeveria turke, fakt është se ajo nuk ndërmori ndonjë veprim apo reagim publik, për vetë faktin se bashkësia myslimane e Shqipërisë ‘de facto’ e kishte fituar mëvetësinë e saj që kur vendi ynë u shkëput nga Perandoria Osmane.³⁴

Kongresi hartoi Statutin, u mor me organizimin, caktoi kompetencat dhe të drejtat e tij, në pajtim me ligjet e shtetit në fuqi. Komuniteti doli si ent më vete; organizoi udhëheqësit fetarë, nëpunësit fetarë, shkollat dhe gjykatat fetare, të cilat zbërthenin çështjet me karakter fetar – kurorëzime, divorce, trashëgimi dhe

pasoja të tyre si dhe administronin pronat vakfnore.³⁵ Ministria e P. të Brendshme me 8 prill 1923 njofton se të gjithë kleret, derisa çështja e tyre të rregullohet me ligj, do të varen nga Ministria e P. Brendshme.³⁶

Komuniteti përpiloi buxhetin e vet që e përballonte me të ardhurat e veta dhe me subvencionin që i jepte qeveria. Në këtë kohë Komuniteti mbante emrin “Xhema’ati Islamiye”, që përbëhej prej një Këshilli të Naltë të Sheriatit me pesë anëtarë, në krye të të cilëve qëndronte Myftiu i Përgjithshëm. Ky Këshill i Naltë zgjidhej nga Kongresi, ku merrnin pjesë delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë. Këshilli i Naltë zgjidhej për pesë vjet. Vartësit e Këshillit të Naltë ishin: 1) Myftinjtë e qarqeve; 2) Sekretarët e vakfeve që merreshin me administrimin e të ardhurave vakfnore, 3) Sekretarët e sherisë, të cilët merreshin me martesat, shkurorëzimet, etj. 4) Mytevelijët që administronin mirëmbajtjen e pasurive vakfnore dhe faltoret.³⁷

Detyrat e Këshillit të Naltë të Sheriatit ishin: Të sigurojë njësinë dhe barazinë ndërmjet myslimanëve, si dhe të nxjerrë në pah shpirtin dhe qëllimin e Sheriatit, duke zhdukur të gjitha besëtytnitë dhe zakonet e këqija, të cilat nuk kanë të bëjnë fare me Islamin. Të ngrejë institucionet

34. Hasan Bello (Dr.), *Shkëputja e Shqipërisë nga Kalifati Osman dhe përpjekjet për pavarësinë e xhamisë shqiptare*, f. 90-91-92.

35. Ali M. Basha, *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)*, f. 79.

36. AQSH, dosja 6, fleta 8.

37. Ali M. Basha, *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)*, f. 79.

fetare për nxjerrjen e Vaizëve, Myftive, Myderrizëve, Teologëve, Imamëve dhe Hatibëve. Të përmirësojë punën në Medrese, sipas principeve dhe metodave moderne. Të ngrejë streha vorfënore, të studiojë dhe të shqyrtojë raportet e paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakfit, të kontrollojë buxhetin e përgjithshëm të përgatitur nga Drejtoria e Financës, të emërojë dhe të shkarkojë sipas rregullave të aprovuara të gjithë nëpunësit e Sherisë dhe të vakfeve, të shqyrtojë dhe të zgjidhë të gjitha akt-vendimet dhe fetvatë, të përgatisë rregulloren e administrimit të përgjithshëm. Të sigurojë botimin e një reviste të paktën njëherë në muaj, të botojë dhe të përkthejë librat e nevojshëm për shtimin e kulturës islame, të përkujdeset për të ngritur më lart mësimin e besimit, si dhe të përgatiten në gjuhën shqipe hytбет dhe predikimet që mbahen para xhematit.³⁸

Vënia e veprimtarisë së Komunitetit Mysliman mbi baza ligjore, ngritja e një arsimit të qëndrueshëm fetar me programe të kohës, dhënia e një fryme kombëtare ceremonive fetare nëpërmjet përdorimit të gjuhës shqipe në predikime, mirëkuptimi në organizimin e drejtësisë mbi baza civile, ndërtimi i marrëdhënieve me shtetin në bazë të një kuptimi modern të një shteti laik, dhe, mbi të gjitha, pavarësia institucionale e

Komunitetit Mysliman, si një vepër origjinale, janë gurë të një kure plotësisht të merituar.³⁹ Aktet e Kongresit Mysliman Shqiptar të vitit 1923, më shumë se në çdo rast tjetër, duke përfshirë edhe periudhën e sotme “të evropianizimit të përgjithshëm” përmbajnë një mendim të reformuar, liberal, të përshtatur për rrethanat e një shteti që jeton në mesin e Evropës, për të cilin feja është e ndarë nga shteti dhe çështje e individit.⁴⁰ Komuniteti Mysliman arriti të vetorganizohet mjaft mirë, në një përvojë të re pothuaj të panjohur, ndërkohë që në plan kombëtar rrezaton një patriotizëm të flaktë dhe përgjegjshmëri të plotë ndaj problemeve sociale që kalonte vendi.

Administrata e Komunitetit Mysliman është vendosur fillimisht në godinën e Mejtepit në Pazarin e vjetër, tashmë i shkatërruar. Kurse ndërtesa e Komunitetit Mysliman u ndërtua në fillim të viteve 1930-të pranë Xhamisë së Vjetër (Sulejman Pasha), e cila është prishur me ndryshmet urbanistike që ka pësuar Tirana në vitin 1967.⁴¹

39. Siri Hoxha, *Veprimtaria e Komunitetit Mysliman Shqiptar në vitet '20 të shek. XX, në plan kombëtar e shoqëror*, gazeta “Drita Islame”, nr. 4 (135), shkurt-mars 1998, revista “Zani i Naltë”, nr. 9, tetor, nëntor, dhjetor 2014, f. 122-123.

40. Shaban Sinani (Prof. Dr.), *Pavarësia e xhamisë, 75 vjet nga kongresi që kërkoi një besim islam me fytyrë evropiane*, gazeta “Drita Islame”, nr. 17 (148), viti i VII i botimit, shtator 1998.

41. Roald A. Hysa, *Xhamitë e Tiranës*, Tiranë

38. Nasuf T. Dizdari, *Njohuri me karakter historik*, Po aty; Statuti i Trupit Xhema-atit Mysliman Shqiptar, 1923, neni 11, f. 3-4.

Kongresi i Parë Mysliman Shqiptar dëshmoi qartësisht tubimin e një bashkësie me identitet kombëtar të përcaktuar dhe të shprehur prej kohësh, me një përfytyrim bashkëkohor për zhvillimin e saj dhe të Atdheut. Lajmi për vendimin kryesor të Kongresit për mëvetësinë e xhamisë shqiptare, shkëputjen e saj nga organizmat qendrore botërore të Islamit të kohës, u prit kudo me miratim dhe entuziazëm të theksuar nga gjithë opinioni publik shqiptar. U përshëndet nga të gjithë banorët e vendit tonë, duke u shndërruar në një festë të vërtetë, në të cilën morën pjesë banorë pa dallim besimi. U bënë lutje fetare në gjuhën shqipe dhe ky

2008, f. 77.

lajm i rëndësishëm u përshëndet edhe me të shtëna artilerie.

Qëndrimet pozitive të mbajtura nga organet e shtypit islam dhe nga shtypi shqiptar i kohës për Kongresin, me ndonjë përjashtim shumë të rrallë, janë shprehje e një mendësie moderne mbarë-popullore, që kishte përfshirë të gjitha masat myslimane të vendit. Kongresi gëzoi edhe vlerësimin e vëmendjen e opinionit ndërkombëtar. Përveç shtypit vendas, gazetat me emër si “New York Times” në Amerikë, “Temps” e Parisit, “El-Ahram” e Egjiptit... etj., përshëndetën Kongresin e Parë Mysliman dhe vendimet e tij.

Dorian Demetja

Personat në moshë të shtyrë Rëndësia e pjesëmarrjes nëpër sisteme shoqërore - trajtuar nga pikëpamja e punëve sociale

Skender Mustafi
Bsc. Punët Sociale

Abstrakt

Në këtë punim do të trajtohet rëndësia e të qenët pjesë e sistemeve sociale për personat në moshë të shtyrë, pleqtë. Punimi lë anash dimensionet e tjera të hapësirave të jetës së këtij grupi shoqëror. Në këtë hulumtim është bërë trajtimi i situatës së personave në moshë të shtyrë vetëm nga pikëpamja e punëve sociale. Kjo temë do të shtjellohet duke iu qasur pasojave të mospjesëmarrjes nëpër sisteme sociale dhe shkaqet të cilat mund të shpien në mospjesëmarrje. Qëllimi i realizimit të këtij punimi është që të bëhet një lloj nxitjeje profesionale e të menduarit konstruktiv dhe produktiv për gjendjen e pleqve, dimension i cili injorohet në tërësi dhe nuk trajtohet në mënyrë profesionale në shoqërinë tonë.

Personat në moshë të shtyrë në këtë punim do të njihen edhe me termin ‘pleq’, term të cilin e llogaris si sinonim me ‘persona në moshë të shtyrë’. Në fjalorin e përditshëm për këtë grup personash shfrytëzohet dhe ‘personat në moshë të thyer’ e që vlerësoj të jetë identifikim i padrejtë dhe jo gjithëpërfshirës për gjendjen e këtij grupi shoqëror. Njëkohësisht termi ‘pleq’ në këtë punim ngërthen edhe gjininë femërore, megjë punimi u kushtohet të gjithë personave në moshë të shtyrë.

Hulumtimi trajton rrjedhat aktuale të të menduarit rreth këtij grupi shoqëror, faktorët të cilët ndikojnë në nivelin e pjesëmarrjes nëpër sisteme shoqërore, pasojat e mospjesëmarrjes nëpër sisteme dhe, së fundi, punimi sugjeron disa nga mënyrat e zbutjes së shkallës së vetmisë dhe intensitetit të mospjesëmarrjes nëpër zhvillimet shoqërore.

Të kuptuarit e sistemeve të personave në moshë të shtyrë

Sistemet sociale (shoqërore) janë bashkësi personash të cilët kanë interesa ose lidhje të përbashkëta, personat ndërveprojnë mes tyre dhe ky ndërveprim rrjedh sipas roleve të caktuara, formale ose joformale, përbrenda sistemeve. Sistemet shoqërore nuk janë rrjete, por bashkimi i sistemeve të ndryshme ndërton rrjete. Për më tepër, qasja e analizës së sistemeve të ndryshme të individëve¹ është një ndër qasjet profesionale të punëve sociale në trajtimin e zhvillimeve shoqërore, si në nivel individual ashtu edhe në nivel të shoqërisë.

Njeriu është vetë një sistem (i cili ngërthen nënsistemin biologjik dhe psikik) dhe, njëkohësisht, merr pjesë në më shumë se një sistem social përgjatë gjithë jetës së tij. Shembuj të sistemeve sociale janë familja, vendi i punës, shokët në kafene, familja e gjerë, miqësia, etj. Personat në moshë të shtyrë, posaçërisht pas daljes në pension, kanë shumë më pak sisteme në të cilat marrin pjesë në mënyrë aktive. Dalja nga vendi i punës zakonisht është e lidhur ngushtë me shkëputjen e personit nga sisteme të ndryshme, të cilat, deri në atë

kohë, kanë qenë pjesë përbërëse e përditshmërisë dinamike. Gjithashtu largimi nga sistemet aktive ndikon në shpërbërjen e shumë vlerave të cilat kanë qenë të ndërlydhura ngushtë me sistemet dhe individin si pjesë të tyre. Mu për këto arsye shumë persona, pas daljes në pension, llogarisin veten të kenë hyrë në moshën e pleqërisë ose madje edhe të jenë plakur.

Për shkak të mungesës së një përkufizimi të përgjithshëm për pleqërinë dhe pamundësinë për të arritur një të tillë në këtë pikë të thuash jam plakur është njësoj sikur të thuash “është bërë grumbull” pasi të kesh hedhur kokrrat e misrit në një vend dhe me kokrrën e fundit që hedh “e njëj grumbullin”. Po nëse llogojmë kokrrën e fundit, kemi akoma grumbull kokrrash? Meqë kjo gjendje paraqet të kuptuarit relativ, do të thotë se kemi të bëjmë me një term, përkufizimi i të cilit është shumë relativ, i varur nga perspektiva personale dhe nga dimensionet e jetës.

Sidoqoftë, për të ruajtur baraspeshën psikike dhe fizike në jetën e përditshme, duhet që sistemet e humbura të zëvendësohen me të tjera, të cilat përmeshin zbrazëtinë e shkaktuar, si në konsumim të vlerave ashtu edhe në ofrim të tyre, si dhe rrisin nivelin e përjetimit të roleve personale nëpër sisteme aktive dhe të ndërveprimit me pjesëmarrës të tjerë në to.

1. Sistemet kryesore të një individi janë: Sistemi fizik, sistemi psikik dhe sistemet sociale.

Gjithashtu, gjithnjë duhet pasur parasysh se shumë sisteme, në jetën aktive të njeriut, janë të përbëra nga elemente aktive, kanë synime të mirë-përcaktuara dhe kërkojnë pjesëmarrjen dinamike të personave përbërës të tyre. Në pleqëri shumica, të mos themi të gjitha, e sistemeve, në të cilat marrin pjesë pleqtë, janë vullnetare, ku pjesëmarrja është pasive dhe në shumicën e rasteve ato nuk kanë synime të caktuara në nivel sistemi. Shembuj të dallimeve të një sistemi aktiv dhe të mirë-organizuar, siç është “vendi i punës”, dhe një sistemi pa synime të përkufizuara, si “të shkuarit në kafenenë e lagjes”, mund të identifikojmë në të gjitha dimensionet e jetës së personave në moshë të shtyrë, andaj dhe pritshmëritë janë të ndryshme si nga ana e sistemeve ndaj personave pjesëmarrës ashtu edhe nga ana e personave ndaj sistemeve.

Të menduarit mbi pleqërinë

Gjatë të jetuarit në moshën e rinisë, shumicën e kohës, nuk diskutohet thujtse fare rreth pleqërisë, mbi rrethanat e të qenët plak dhe domethëniet e proceseve gjatë kësaj periudhe të jetës. Madje, edhe nëse diskutohet rreth kësaj teme, bëhet fjalë për mendime të paformuara dhe shpalosen ide e vizione që në të vërtetë janë dëshira rinore që kanë të bëjnë me mungesa ose zbrazëti të cilat, për shkak të rrethanave të jetës dhe moshës

aktuale, nuk mund të plotësohen. Mendime të tilla si: “Kur të plakem dua të jetoj në një vend të qetë me plazh.”, “...dua të shëtit botën.”, ose “...dua të kaloj kohën vetëm me të dashurit e mi.”, janë mendime rinore dhe vizione të cilat, në të shumtën e rasteve, nuk përputhen me rrethanat reale jetësore të individëve në moshë të shtyrë.

Gjatë të jetuarit të jetës në moshën e pjekurisë, pleqëria, shumicën e kohës, trajtohet si fenomen, si proces ose si zhvillim, i cili përflitet më shumë se gjatë moshës së rinisë, por akoma nuk trajtohet seriozisht. Gjatë kësaj periudhe të jetës, për shkak të angazhimit të madh dhe produktivitetit individual, pleqëria ndërldhet ngushtë me lodhje, rraskapitje, si dhe me dërrmim të trupit dhe psikikës. Andaj edhe trajtuar nga kjo pikëpamje mund të identifikohen dy grupe shoqërore me qëndrime të ndryshme ndaj pleqërisë. Sipas njërit grup, i cili është i rraskapitur nga puna dhe i pakënaqur me të, në pleqëri merret parasysh nevoja për pushim dhe qetësim të eshtrave e nervave. Ndërsa sipas grupit tjetër të së njëjtës moshë, i cili është i fortë fizikisht e në psikikë dhe është i kënaqur me punën e vendin e punës, në pleqëri merret parasysh nevoja për punë dhe angazhim. Ky grup, në njërin anë është i shqetësuar me punën dhe koordinimin e saj, ndërsa në anën tjetër me kohën dhe menaxhimin e

saj. Andaj dhe te ky grup njerëzish shpalosen mendimet si: "...unë do të punoj edhe më tej nëse mundem...", "...dua që të kem një baraspeshë mes punës dhe kohës së lirë...", "...do të punoj ca muaj, pastaj do të qëndroj ca muaj në shtëpi. Këtë ndërrim do ta bëj vazhdimisht...". Sikurse mendimet rinore, ashtu edhe mendimet e këtij grupi shoqëror janë pa bazë faktike të të njohurit të jetës së personave në moshë të shtyrë, dhe mbi këto mendime nuk mund të ndërtohen ide të vërteta të ndërtimit të projekteve të përshtatshme për moshën e pleqërisë.

Në të vërtetë për t'iu përgjigjur pyetjes se çfarë do të bëj kur të plakem, duhet kuptuar, pranuar dhe definuar pleqëria, vetja dhe sistemet në të cilat bëjmë pjesë dhe do vazhdojmë të jemi gjatë asaj moshe. Pengesa e parë në trajtimin e kësaj teme është se nuk ka përkufizim të vetëm të pleqërisë. Mbi pleqërinë mund të gjenden përkufizime të ndryshme, por asnjëherë një përkufizim i cili njehson çdo element, proces ose dimension të pleqërisë. Andaj pleqëria, fillimi i saj ose kulmi i saj, nuk është një moshë e caktuar, por dallon nga individ i individ ose nga pikëpamja dhe të kuptuarit e secilit për veten e tij.

Përcaktimi i moshës së pleqërisë mund të jetë bërë në mënyrë kulturore ose ligjore si formë referimi, por jo si pikë ku bëhet ndarja mes të qenët jo plak dhe të qenët plak. Për shembull, në pjesën veriore të Maqedonisë

së Veriut, në mënyrë kulturore, në shumicën e rasteve, pleqëria i referohet arritjes së 60 viteve jetë ose kur fëmijët arrijnë moshën e martesës dhe martohen, do të thotë kur personi merr rolin e vjehrrit. Pa dyshim që ky përkufizim ose lloj i të përkufizuarit kulturor, është dinamik dhe ndryshon e zhvillohet bashkërisht me ndryshimet kulturore përbrenda një shoqërie, në një rajon të caktuar ose nëpër shoqëri të ndryshme. Në anën tjetër, nga këndvështrimi ligjor i shteteve të zhvilluara të Evropës pleqëria i referohet vitit të daljes në pension i cili dallon nga mosha 60 vjeçare deri në moshën 67 vjeçare për meshkujt dhe nga mosha 55 vjeçare deri në moshën 66 vjeçare për femrat².

Meqë këto të dhëna i referohen vetëm pleqërisë, atëherë kur jemi plakur? Nga cila moshë fillon pleqëria? Ç'është pleqëria? Si mund të bëjmë dallimin mes të qenët dhe të mos qenët plak?

2. Handelszeitung (09.2022). So unterschiedlich sind die Pensionsalter in Europa (sq. Aq e ndryshme është mosha e daljes në pension në Evropë). E gjetur tek: <https://www.handelszeitung.ch/politik/schweiz-im-mittelfeld-sounderschiedlich-sind-die-rentenalter-in-europa#530585-:~:text=Das20%Rentenalter20%in20%Europa20%liegt20%zwischen20%2060%und20%2067%Jahren.&text=In20%der20%Schweiz20%stimmen20%wir,bez%C%3BCglich20%der20%Pensionsalter20%ein20%Flickenteppich>. Së fundi qasur më 24 Shtator 2022.

Që të mund t'i përgjigjemi këtyre pyetjeve dhe pyetjeve të ngjashme, për veten tonë dhe për rrethin ku jetojmë, duhen kuptuar disa fakte të përgjithshme rreth kësaj temë:

Pleqëria, në vete, nuk përfshin një grup homogjen njerëzish, por ky grup është shumë heterogjen edhe kjo jo vetëm në një parametër. Në këtë grup kemi individë të moshave, gjinive, kulturave, bindjeve, besimeve e parapëlqimeve të ndryshme. Këta individë kanë prapavijë të ndryshme të zhvillimit personal, kanë bagazh dallues edukativ e të përgatitjes profesionale, kanë fuqi të ndryshme financiare, si dhe kanë pritshmëri të ndryshme në udhëheqjen e proceseve personale dhe në mirëmbajtjen e lidhjeve me sistemet e ndryshme sociale.

Andaj, përgjigja e pyetjes: “A jam plak?” dhe “Kur jam plakur?” është rezultat i një procesi që është i ndërlikur ngushtë me rrethanat aktuale të personit i cili parashtrohet këto pyetje, zhvillimit të mëhershëm personal, lidhjeve shoqërore (lidhjeve familjare, etj.) dhe fuqisë materiale.

Zhvillimi i individit

Trajtuar nga pikëpamja e punëve sociale, njeriu kalon nëpër disa faza të zhvillimit nëpër të cilat ngërthen dhe përjeton role të ndryshme, të cilat i shfrytëzon si pjesë të fuqive të veta ose të cilave u nënshtrohet si pjesë të rrjedhave të jetës personale e sociale:

- Në fazën e parë të zhvillimit, si fëmijë, njeriu është konsumues pasiv dhe përvetësues aktiv i të

gjitha vlerave materiale, shpirtërore e sociale. Pjesëmarrja nëpër sistemet e ngushta sociale, si familja e ngushtë dhe e gjerë, si dhe qendrat jashtë familjare të kalimit të kohës, luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin psikik, fizik e social.

- Në fazën e dytë të zhvillimit, si i ri, njeriu është konsumues dhe përvetësues aktiv i vlerave, si rezultat i njohurive e aftësive personale dhe zhvillimeve sociale në përputhje me moshën e arritur. Kyçja nëpër sistemet edukativo-arsimore, siç janë shkollat, organizatat e aktiviteteve të ndryshme, qendrat për edukim fetar, etj., mundësojnë pjesëmarrje aktive në përvetësim të vlerave në mënyrë të sistemuar.

- Në fazën e tretë të zhvillimit, si i rritur, njeriu është prodhues aktiv në të gjitha sferat e jetës dhe konsumues e përvetësues i vlerave, produkteve e shërbimeve të zhvillimeve sociale në mënyrë të përzgjedhur dhe të vetëdijshme. Në këtë fazë njeriu shfrytëzon fuqitë njohëse për të vepruar në mënyrë aktive dhe njëkohësisht për të përvetësuar njohuri të reja mbi zotërimin e proceseve të jetës së përditshme dhe të mirëmbajtjes së lidhjeve me pjesëmarrësit e sistemeve të ndryshme.

- Në fazën e fundit, si plak, njeriu është reflektues i njohurive, përvojave dhe përjetimeve, si ndaj vetes ashtu edhe ndaj të tjerëve. Në këtë fazë, në shumicën e rasteve,

kalohet nga pjesëmarrja aktive nëpër sisteme sociale në reflektimin pasiv nëpër sistemet sociale dhe reflektimi aktiv në nivel personal. Personat në këtë moshë tanimë me vete bartin bagazhe të ndryshme të njohurive e përvojave, si dhe përgjatë jetës kanë arritur një lloj bindjeje të caktuar dhe këto elemente ndikojnë drejtpërdrejtë në të kuptuarit dhe të reflektuarit e jetës së kaluar dhe pleqërisë personale.

Së fundi, pas kalimit në pension dhe kalimit në “fazën e pleqërisë”, në shumicën e rasteve, kalohet nga pjesëmarrja aktive dhe shpërndarja e vlerave në shoqëri në pjesëmarrjen aktive në jetën individuale dhe plotësim të nevojave personale.

Mosha e shtyrë - pleqëria

Pleqëria, në të shumtën e rasteve, në dekadat e fundit, ndërlidhet ngushtë me kohën e daljes në pension, pavarësisht nëse është në fillim të viteve të gjashtëdhjeta të jetës (koha para daljes në pension). Në këtë rast, rol të rëndësishëm luan edhe shëndeti e pikëpamja e individit, i cili mendon, reflekton e flet mbi pleqërinë. Në të vërtetë, dalja në pension për shumë individë luan rol shumë të rëndësishëm për të përcaktuar moshën e pleqërisë, andaj dhe duhet marrë me seriozitet. Kjo ndodh pasi individ i largohet nga angazhimi i plotë i prodhimit të përgjithshëm dhe i shpërndarjes aktive të vlerave sociale. Ndër të

tjera bëhet largimi nga pjesëmarrja aktive nëpër sistemet sociale, ulen të hyrat financiare dhe bie niveli i aktiviteteve personale pothuajse nga 100% në heshtje të plotë. Në këtë rast dalja në pension, për shumë persona të përfshirë në punë aktive, tërheq një vijë të kuqe mes dy fazave të zhvillimit të jetës së individit.

Kjo periudhë, në varësi të llojit të profesionit të ushtruar dhe aftësive mendore e fizike të individit, ka ndikim të madh në të kuptuarit e moshës së pleqërisë dhe periudhës vijuese të jetës. Andaj edhe te shumë individë paraqiten huti të shumta, shfaqet mungesë e kuptimit të jetës së kaluar, si dhe jetës në përgjithësi, dhe fillohet të mendohet më thellë rreth vdekjes dhe vlerave personale.

Njeriu, për nga natyra, kërkon të ofrojë vlerat personale në shoqëri, të jetë i vyer për shoqërinë dhe të jetë pjesë aktive e saj. Ai përpiqet të veprojë në nivel aktiv në atë mënyrë që shoqëria të ketë nevojë për të ose së paku rrethi ku jeton të ketë nevojë për të. Madje Melody Beattie³ në librin e saj “Varësia për të qenë i nevojshëm” thotë se njeriu është i varur nga dëshira që shoqëria të ketë nevojë për të. Mu për këtë arsye, angazhimi fizik e social, në këtë periudhë të jetës, është shumë i rëndësishëm, si për ruajtjen e shëndetit fizik ashtu edhe të atij psikik. Ky është edhe shkaku

3. Beattie, Melody (2014). Die Sucht gebraucht zu werden. Heyne Verlag. 288 f.

që shumë persona, të cilët mund të përballojnë proceset dhe intensitetet e punës aktive, kërkojnë të qëndrojnë akoma në punë dhe t'u vazhdohet kontrata e punës edhe më tej.

Faktorët e rëndësishëm që ndikojnë pjesëmarrjen në shoqëri

Në moshën e pleqërisë, pjesëmarrja në shoqëri përmes një jete aktive është e varur fillimisht nga shëndeti. Dobësimi i shëndetit dhe paraqitja e nevojave për mbështetje shëndetësore kufizojnë pjesëmarrjen fizike në aktivitete shoqërore. Në këtë pikëpamje rol të rëndësishëm luajnë dhe mundësitë hapësinore, infrastruktura dhe objektivat që individi ka në vendin ku jeton. Nëse në nivel shoqëror nuk ofrohen mundësi strukturore, të cilat plotësojnë kushtet fizike për të përfshirë njerëzit e dobët ose me të meta fizike, atëherë ideja për pjesëmarrje është shuar para lulëzimit të saj. Për shembull, nëse objekti ku po ofroni kursin për personat në moshë të shtyrë nuk ka infrastrukturë, si lift ose shkallë shiriti, atëherë në mënyrë automatike janë përjashtuar personat me nevoja të veçanta dhe personat e dobët fizikisht.

Struktura dhe kultura familjare është ndër faktorët më të rëndësishëm pas shëndetit. Familja luan rol të rëndësishëm, si për pjesëmarrjen në sisteme sociale ashtu edhe për përjetimin e vlerave

themelore njerëzore. Pjesëmarrja nëpër aktivitetet familjare, edhe në moshën e pleqërisë, ruan dukshëm nivelin e pjesëmarrjes në sistemet më të gjera shoqërore në përgjithësi. Si marrja përsipër e detyrave të ndryshme përbrenda familjes, ashtu edhe vizitat e ruajtjet e lidhjeve me familjarët e rrethit më të gjerë, luajnë rol të rëndësishëm për çdo njeri, pasi bëhet fjalë për përfshirje nëpër sisteme të ndryshme ku dukshëm shkëmbehen vlera të larmishme dhe merren role dinamike. Këto aktivitete ndikojnë në ruajtjen e dëshirës personale për pjesëmarrje nëpër organizime shoqërore dhe shkatërrojnë të gjitha barrierat e hendeqet që shtyjnë personin të rrisë dëshirën për veçim.

Faktor tjetër i rëndësishëm është **organizimi i rrjedhave financiare**. Lartësia e pensionit, kursimet dhe mbështetjet nga burime të tjera mundësojnë pjesëmarrjen më të lehtë nëpër sisteme të ndryshme sociale. Gjithashtu mundësojnë përjetimin dhe përmbushjen e dëshirave dhe nevojave të ndryshme të egos personale. Në të shumtën e rasteve koha e lirë është e kushtueshme, andaj është e lidhur drejtpërdrejt me kapacitetin financiar individual. Për shembull, për të marrë pjesë në një klub kulturor ose social, duhet paguar anëtarësia, duhet përshtatur me sjelljen e pjesëtarëve të tjerë si në konsumim ashtu edhe në veshje, andaj dhe dallimi klasor në të hyra

ndikon në mospjesëmarrje dhe veçim. Fundja, madje edhe për t'u takuar me shokë në kafene kërkon pasje të të mirave financiare.

Kultura e përgjithshme e organizimit shoqëror në vendin e jetesës gjithashtu luan rol të rëndësishëm. Sa më e hapur të jetë shoqëria, duke u mundësuar personave në moshë të shtyrë pjesëmarrje nëpër aktivitete të ndryshme të përbashkëta, aq më e lartë është pjesëmarrja. Si dhe sa më aktive të jetë shoqëria, aq më të përfshirë janë pleqtë në aktivitetet e ndryshme shoqërore, pasi kemi të bëjmë me aktivitete të larmishme të cilat, në vetvete, ngërthejnë role dinamike dhe në mënyrë më të shpeshtë nxisin pjesëmarrje dinamike të elementeve shoqërore. Madje, kur shoqëria është përfshirëse (inkluzive), atëherë motivimi ndër-personal është shumë më i lartë, ndërsa stigmatizimi është më i ulët dhe i papranueshëm.

Nxitja e qëllimshme institucionale në kuadër të programeve sociale të organizuara nga organet shtetërore është një faktor shumë i rëndësishëm në rritjen e nivelit të pjesëmarrjes së pleqve nëpër aktivitete shoqërore. Në këtë rast, organizimi i planifikuar dhe profesional me prapavijë rëndësinë e pjesëmarrjes sociale, jo vetëm ndikon në pjesëmarrjen e pleqve nëpër aktivitete të planifikuara, por edhe rrit orientimin e tyre për

të ruajtur integritetin dhe vlerën personale. Kjo ndodh kur projekte të tilla nxiten nga profesionistë, të cilët si qëllim kanë vlerën dhe ofrimin e shërbimeve të mirëfillta profesionale me synime të mirë-përcaktuara. Andaj dhe përvetësimi i projekteve institucionale është shumë i rëndësishëm.

Pasojat e mospjesëmarrjes nëpër aktivitete shoqërore

Ekspertët kanë hulumtuar persona të shtresave dhe shoqërive të ndryshme në moshën e pleqërisë, nëpër situata të larmishme, duke përfshirë në hulumtim faktorë të rëndësishëm dhe kanë vërtetuar se mospjesëmarrja nëpër aktivitete sociale ka ndikim të madh në shëndetin fizik dhe psikik të individit. Më poshtë janë radhitur vetëm disa nga çrregullimet më të përhapura dhe më të rëndësishme të personat në moshë të shtyrë për shoqërinë tonë.

1. Depresionet e pleqërisë

Shkaqet e depresioneve të pleqërisë mund të jenë të shumta, të akumuluar brenda një periudhe të caktuar ose përgjatë gjithë jetës. Ndër më të rëndësishmit janë: humbja e të afërmeve, humbja e anëtarëve të shoqërisë së ngushtë dhe dëshpërimet e kthyer në zhgënjime gjatë vetë-pasqyrit të viteve të kaluara. Niveli i depresioneve është i ndryshëm te plakat dhe pleqtë si dhe

për depresionet e femrave flitet më pak dhe ato ndërliiden me stilin e tyre të jetesës edhe pse ato në shumë raste kalojnë nëpër depresione më të thella për shkak të kalimit të jetës në mënyrë të izoluar, ku sistemi i vetëm aktiv përgjatë gjithë jetës ka qenë familja e ngushtë. Për këtë arsye dhe angazhimi për identifikimin profesional të fazave të depresionit duhet të jetë më i madh.

Gjatë depresioneve personat në moshë të shtyrë përjetojnë për një kohë të gjatë periudha të mërzi së thellë nga e cila nuk shihet rrugëdalje. Në këtë gjendje asgjë nuk ka vlerë dhe, në një formë, vdekja bëhet më e dashur se jeta dhe shihet si zgjidhja më e drejtë. Gjithashtu personat e rënë në këtë gjendje kanë dyshime në veten dhe e llogarisin atë barrë dhe të pavlerë për shoqërinë e madje edhe për familjarët më të ngushtë. Për shkak të kësaj gjendjeje të rëndë, përveç depresioneve mund të paraqiten edhe probleme tjera, si: ndjenjat e dhembjeve të ndryshme, lodhjet dhe mungesa e oreksit, veçimi, shqetësimi i shpeshtë dhe i shpejtë, etj. Shqetësimet dhe reagimet janë të ndryshme te pleqtë dhe plakat, ku pleqtë reagojnë dhe shprehin nervozizëm e pakënaqësi, ndërsa plakat tërhiqen, nuk flasin dhe reagojnë në heshtje e me kokëfortësi. Andaj, këto janë edhe shenja të cilat tregojnë se personi është duke kaluar një kohë depresionesh, gjendje e cila

jo çdo herë mund të vërehet ose në ndonjë formë të komunikohet nga të prekurit⁴ dhe ⁵.

Sipas psikologes gjermane Karin Kutz⁶, 40% e vetëvrasjeve në Gjermani realizohen nga persona të moshës mbi 65 vjeçare ku burrat janë më të shpeshtë, sepse ata ose janë mbyllur në vete ose nuk gjejnë persona për të folur rreth gjendjes së tyre, si rezultat i sistemit të paqëndrueshëm të familjes dhe veçimit nga sistemet e shoqërisë. Në këtë pikëpamje, si pasojë e depresionit, personat e kësaj moshe kryejnë edhe “vetëvrasje të heshtur”, duke privuar veten nga marrja e barërave të rëndësishme dhe nga të ushqyerit.

4. Johanniter-Unfall-Hilfe e.V. (2021). Psychische Erkrankungen im Alter. Publikuar nga MitPflegeLeben. URL: <https://mitpflegeleben.de/informationsportal/psychische-erkrankungen-im-alter/>. Së fundi qasur më 04 Tetor 2022.

5. Ternès, Anabel (2018a). Psychische Erkrankungen im Alter sind häufig - doch die Betroffenen schweigen oft. Publikuar nga FOCUS Online u. a. Revistë nga Statista GmbH, Hamburg. URL: https://www.focus.de/gesundheit/experten/psychische-erkrankungen-im-alter-die-haeufigstenkrankheitsbilder_id_9893904.html. Së fundi qasur më 04 tetor 2022.

6. Kutz, Karin (2006). Psychische Erkrankungen bei älteren Menschen. Publikuar nga Praxis für Psychotherapie (HPG). URL: http://psychotherapie-kutz.de/psychische_erkrankungen_bei_aelteren_menschen.html. Së fundi qasur më 04 tetor 2022.

2. Frika dhe ankthet

Për ankthe dhe frikë bëhet fjalë atëherë kur frika ndikon jetën emocionale të njeriut dhe çrregullon rrjedhën e jetës së përditshme. Personat kanë frikë të madhe nga gjërat ose situatat e caktuara, të cilat i shpien ata të kalojnë në panik. Një numër i madh i personave, në moshë të shtyrë, gjithnjë e më shumë janë të prekur nga frika e vdekjes. Këtë gjendje e thëllon edhe më tepër mungesa e ndërlidhjeve të mirëfillta me sisteme të ndryshme sociale. Mungesa e komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët është një shkak kyç, i cili luan rol të rëndësishëm për përkeqësimin e kësaj gjendjeje. Të tjerët, më të rëndësishëm në këtë rast, janë familjarët e ngushtë ose të gjerë dhe grupet e tjera të shkëmbimit të bisedave. Mungesa e familjes ose lidhjet e prishura familjare ndikojnë dukshëm në paraqitjen e frikës dhe anktheve të vdekjes në vetmi. Kjo mungesë gjithashtu nxit edhe paraqitjen e llojeve të tjera të frikës së përditshme si: frika e të mbeturit pa ushqim, frika e të mbeturit i/e izoluar, frika e të mbeturit i/e sëmurë deri në vdekje, etj.

3. Sëmundjet bipolare

Sëmundjet bipolare nënkuptojnë lëkundjen midis një manie dhe depresioneve. Kjo nënkupton që personi herë është në gjendje manie, e herë në gjendje depresionesh.

Njeriu është në gjendje manie kur përqendrohet në një gjë dhe me intensitet të lartë realizon / vepron / përjeton atë për të cilën i është ngulitur mendja. Në këtë gjendje të moshuarit e izoluar zhvillojnë depresione të brendshme për shkak të mungesës së pjesëmarrjes në shoqëri, ose mungesës së shoqërisë dhe pasjes së mendimit të të qenët i/e pavlerë. Kjo gjendje është e vështirë të vërehet te personat e prekur meqë fazat e depresionit përcillen gjithnjë e më shumë me eufori⁷. Megjithatë disa nga simptomat mund të dallohen sa për të mundësuar që gjendja të kontrollohet dhe identifikohet nga ekspertët. Personat e prekur nga kjo gjendje janë shpesh në dëshpërim, janë në gjendje mërzie, përcillen nga faza manie me kulme emocionesh, janë euforik, kanë dëshirë të pandalshme për të ndërmarrë diçka dhe janë në gjendje për të rrezikuar shumë⁸. Ndërmarrja e hapave të rrezikshme nuk ka të bëjë vetëm në shpenzim të kursimeve ose konsumim të ushqimit 'të ndaluar nga mjeku', por edhe në ndërmarrje të aktiviteteve të cilat rrezikojnë jetën personale. Në këtë fazë interesat, dëshirat dhe synimet personale

7. Ternès, Anabel (2018b). Bipolare Störungen sind gefährlich - aber nur schwer zu erkennen. Publikuar nga FOCUS Online u. a. Revistë nga Statista GmbH, Hamburg. URL: Manisch-depressiv: Symptome einer bipolaren Störung - FOCUS online;. Së fundi qasur më 14 tetor 2022.

8. Shih po të njëjtin burim të fusnotës 6.

janë të pazëvendësueshme kundrejt nevojave dhe mundësive të të tjerëve, qofshin të tjerët edhe anëtarët më të ngushtë të familjes.

Në këtë mënyrë kalimi nga mania në depresion, dhe anasjelltas, lënë pasojë të mëdha shëndetësore, si në sistemin biologjik ashtu edhe në atë psikik. Këta persona, gjatë fazës së manisë, janë plot vrull dhe nuk njohin kufi, duke 'prekur' skajin e pozitivizmit, ndërsa gjatë fazës së depresioneve bien në skajin tjetër emocional, duke u thelluar edhe më shumë në depresione, si shkak i ndikimit të aktiviteteve të fazës së manisë. Një diagnozë e hershme është shumë e rëndësishme për të ulur shkallën e dëmeve psiko-fizike tek individit.

4. Krijimi i varësive

Në varësi të mënyrës së organizimit të jetës, në të kaluarën, marrin theks dhe aktivitetet në faza të izolimit në moshën e pleqërisë. Shumë persona, ose marrin pilula në mënyrë të pakontrolluar, ose fillojnë të konsumojnë pije dehëse. Nëse kanë histori konsumimi, atëherë rrisin sasinë e konsumimit të alkoolit, si strategji të tejkalimit të fazave të rënda të mërzisë.

Një aktivitet tjetër është edhe luajtja e lojërave të ndryshme të bixhozit nëpër lokale, të cilat mundësojnë veçimin. Veçimi në kulturën tonë është akoma i rëndësishëm, pasi personat në

moshë të shtyrë, posaçërisht burrat, akoma dëshirojnë të mbrojnë nderin përkundër faktit të realizimit të aktiviteteve, të cilat, ata vetë, i shohin si të pandershme. Në këtë mënyrë zhvillohen varësi nga substancat ose veset. Sipas Johanniter-Unfall-Hilfe e.V.⁹ personat në këtë fazë konsumojnë, më së shumti, pilula për gjumë dhe kundër dhimbjes.

Në shoqërinë tonë, gjithnjë e më shumë, është duke u rritur konsumimi i pijeve dehëse dhe substancave që krijojnë varësi, megjithatë asnjëherë nuk trajtohen në mënyrë profesionale, qoftë nga pikëpamja e ndikimit të tyre te konsumatorët, qoftë nga pikëpamja e ndikimit në shkatërrimin e lidhjeve të ndryshme sociale. Madje, varësitë e krijuara tek të moshuarit, qoftë edhe nga konsumimi i pakontrolluar i pilulave, mohohen e madje janë tema të padëshiruara për diskutim për shoqërinë në përgjithësi.

Të menduarit rreth ikjes nga izolimi

Mënyra e vetme e të pasurit të një jete të shëndoshë fizike e psikike dhe të pasurit të një jete të begatshme është pjesëmarrja aktive në shoqëri dhe të qenët aktiv në jetën e përditshme. Andaj, nëse mungon vullneti personal, atëherë duhen ndërmarrë hapa për realizimin e projekteve të ndryshme, të cilat mundësojnë një jetë të begatshme për personat në moshë të shtyrë.

9. Shih po të njëjtin burim të fusnotës 5.

Pikënisja e realizimit të projekteve është të kuptuarit se nuk ka kulturë shtetërore ose nacionale. Nuk ka kulturë shqiptare, për të gjithë popullin shqiptar, kudo që jeton, as kulturë shqiptare për banorët e Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë së Veriut, në tërësi apo secila veçmas. Natyrisht, janë elementet e ndryshme ato që e ndërlidhin një popull të tërë, por këto elemente assesi nuk janë elemente që përcaktojnë kulturën e përgjithshme edhe pse këto elemente herë mund të jenë më intensive dhe dalluese e herë më pak intensive në një shtet ose popull të caktuar. Pa dyshim, është e rëndësishme të kuptohet se, legjislatura e një shteti ose përcaktimet ligjore të një rajoni, mund të kenë ndikim në formësimin e elementeve të caktuara kulturore dhe të bëjnë që një grup më i madh shoqëror të njësohet përmes elementeve të tilla.

Kultura fillimisht është individuale, pastaj familjare, dhe në nivel më të gjerë e vendbanimit dhe së fundi rajonale. Në këtë rast kultura personale është tërësisht e ngjizur me individin, ndërsa ajo rajonale më e ngjizur me strukturat dhe elementet e sistemit social rajonal. Të kuptuarit e këtyre kulturave dhe elementeve të tyre të përbashkëta është shumë e rëndësishme për të kuptuar sjelljet, normat dhe vlerat nga ana e personave në moshë të shtyrë, me të cilët dhe për të cilët duam të zhvillojmë projekte mbështetëse.

Identifikimi dhe njohja e elementeve kyçe, mbi të cilat ndërtohen këto kultura, na mundësojnë të realizojmë një bashkëveprim më të lehtë me personat në moshë të shtyrë dhe të zhvillojmë projekte të pranueshme dhe larg konflikteve normative, morale e etike.

Andaj edhe hapi i parë i të menduarit rreth projekteve për personat në moshë të shtyrë është i lidhur ngushtë me njohjen e rrethit më të ngushtë social, me mundësitë e bashkëveprimit individual dhe me identifikimin e interesave grupore. Për këtë arsye duhen bërë përpjekje që gjatë zhvillimit të projekteve të përfshihen dhe persona të kësaj grup-moshe. Mbi këtë bazë njohjeje mund të zhvillohen tre lloj projektesh, të cilat kanë elemente, vlera dhe intensitete të ndryshme veprimi e bashkëveprimi:

- Projekte individuale
- Projekte vullnetare-rajonale
- Projekte zyrtare-institucionale

1. Projektet individuale

Nuk duhet harruar se të pasurit shtëpinë përplot me njerëz nuk do të thotë se për personat në moshë të shtyrë gjithçka është në rregull dhe se mungesat janë plotësuar. Asgjë nuk e zëvendëson nevojën individuale për të qenë pjesë e sistemeve të ndryshme sociale, për të marrë role të larmishme dhe për të konsumuar vlera të shumëfishta. Personat, në

këtë moshë, kanë nevojë të jenë pjesë aktive e familjes dhe shoqërisë, në mënyrë që të përjetojnë ndjenjën dhe mendimin e të qenët me vlerë. Në këtë rast projektet individuale janë pikënisja e inkuadrimit të personave në moshë të shtyrë nëpër projekte. Andaj, projektet duhet të fillohen që në familje përmes dhënies së detyrave, roleve dhe hapësirave të përshtatshme, që pleqtë të jenë pjesë aktive e familjes.

Nëse pleqtë janë të prirur të mos largohen nga shtëpia, atëherë nxitja e tyre për të vizituar objektet fetare do të ishte shumë e rëndësishme për neutralizimin e mundësisë për thellim në mendime dhe reflektim të së kaluarës, e që ky reflektim ndikon negativisht e mund të shpjerë në vet-shkatërrim. Ky thellim ndihmon të kuptuarit e jetës dhe ndërlihd të menduarit individual me një Fuqi më të lartë, gjë që përmirëson dukshëm stilin e jetës. Gjithashtu, angazhimi i tyre për të realizuar blerje të vogla për nevoja familjare do të ishte një projekt aktiv ku do të shfaqej “nevoja” dhe “varësia” e familjes nga ky veprim. Aktivitetet nuk duhet të jenë të natyrës “sa për sy e faqe”, por serioze dhe me vlerë. Gjithashtu, varësisht nga profesioni, njohuritë dhe përvoja, të kërkohet mbështetja e familjarëve e posaçërisht e nipërve dhe mbesave. Bashkëveprimi me nipërit dhe mbesat mund të realizohet në forma të ndryshme dhe luan rol të rëndësishëm për

ruajtjen e shëndetit fizik e psikik, si dhe ruajtjen e lidhjeve familjare. Në raste kur pleqtë janë të sëmurë ose të pamundur, atëherë vizita e tyre, hyrja në diskutim dhe trajtimi i temave të ndryshme është shumë e rëndësishme. Të gjithë këto lloje projektesh dhe shumë të tjera mund të realizohen pa ndonjë nevojë të mjeteve financiare dhe në këtë mënyrë janë të hapura për të gjithë personat, pavarësisht gjendjes së tyre materiale.

Së fundi, angazhimi individual për të mirë të familjes më të gjerë, vendbanimit dhe rrethit më të gjerë, është gjithashtu shumë i rëndësishëm, si për të mirën personale, ashtu edhe për të mirën shoqërore dhe ndërveprim aktiv kulturor.

2. Projektet vullnetare rajonale

Projektet vullnetare rajonale, të cilat mund të jenë edhe individuale, zakonisht, janë të organizuara për pjesëmarrje grupore, si për të mirën e grupit, ashtu edhe për të mirën e shoqërisë. Në këtë rast bëhet fjalë për projekte të cilat janë edukativo-arsimore, për transferim të kulturës, për transferim të dijes, për ndërveprim mes gjeneratave, për ndërveprim mes grupeve ose edhe për plotësim të një mungese shoqërore.

Për organizimin e projekteve të tilla rol të rëndësishëm mund të luajnë bashkësitë e ndryshme lokale,

organizatat e pavarura lokale e rajonale dhe bashkësitë e ndryshme fetare të vendbanimit e rajonit. Nxitja e projekteve mund të bëhet ose nga ana e personave ose nga ana e organizatave, ku në mënyrë të organizuar, sipas një plani të përcaktuar dhe një synimi të mirë-përcaktuar, ofrohen vlera për një grup të përzgjedhur shoqëror ose shoqërinë rajonale në përgjithësi. Projekte të tilla kërkojnë mbështetje financiare në funksion të arritjes së pjesës së synuar të shoqërisë dhe të ofrimit të vlerës së planifikuar.

Natyra vullnetare u jep mundësinë që këto projekte të bëhen tradicionale, dinamike dhe të kenë vlerën e një zhvillimi kulturor në nivel rajonal. Element i rëndësishëm pozitiv i këtyre projekteve është dinamika e ndryshimit të përmbajtjes dhe formës së organizimit, si dhe pavarësia në organizim e realizim.

3. Projektet zyrtare-institucionale

Organet e ndryshme shtetërore janë sisteme të mirë-organizuara dhe të ndërtuara nga elemente profesionale, të cilat ndjekin synime të përcaktuara në mënyrë profesionale. Profesionistët, në këtë rast, shfrytëzojnë burimet shtetërore dhe të dhënat statistikore për të identifikuar modelet e zhvillimeve shoqërore, nevojat e grup-moshave dhe nevojat kulturore rajonale e më gjerë. Në bazë të këtyre njohurive

zhvillohen projekte profesionale, të cilat kanë strukturë të mirë-përcaktuar, rrjedhë e cila përputhet me mundësitë dhe nevojat e pjesëmarrësve dhe ofrojnë vlerë të dobishme për të gjithë pjesëmarrësit, aktivë e pasivë. Projekte të tilla mund të jenë rajonale, kombëtare, ndërkombëtare e digjitale.

Është e rëndësishme që gjatë realizimit të projekteve të tilla të përfshihen të gjithë pleqtë, duke përfshirë edhe ata që jetojnë të vetmuar, janë jashtë sistemeve familjare dhe pleqtë që jetojnë nëpër azile apo shtëpi kujdesi.

Përmbyllje

Jeta e popullit shqiptar po zhvillohet gjithnjë e më shumë drejt modeleve të botës perëndimore. Ky ndryshim në disa dimensione është i dëshiruar e në disa i natyrshëm (qoftë edhe i padëshiruar nga grupe shoqërore). Sido që të jetë, është ndryshim i cili është duke ndodhur, andaj duhet pranuar si i tillë dhe duhet punuar me të. Nëse shtëpitë e pleqve janë tanimë “normale”, vajtimi dhe sulmi i tyre nuk është veprim profesional dhe nuk sjell asnjë dobi individuale e shoqërore. Çdo ndryshim dhe çdo rrjedhë kërkon trajtim profesional dhe çdo fenomen, i cili është i papranueshëm për një shoqëri, duhet trajtuar në mënyrë profesionale, për t’u mënjanuar ose për të gjetur rrugën për t’u trajtuar siç duhet.

Ndryshimet e përgjithshme kulturore dhe paraqitja e rrjedhave të reja, siç është tërheqja nëpër mikrofamilje dhe shkëputja e lidhjeve aktive me familjen më të gjerë, luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e pikëpamjeve, dëshirave dhe nevojave individuale. Në moshën e shtyrë, për shkak të kohës së lirë dhe mundësisë më të madhe për vetë-reflektim, këto ndryshime vërehen me intensitet edhe më të lartë dhe pasojat janë më të mëdha. Andaj, zhvillimi i projekteve në të mirë të personave në moshë të shtyrë dhe në të mirë të shoqërisë në përgjithësi është shumë i rëndësishëm për të ruajtur stabilitetin shoqëror dhe për të mbushur plasaritjen e zhvillimeve të përgjithshme kulturore dhe ngecjeve individuale e familjare në zhvillim.

Gjendja jonë aktuale është e dhimbshme ku, në njërin anë,

ndryshimet janë të dukshme dhe urrejtja e mospranimi është e nivelit të lartë dhe, në anën tjetër, mungesa e angazhimit për të ndryshuar ose përballuar gjendjen është evidente. Ne duhet të ngremë më lart vetëdijen tonë, të jemi më vigjilent ndaj ndryshimeve dhe më këmbëngulës në mbështetjen ose refuzimin e tyre. Ndryshimet e pranueshme, qofshin edhe të padëshiruara, duhen përcjellë me aktivitete, të cilat na bëjnë më të afërta me to ose më të mbrojtur prej tyre.

Ne si shoqëri, si rajon, si familje e individë, duhet të jemi të vetëdijshëm për nevojat tona dhe mundësinë për plotësimin e tyre. Andaj, bazuar në njohuritë mbi gjendjen aktuale dhe nevojat individuale e grupore, duhen zhvilluar projekte të cilat rrisin vetëdijen personale e shoqërore dhe ruajnë stabilitetin kulturor e social.

Fëmijët dhe të drejtat e tyre

Mr. sc. Bahri Curri

Abstrakt

Familja është bërthama e shoqërisë dhe suksesi i saj është suksesi i shoqërisë. E fëmijët janë fryti i familjes, dhe shpresa për ardhmërinë e familjes dhe të tërë popullit.

Natyrisht që të kesh fëmijë është një dhuratë e paçmuar nga Zoti për njeriun, një nder dhe privilegj që të bën të ndjehesh i lumtur, por është edhe barrë e përgjegjësi që kërkon mund e kujdes të shtuar.

Si vajza edhe djali janë begati e paçmueshme, të cilët, pa dallim, janë të rëndësishëm dhe kanë të drejtat e tyre jetike. Edhe pse te shqiptarët, por jo vetëm, ekziston dëshira dhe animi i tyre kah djemtë më tepër sesa për vajzat, kjo në Islam është e urryer dhe këtë gjë e dënon edhe Kur'ani duke na rrëfyer praktikën e keqe të njerëzve para Islamit, pra në kohën e injorancës, kur vajza ishte e privuar nga çdo e drejtë, madje shpesh edhe nga e drejta e jetës.

Duke qenë se fëmijëria është faza e parë në jetën e njeriut, Feja Islame kujdeset shumë për të dhe i kushton vëmendje të madhe. Islami është i pari që merret me të drejtat e fëmijëve që nga Mesjeta dhe i ka paraprirë kohëve moderne me më shumë se pesëmbëdhjetë shekuj. Kjo për faktin se fëmijët janë e ardhmja dhe shpresa e së nesërmes. Islami ka përcaktuar një kushtetutë gjithëpërfshirëse për të drejtat e fëmijës, që përmban të drejtat e tij para lindjes së tij, kur ai është embrion, dhe pas kësaj në etapat e ndryshme të fëmijërisë së tij. Islami konsideron si fëmijë atë që nuk ka arritur pubertetin (moshën e pjekurisë) dhe kjo nuk e kalon moshën pesëmbëdhjetë vjeç.

Mirësitë e Allahut janë dhuratë për ne

Mirësitë e Allahut ndaj nesh janë të llojllojta e të panumërta. Disa prej tyre janë të dukshme dhe të

njohura, begatinë e të cilave mund ta perceptojmë lehtësisht. Ndërsa disa të tjera janë të padukshme e të fshehura që nuk mund ta kuptojmë urtësinë e tyre me shikim të parë pa një hulumtim të mirëfilltë. Andaj

edhe Allahu na thotë në Kur'an:

وَأِنْ تَعَدُّوا نِعْمَتَ اللَّهِ لَا تَحْصُوهَا

“...Edhe në qoftë se përpiqeni që t'i numëroni të mirat e Allahut, nuk do të mund të arrini që t'i përkufizoni (në numër).”¹

E begatia më e madhe është Islami, pa të cilin do të mbretëronte kaosi në botë.

Fëmijët janë dhuratë nga Allahu

Prej dhuratave të çmueshme për njeriun, padyshim që janë edhe fëmijët, të cilët vetë Allahu i quan dhuratë:

لِلَّهِ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ يَهَبُ لِمَنْ يَشَاءُ إِنثًا وَيَهَبُ لِمَنْ يَشَاءُ الذَّكَورَ

“Vetëm Allahut i takon pushteti i qiejve e i tokës; Ai krijon çka të dojë; Ai i falë (dhuron) vetëm vajza atij që do; e i falë (dhuron) vetëm djem atij që do.”²

Natyrisht që të kesh fëmijë është nder dhe privilegj dhe të bën që të ndjehesh i lumtur, por më tepër është barrë dhe përgjegjësi që kërkon mund e kujdes të shtuar.

Si vajza, si djali janë begati e paçmueshme, të cilët, pa dallim, janë të rëndësishëm dhe kanë të drejtat e tyre jetike. Edhe pse te shqiptarët, e jo vetëm te shqiptarët, por pothuajse në çdo popull, ekziston dëshira dhe animi i tyre kah djemtë më tepër sesa

për vajzat. Gjë e cila është e urryer në Islam dhe këtë gjë e dënon edhe Kur'ani, duke na rrëfyer praktikën e keqe të njerëzve para Islamit, pra në kohën e injorancës, kur vajza ishte e privuar nga çdo e drejtë, madje shpesh edhe nga e drejta e jetës. Allahu thotë në Kur'an:

وَإِذَا بُشِّرَ أَحَدُهُمْ بِالْأُنثَىٰ ظَلَّ وَجْهُهُ مُسْوَدًّا وَهُوَ كَظِيمٌ

“Kur ndonjëri prej tyre (baballarëve) lajmërohet me (lindjen) vajzë, fytyra e tij prishet dhe bëhet plot mllef.”³

Ku disa prej tyre, nga mllefi pse i ka lindur vajzë, edhe i kanë varrosur vajzat e tyre për së gjalli. Prandaj na thotë Kur'ani:

وَإِذَا الْمَوْءِدَةُ سُئِلَتْ بِأَيِّ ذَنْبٍ قُتِلَتْ

“Dhe kur të pyeten ato vajza të varrosura të gjalla, për çfarë mëkati ato janë mbytur?”⁴

Madje jo vetëm vajzat që i kanë varrosur për së gjalli, por edhe nënat e tyre i kanë qortuar dhe ndëshkuar pse kanë lindur vajza e jo djem.

Edhe pse ajeti 49 i mësipërm i sures Shura i përmend vajzat para djemve, që tregon se edhe vajza është me vlerë, e dashur dhe e rëndësishme, madje me përparësi para djemve. Profeti a.s. me theks të veçantë përmend vajzat në edukimin dhe kujdesin ndaj tyre e thotë:

مَنْ كَانَ لَهُ ثَلَاثُ بَنَاتٍ فَصَبَّرَ عَلَيْهِنَّ، وَأَطَعَمَهُنَّ، وَسَقَاهُنَّ، وَكَسَاهُنَّ مِنْ جِدَّتِهِ كُنَّ لَهُ حِجَابًا مِنَ النَّارِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ

1. Ibrahim, 14:34.

2. Shura, 42:49.

3. Nahl, 16:58.

4. Tekuir, 81:8-9

“Kush i ka tri vajza dhe bën sabër ndaj tyre, i ushqen dhe i veshmbathë prej pasurisë që ia ka dhënë Zoti, ato do të jenë për të perde prej zjarrit të Xhebenemit.”⁵

Hadithi nuk përkufizohet vetëm në numrin tre, por edhe kush ka dy apo edhe vetëm një vajzë. Po ashtu kjo s’ka të bëjë vetëm me vajzat, por kjo përfshinë të gjitha femrat, qoftë motër, hallë, teze, etj. Hadithi nxit kujdestarin, e në këtë rast të dy prindërit, që të bëhen të durueshëm me to. Do të thotë të durueshëm në rritjen, edukimin, disiplinimin dhe përgatitjen e tyre, po ashtu edhe në furnizimin e tyre brenda mundësive e kapaciteteve të tyre si ushqimi, veshmbathja, etj.

Profeti a.s., kur iu dha lajmi për lindjen e vajzës së tij, Fatimes, është gëzuar aq shumë sa që thoshte: *“Ajo është një aromë e këndshme që po e ndjej, ndërsa furnizimi i saj i takon Allahut!”*, pra lindjen e vajzës e sheh si bekim dhe bereqet.

Fëmijët janë zbukurim i jetës së kësaj bote

Fëmijët janë zbukurim dhe hijeshi e jetës në këtë botë. Allahu, në Kur’anin Famëlartë, na tregon:

الْمَالُ وَالْبَنُونَ زِينَةُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا

“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote”⁶.

Natyrisht, që ku ka fëmijë ka gjallëri, gëzim e lumturi. Zëri i

fëmijëve mbush shtëpinë, jo vetëm me zhurmë, por edhe me shpresë e kurajë. Andaj edhe Profeti a.s. na dëfton se edhe xhamitë që gumëzhijnë nga zhurma e fëmijëve janë shpresë dhe perspektivë për atë popull. Për këtë arsye i shohim sahabët të merrnin edhe fëmijët e tyre në xhami për t’i kalitur e mësuar fëmijët me xhaminë dhe frymën e saj. Madje mbanin edhe ëmbëlsira me vete, që në rast mërzitjeje të fëmijës nga qëndrimi në xhami ua jepnin atyre për t’i qetësuar.

Familja

Familja është bërthama e shoqërisë dhe sukseesi i saj është sukseesi i shoqërisë. E fëmijët janë fryti i familjes dhe shpresa për ardhmërinë e familjes si dhe të tërë popullit. Andaj dhe Islami i ka urdhëruar anëtarët e familjes me shumë detyra dhe u ka dhënë të drejta që duhen respektuar, e ndër këto të drejta janë edhe të drejtat e fëmijëve, të cilat shumë njerëz nuk i trajtojnë fare, apo edhe nëse i trajtojnë, nuk e bëjnë atë si duhet.

Të drejtat e fëmijëve

Kohët e fundit po flitet shumë për të drejtat e fëmijëve, për Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, për traktate e konventa të ndryshme që garantojnë të drejtat e fëmijëve. Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve është kthyer jo vetëm në një ditë festive, por edhe në një ditë për t’i thënë jo

5. Transmeton Ibn Maxhe, nr. 2974. Albani e konsideron hadith sahih.

6. Kehf, 18:46.

dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve. Është dita kur vetë fëmijët shprehen lirshëm për të thënë të drejtat e tyre.

Dita e fëmijëve u vendos në datën 1 qershor, sepse në këtë datë është mbajtur Konferenca Botërore e Mirëqenies së Fëmijëve në Gjenevë, në vitin 1925. Dy vjet më vonë, Festa e 1 qershorit filloi që të festohet në të gjithë botën.

Vendet të cilat e festojnë Ditën Botërore të Fëmijëve më datën 20 nëntor e bëjnë këtë në përkujtim të Deklaratës për të Drejtat e Fëmijëve të miratuar nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor të vitit 1959. Ndërsa Konventa për të Drejtat e Fëmijëve e konsideron fëmijë çdo qenie njerëzore që nuk ka mbushur 18 vjet.

Islami është i kujdesshëm për të ruajtur dhe mbrojtur njeriun në të gjitha fazat e jetës së tij. Allahu i Lartësuar thotë:

وَلَقَدْ كَرَّمْنَا بَنِي آدَمَ وَحَمَلْنَهُمْ فِي الْوَحْشِ وَالْبَحْرِ وَرَزَقْنَهُم مِّنَ الطَّيِّبَاتِ وَفَضَّلْنَاهُمْ عَلَىٰ كَثِيرٍ مِّمَّنْ خَلَقْنَا تَفْضِيلًا

“Ne vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), ua mundësuam atyre që të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuam ata (i lartësuar) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam.”⁷

Duke qenë se fëmijëria është faza e parë në jetën e njeriut, Islami kujdeset shumë për të dhe i kushton

7. Isra', 17:70.

vëmendje të madhe. Për këtë arsye Islami është i pari që merret me të drejtat e fëmijëve që nga Mesjeta dhe i ka paraprirë kohëve moderne me më shumë se pesëmbëdhjetë shekuj. Kjo për faktin se fëmijët janë e ardhmja dhe shpresa e së nesërme. Islami ka përcaktuar një kushtetutë gjithëpërfshirëse për të drejtat e fëmijës që përmban të drejtat e tij para lindjes së tij, që kur ai është embrion, dhe pas kësaj në vitet e ndryshme të fëmijërisë së tij. Islami përcakton si fëmijë atë që nuk e ka arritur pubertetin (moshën e pjekurisë) dhe kjo nuk e kalon moshën pesëmbëdhjetë vjeç.

Pra Islami ua ka garantuar të gjithë fëmijëve të drejtat e tyre në të gjitha fazat e tyre të jetës, derisa të arrijnë pjekurinë, aftësinë dhe zotësinë për t'u mbështetur pastaj në forcat e veta për të përmbushur e siguruar nevojat dhe kërkesat e tyre.

Në vijim do të mundohemi që t'i cekim radhazi dhe t'i trajtojmë shkurtimisht.

E drejta e përzgjedhjes së prindërve

Fëmija ka të drejtë që të ketë prindër, dhe që të jenë prindër të mirë e besimtarë. Andaj Islami na mëson që për fëmijët e ardhshëm duhen zgjedhur prindër të mirë, besimtarë e të edukuar. Madje edhe thuhet edukoni fëmijët 20 vjet para se të lindin fëmijët, pra me edukimin e çiftit bashkëshortor para lindjes së

fëmijëve, gjë e cila pastaj reflektohet te fëmijët. Kjo për arsye se prindërit e edukuar e të përkushtuar me bindje ndaj Zotit, përveç kujdesit të veçantë ndaj fëmijëve, edhe me vetë praktikën e tyre të përditshme i frymëzojnë dhe i edukojnë fëmijët në frymën e shëndoshë. Kjo edhe mund të quhet si edukim i heshtur që ka shumë efekt pozitiv. Për këtë arsye fëmija ka të drejtë që të ketë prindër që e kuptojnë dhe e zbatojnë prindërimin e mirë.

Prandaj për këtë Profeti a.s. iu thotë djemve:

تُنَكِّحُ الْمَرْأَةَ الْأَرْبَعَ: لِمَالِهَا، وَلِحَسَبِهَا، وَلِجَمَالِهَا، وَلِلَّيْنِهَا، فَاطْفَرُ
بِذَاتِ الْدِّينِ تَرَبَّتْ بِذَاكَ

“Gruaja martohet për katër gjëra: Për pasurinë e saj, për prejardhjen e saj, për bukurinë e saj dhe për fenë e saj. Zgjidh gruan fetare, do të jesh i lumtur (i kënaqur).”⁸

Ndërsa vajzave iu thotë:

إِذَا خَطَبَ إِلَيْكُمْ مَنْ تَرْضَوْنَ دِينَهُ
وَجُلُقَهُ فَرُوجُوهُ، إِلَّا تَفْعَلُوا تَكُنْ فِتْنَةً فِي
الْأَرْضِ، وَفَسَادٌ عَرِضٌ

“Nëse një person, që e pëlqeni fenë dhe moralin e tij, ju ofron martesë, martojeni. E nëse e refuzoni këtë, dijeni që bëni fitne dhe trazira në tokë.”⁹

Me një fjalë, standardet themelore e fillestare përpërzgjedhjen e bashkëshortit/bashkëshortes

duhet të jenë feja dhe morali, e më pastaj të shikohen edhe të tjerat. Hadithi na tërheq vërejtjen që nëse nuk respektohen këto standarde rrezikohet humbja e bereqetit dhe e lumturisë, si dhe shkaktimi i shumë telasheve e problemeve.

E drejta e origjinës-prejardhjes

Fëmija ka të drejtën e jetës së shëndetshme familjare, të ketë dy prindër të martuar ligjërisht dhe t'i njohë ata. Të dihet prejardhja e tij dhe lidhja farefisnore... Për këtë dhe Islami ka ndaluar imoralitetin dhe prostitucionin që të mos përzihet origjina e fëmijës, si dhe fëmija të përjetojë atësinë dhe amësinë, e të ndjejë ngrohtësinë dhe krenarinë e origjinës. Pra, të ketë moral publik dhe të bëjë jetë të dinjitetshme e jo të ndihet i turpëruar.

E drejta për të jetuar

E drejta për jetë ndërlihet me dy fazat e jetës së fëmijës. Faza e parë ka të bëjë para lindjes së tij, sa është në barkun e nënës pas ngjizjes dhe dhënies së shpirtit. Në këtë rast ndalohet vrasja e fëmijës në barkun e nënës, pra marrja e jetës së tij përmes abortit, apo formave të tjera. Pra, aborti në Islam ndalohet rreptësisht, me përjashtim të rastit kur rrezikohet edhe jeta e nënës, atëherë dijetarët e lejojnë me kushte specifike. Në këtë fazë edhe Allahu i Madhërishëm heq dorë nga e drejta

8. Transmeton Muslimi, nr. 1466.

9. Transmeton Tirmidhiu, nr. 1084, dhe Ibn Maxhe, nr. 1967. Albani e konsideron hadith hasen.

e Tij e agjërimit, nga haku i agjërimit që njerëzit detyrohen të agjërojnë për Allahun, heq dorë në favor dhe në të mirë të shëndetit të fetusit, por edhe të shëndetit të nënës. Pra gruaja shtatzënë ka të drejtë që të mos agjërojë për të ruajtur shëndetin e fëmijës në bark dhe shëndetin e saj.

Ndërsa faza e dytë ka të bëjë pas lindjes së tij. Ndodh që disa njerëz i vrasin fëmijët për arsye të ndryshme, siç e cekëm më lart që kanë mbytur fëmijët e tyre pas lindjes për shkak se kanë lindur vajza e jo djem. Por ka edhe të atillë që i mbysin edhe nga frika e varfërisë, gjë që është e ndaluar në Islam. Allahu, në Kur'an, thotë:

وَلَا تَقْتُلُوا أَوْلَادَكُمْ خَشْيَةَ إِمْلَاقٍ نَحْنُ نَرْزُقُهُمْ وَإِيَّاكُمْ إِنَّ قَتْلَهُمْ كَانَ خِطْئًا كَبِيرًا
 “Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve, e mbytja e tyre është mëkat i madh.”¹⁰

Pra ka drejtë, jo vetëm për të jetuar, por edhe që të bëjë një jetë të denjë e fisnike derisa të bëhet i zoti i vetvetes dhe të marrë përgjegjësi.

E drejta e trashëgimisë dhe e pronësisë

E drejta e trashëgimisë dhe e pronësisë si e drejtë e natyrshme dhe bazike ndër të drejtat e njeriut, edhe fëmija, që para lindjes, me rastin e dhënies së shpirtit në barkun e nënës, e zotëron të drejtën e trashëgimisë, si

10. Isra', 17:31.

dhe t'i vihen në pronësi të mira të ndryshme materiale.

E drejta e kujdesit para lindjes dhe gjatë lindjes

Islami obligon prindërit për kujdes të veçantë për fëmijën para lindjes, gjeëgjësisht gjatë shtatzënisë, më konkretisht e ngarkon babanë për shpenzimet e nevojshme, qoftë gjatë shtatzënisë, lindjes dhe ushqyerjes me qumësht gjiri, ku Allahu xh.sh. thotë:

وَإِنْ كُنَّ أُولَاتٍ حَمْلٌ فَأَنْفِقُوا عَلَيْهِنَّ حَتَّى يَضَعْنَ حَمْلَهُنَّ فَإِنْ أَرْضَعْنَ لَكُمْ فَآتُوهُنَّ أَجُورَهُنَّ

“Në qoftë se ato (gratë) janë shtatzëna, atëherë furnizoni ato derisa ta heqin barrën e tyre (të lindin), e nëse ato u japin gji fëmijëve tuaj, atëherë jepuani atyre shpërblimin që u takon!”¹¹

Procesi i lindjes është një moment i ndërlikuar dhe i vështirë, shpesh edhe i rrezikshëm. Andaj edhe është e drejtë e fëmijës që t'i sigurohet një lindje e sigurt dhe pa pasoja, qoftë për të apo edhe për nënën e tij. Duhet që të merren të gjitha masat e mundshme për një përgatitje të tillë.

E drejta ceremoniale pas lindjes

Islami na mëson për disa gjëra që duhet t'i bëjmë me fëmijët tanë pas lindjes së tyre, si t'i këndohet ezani në veshin e djathtë, ndërsa ikameti në veshin e majtë. Po ashtu

11. Talak, 65:6.

t'i fërkohet me gisht qiellza e gojës me një copëz hurme të zbutur.

E drejta e emërimit

E drejtë e fëmijës është që të ketë një emër të mirë dhe kuptimplotë. Madje çdo prind është përgjegjës për përzgjedhje të një emri të bukur. Profeti a.s. thotë:

حق الولد على الوالد أن يحسن اسمه ويحسن أده

“E drejtë e fëmijës që e detyron prindin është ngjitja e emrit të mirë dhe edukimi i mirë.”¹²

Prandaj duhet emërtuar me emër të bukur, meqë emri i tij mund të aludojë për vlerat e së ardhmes së tij. Profeti a.s., gjithashtu, thotë:

إِنَّكُمْ تُدْعَوْنَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ بِأَسْمَائِكُمْ وَأَسْمَاءِ آبَائِكُمْ فَاحْسِنُوا أَسْمَاءَكُمْ

“Ju do të thirreni në Ditën e Gjykimit me emrat tuaj dhe me emrat e prindërve tuaj, andaj zgjidhni emra të bukur në emërtim!”¹³

Prandaj është e rëndësishme që të zgjidhet një emër i mirë për fëmijën dhe të shmanget zgjedhja e emrave të shëmtuar e me kuptime të shëmtuara.

E drejta e synetimit

Islami bën thirrje për synetimin e fëmijëve djem që është në pajtim edhe me fenë e pastër të Ibrahimit a.s. Kjo është një natyrshmëri e pastër e praktikuar më herët, por që sot edhe shkenca mjekësore

12. Bejhekiu, “Shuab el-Iman”, 6/2901.

13. Es-Sujutij, “El-Xhamiu es-Sagîr”, nr. 2533.

bën thirrje për një veprim të tillë, i cili është shumë i dobishëm e i shëndetshëm.

E drejta e akikas

Për fëmijën e lindur preferohet që të bëhet akika, që është therja e një dashi për lindjen e tij në shenjë falënderimi ndaj Allahut për këtë dhuratë të çmueshme. Gjë e cila mundësisht të bëhet në ditën e shtatë, ose të katërmëdhjetë, apo të njëzetë e njëtë, e nëse jo, atëherë kurdo që mundet.

E drejta e ushqyerjes me qumësht gjiri

E drejta e të ushqyerit është e drejtë jetike themelore e fëmijës, e veçanërisht e qumështit të gjirit, për shkak se kjo ka rëndësi të madhe për zhvillimin e fëmijës në të gjitha aspektet, fizike apo mendore qofshin ato. Dhënia e gjirit, përveç zhvillimit fizik, forcon imunitetin dhe siguron për fëmijën ushqimin e duhur të cilin gjiri i nënës e prodhon sipas nevojave të fëmijës në çdo orë e në çdo ditë. Andaj dhe Allahu i lartësuar e detyron të ushqyerit e fëmijës me gjë për dy vjet të plotë, dhe thotë:

وَالْوَلَدُ يُرْضَعُ أَوْلَدَهُ حَوْلَيْنِ كَامِلَيْنِ لِمَنْ أَرَادَ أَنْ يُتِمَّ الرَّضَاعَةَ

“Nënat, ato që duan ta plotësojnë dhënien e gjirit, janë të detyruara që t’u japin gjë fëmijëve të vet dy vjet të plota!”¹⁴

Për këtë arsye nuk i lejohet që ta

14. Bekare, 2:233.

zëvendësojë atë me ushqim artificial, përderisa e ka qumështin e gjirit. Por nëse nuk i mjafton qumështi i gjirit, atëherë ia shton atë edhe me artificial, e jo t'i zëvendësohet.

Për këtë edhe organizata të shumta botërore, që nga mesi i shekullit të kaluar dhe në këto dy dekada që po jetojmë, thërrasin drejt të ushqyerit natyral të fëmijës me gji.

E drejta e shtetësisë, përcaktimit etnik, fetar e politik

Këto të drejta të fëmijës përcaktohen sipas përcaktimit të prindit, derisa fëmija të arrijë moshën e pjekurisë e që më vonë ai ka të drejtë që të ripërcaktohet për këto gjëra, apo t'i vazhdojë ato. Profeti a.s. ka thënë:

كُلُّ مَوْلُودٍ يُوَلَّدُ عَلَى الْفِطْرَةِ، فَأَبَوَاهُ يُهَوِّدَانِهِ، أَوْ يُنَصِّرَانِهِ

“Çdo fëmijë lind me natyrshmëri të pastër (islame), e më pas prindërit janë ata që e bëjnë atë çifut, apo të krishterë...”¹⁵

E drejta e kujdesit shëndetësor

Fëmija ka të drejtë për kujdes shëndetësor, vëmendje ndaj të gjitha kërkesave dhe nevojave të tij për një jetë të denjë e të shëndetshme.

E drejta e mbrojtjes

Islami ia ka siguruar fëmijës të drejtën e mbrojtjes dhe është një nga të drejtat më të rëndësishme që duhet t'i jepet fëmijës. Fëmija duhet

15. Transmeton Buhariu, nr. 1385.

që të mbrohet nga neglizhenca, keqtrajtimi, abuzimi, ngacmimi, bulizmi, etj... Ndjenja e sigurisë është shumë e rëndësishme për të krijuar një familje të suksesshme. Islami është fokusuar gjithashtu në mbrojtjen e fëmijëve nga luftërat dhe fatkeqësitë.

E drejta e shprehjes dhe pjesëmarrjes

Islami i ka dhënë fëmijës të drejtën për t'u shprehur dhe për të marrë pjesë në një opinion, kështu që ai duhet të dëgjohet.

E drejta e edukimit

Prindërit e kanë detyrim që t'i edukojnë fëmijët e tyre. Po flasim për edukim islam, edukim moral, edukim shoqëror; edukim të mirëfilltë. Prandaj fillimisht kërkohet që prindërit të marrim edukatë e të parapërgatiten e pastaj këtë edukim t'ua përcjellin edhe fëmijëve të tyre, sepse, prindërit janë përgjegjës para Allahut për edukimin e fëmijëve. Fëmija duhet që të edukohet me parimet e Islamit, të mësohet si të sillet me mirësjellje me të tjerët, të mësojë përmendësh Kur'anin Fisnik, të mësojë të falet dhe si të marrë abdes.

E drejta e shkollimit

Po ashtu, prej të drejtave të fëmijës pas lindjes është edhe e drejta e shkollimit. Fëmijët kanë të drejtën e shkollimit, sepse këtë të

drejtë ua ka rezervuar Allahu qysh para 15 shekujsh. Të kenë shkollim e përgatitje të duhur në të gjitha fushat e jetës, si dhe përgatitjen profesionale, aty ku fëmija e sheh veten të denjë, ashtu edhe përgatitjen fetare. Pra ka të drejtë për arsimim, duke përdorur metoda moderne dhe të ndryshme

E drejta e ushtrimit të drejtësisë

Prej të drejtave të fëmijëve është edhe e drejta e ushtrimit të drejtësisë me ta. Prindërit e kanë për detyrë që të mbajnë drejtësi mes fëmijëve. Të mos bëjnë dallime mes fëmijëve për nga mosha ose gjinia, sepse kanë përgjegjësi para Allahut. Profeti a.s. thotë:

فَاتَّقُوا اللَّهَ وَاَعْدِلُوا بَيْنَ اَوْلَادِكُمْ
 “Kini frikë Allahun dhe mbani drejtësi mes fëmijëve tuaj.”¹⁶

Përveçse nëse ndonjë fëmijë ka nevoja të veçanta e specifike. Me një fjalë tjetër duhet të mbahet drejtësi në dhënie, drejtësi në edukim, drejtësi në dashuri, drejtësi në respekt e kështu me radhë.

E drejta emocionale

Fëmija ka të drejtë që të përjetojë ndjenjën se dikush e do atë, dhe është i dashur e i dëshiruar nga dikush si nga prindërit, familja e më gjerë. Pra, kjo e drejtë emocionale, që nënkupton ta duash fëmijën, ta afrosh atë, ta ndiesh kënaqësinë e të pasurit fëmijë, kënaqësinë e kësaj dhurate që ta ka

16. Transmeton Buhariu, nr. 2587.

dhënë Allahu. Profeti a.s. thotë:

مَنْ لَا يُرَحِّمُ لَا يُرَحِّمُ
 “Ai i cili nuk mëshiron, nuk do të mëshirohet.”¹⁷

Kjo është e një rëndësisë të veçantë, sikurse edhe përqaftimi e loja. Profeti a.s. ka urdhëruar që fëmijët të përkëdhelen, të puthen, të përqafohen dhe të afrohen, pasi kjo konsiderohet mëshirë për ta.

E drejta e përkujdesjes

Fëmija pas lindjes, duke qenë se është një qenie dobët, ka të drejtën e përkujdesjes për të, të cilën ia ka garantuar Islami. Dhe këtë përkujdesje paraprakisht ua ngarkon prindërve, të drejtë të cilën ua ka rezervuar fillimisht atyre. Ngase fëmija është nga mishi dhe gjaku i tyre, andaj edhe kujdesen më së miri për të, po ashtu edhe i përballojnë më lehtë vuajtjet e mundimet e përjetuara gjatë rritjes së tij. Mirëpo në rast se ndahen prindërit, atëherë nëse fëmija është në moshën e hershme e drejta e përkujdesjes i takon nënës, e më pas kur të rritet, apo nëse nëna e divorcuar martohet, atëherë fëmija kthehet te babai. E në rast se prindërit mungojnë, atëherë këtë përkujdesje e merr përsipër shteti.

E drejta e zhvillimit dhe rendimentit të mirë

Prej të drejtave të fëmijëve është edhe e drejta e ngritjes së rendimentit

17. Transmeton Buhariu, nr. 6013.

apo efektshmërisë së fëmijës, sepse, në kohën që po flasim, zhvillimi është shumëdimensional, kështu që duhet të integrohen aftësitë e fëmijës. Profeti a.s. thotë:

عَلِّمُوا أَبْنَاءَكُمْ السَّابِغَةَ، وَالرَّمَايَةَ
 “Mësojani fëmijëve tuaj notin dhe shigjetimin!”¹⁸

Shto këtu edhe shumë vlera të kohës sonë, që mund ta ngrenë rendimentin dhe aftësinë me kurse të ndryshme e në shkathhtësi të ndryshme.

E drejta për furnizim e shpenzime

Islami e detyron prindin, veçanërisht familjen, që të sigurojë për fëmijën furnizimet dhe shpenzimet e duhura, në mënyrë që ai të gëzojë një jetë shoqërore të lumtur e dinjitoze. Prandaj, duhet që të sigurohen ushqimi, veshmbathja, strehimi, një vend për edukim dhe të gjitha nevojat e tjera të fëmijës. Ky furnizim duhet të vazhdojë dhe është i detyrueshëm për kryefamiljarin derisa fëmija të arrijë moshën e

pubertetit. Deri atëherë kur fëmija do të jetë moshë-rritur dhe i zoti i vetes, i cili përmbush të gjitha nevojat e veta dhe që mund të punojë e të sigurojë të ardhura të përshtatshme.

E drejta për lojë, argëtim e zbavitje

Loja, argëtimi e zbavitja janë të drejta ligjore, që i takojnë fëmijës, me të cilat detyrohen prindërit që t’ia sigurojnë fëmijës. Fëmija duhet që një kohë të caktuar ta kalojë dhe të ndjejë veten komod me lojëra e zbavitje si me prindër, me vëllezër e motra dhe me familjarë tjerë. E tëra kjo në suaza të duhura e në korniza të lejuara etike.

Kujdesi për jetimët

Disa fëmijë mbesin jetimë që në ditët e para të jetës së tyre, duke humbur njërin apo të dy prindërit. Por për të mos mbetur pa përkujdesjen e duhur e të merituar, Islami i detyron të gjithë myslimanët që të kujdesen për këta fëmijë, t’iu sigurojnë atyre të gjitha nevojat e tyre dhe t’u sigurojnë e mundësojnë atyre një jetë të denjë.

18. Es-Sujutij, “*El-Xhamiu es-Sagîr*”, nr. 5460.

Abdullah Nasih Ulvan, Terbijjetu el-Evlad fi el-Islam; Dar es-Salam li et-Tiba'ati ve en-Neshri ve et-Tevzi'i, botimi 21, 1412h-1992.

Ajetu Nasir, Hukuk et-Tifl fi el-Islam; <https://mqaall.com/child-rights-islam-referenc-es/?fbclid=IwAR16ZWbDXbFCwThkPqF2bsqADYA9zA5smI3YG0CH0KIX2vKzTsIDxmRUC1w>

Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve; www.sq.wikipedia.org/wiki/Dita_ndërkombëtare_e_fëmijëve

<https://lwworc.org/sq/who-rights-of-the-child>

Musa el-Esved, Hadhihi Hije Hukuk el-Atfal fi el-Islam; www.alqabas.com/article/452278-هذه-هي-حقوق-الأطفال-في-الإسلام

Revan Sa'd Atik el-Harbij, Min Hukuk et-Tifl fi el-Islam; www.alukah.net/social/0/138628/من-حقوق-الطفل-في-الإسلام/?fbclid=IwAR3i4jwfmVXcrEtN9Eb0m6N9IWJ3cwtwvGMO8nCNUYLy0IESIUmfBaNk-U8

www.mqaall.com/unicef-childrens-rights/

www.unicef.org/albania/sq/konventa-e-të-drejtave-të-fëmijëve-kdf

www.unicef.org/child-rights-convention/convention-text-childrens-version

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës; www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf?fbclid=IwAR04ikN-WNRS-qzF1LC6RW07-Uj34iOzbLblo-XKHpxh7rztg6ykgFrYyk

Zinad es-Sabbah, Bahthun an Hukuk et-Tifl fi el-Islam; www.mawdoo3.com/بحث_من_حقوق_الطفل_في_الإسلام?fbclid=IwAR0CT1Suust-koIM2No1nbpmcePem7stqfptOc1-bDQmuxGfgPRptQ

Line Hamud, Sherh Hadith Men Kane lehu Thelathu Benatin fe Sabere Alejhinne; [www.mawdoo3.com/شرح_حديث_\(من_كان_له_ثلاث_بنات_فصبر_عليهن\)?fbclid=IwAR3i4jwfmVXcrEtN9Eb0m6N9IWJ3cwtwvGMO8nCNUYLy0IESIUmfBaNk-U8#cite_note-ee9464ee_a110_41cf_a7cd_9b1d69450487-15](http://www.mawdoo3.com/شرح_حديث_(من_كان_له_ثلاث_بنات_فصبر_عليهن)?fbclid=IwAR3i4jwfmVXcrEtN9Eb0m6N9IWJ3cwtwvGMO8nCNUYLy0IESIUmfBaNk-U8#cite_note-ee9464ee_a110_41cf_a7cd_9b1d69450487-15)

Zhvillimi juridik i së drejtës së pronësisë së Institucioneve Fetare në Shqipëri

Prof. asc. dr. Saimir Shatku
Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Pronësia përbën një nga të drejtat më të vjetra, të lindura bashkë me njerëzimin, e cila konsiston në të drejtën e individit për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji civil dhe juridiksioni hyjnor.

E drejta e pronësisë së komuniteteve fetare paraqet një ndër institutet juridike me të rëndësishme të të drejtave reale pronësore, në përgjithësi, dhe gjithashtu përbën formën kryesore të ushtrimit të të drejtave të njeriut mbi sendet, duke u kthyer në katalizatorin e të gjithë zhvillimit ekonomik të një vendi.

Përgjatë viteve të diktaturës vërehej bashkekzistenca e regjimit me tipare kapitalizmi dhe socializmi, ku ky i fundit do të triumfojë në vitin 1976 me miratimin e Kushtetutës së re, në të cilën sanksionohej zhdukja e pronës private. Me këtë kushtetutë u eliminua tërësisht domeni i pronës dhe i të drejtave reale të lidhura me të, e individit u zhvesh nga çdo e drejtë mbi pronën, pasi kështu i nevojitej “interesit të përgjithshëm” politik të vendit, duke cenuar, në këtë mënyrë, drejtpërdrejt ushtrimin e të drejtës së lirë të pronës private të individit.

Bilanci i humbjes pasurore dhe pronësore ishte tepër i madh, ku rreth 1 milion metra katrorë të Bashkësisë Islame ishte keqpërdorur dhe dhunuar, ndërsa pjesa tjetër ndarë dhe degraduar, e si rrjedhojë, pavarësisht ekzistencës së marrëveshjeve të ndryshme me shtetin, procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave të komuniteteve fetare ka hasur mjaft vështirësi e pengesa.

Pronësia përbën një nga të drejtat më të vjetra, të lindura bashkë me njerëzimin, e cila konsiston në të drejtën e individit për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji civil dhe juridiksioni hyjnor. E drejta e pronësisë së komuniteteve fetare paraqet një ndër institutet juridike me të rëndësishme të të drejtave reale pronësore, në përgjithësi, dhe gjithashtu përbën formën kryesore të ushtrimit të të drejtave të njeriut mbi sendet, duke u kthyer në katalizatorin e të gjithë zhvillimit ekonomik të një vendi. *Neni 10/ paragrafi 6, i Kushtetutës së Shqipërisë, i datës 21.10.1998, ka sanksionuar se bashkësitë fetare janë persona juridik. Ata kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve. Ky është paragrafi kryesor i mbrojtjes juridike dhe kushtetuese të pronës dhe pasurive të Institucioneve religjioze në vendin tonë.*

Nëse prona, apo *ius proprietatis*, nuk është rregulluar juridikisht në mënyrën e duhur, do të kemi mungesën e një prej shtyllave kryesore të kapitalizmit dhe të ekonomisë së tregut. Rëndësia e kësaj të drejte shprehet me faktin se ajo rregullohet dhe mbrohet, jo vetëm në aspektin ligjor kombëtar, por edhe kushtetues e ndërkombëtar. Duhet të theksohet se e drejta e pronësisë mbi institucionet e vakëfit

dhe të bashkësive të tjera fetare është e lidhur me të drejtën zotëruese të ushtrimit e të gëzimit të saj me qëllim përhapjen e vlerave universale dhe ekomomike. Kjo gjë pasqyrohet në Statutet e Bashkësive fetare të 1923, 1925, 1927 dhe 1933 si dhe në Kushtetutën aktuale të vendit tonë.

Është evident fakti se me funksionimin e një ekonomie globale të tregut, pronësia, kryesisht ajo e paluajtshme, përbën bazën kryesore të zhvillimit të shoqërisë, në tërësi, si dhe të veprimtarive funksionale dhe vepruese të komuniteteve fetare, në veçanti (*kujtojmë Marrëveshjet mes Shtetit dhe Bashkësive fetare të shkurtit 2007 për të mirat materiale dhe pronësore të komuniteteve fetare tradicionale në Republikën e Shqipërisë*). Alarmi për kthimin fizik dhe kompensimin financiar të pronës, si një e drejtë *ius realis*, është dhënë ndër vite nga progres-raporti i Komisionit Evropian si dhe Raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit përgjatë viteve 1995-2005-2018.

Evolucioni i pronësisë së truallit fetar nuk kishte se si të mos reflektohej dhe në aktet kryesore ligjore shqiptare, duke ndryshuar nga një periudhë në tjetrën, ku secila karakterizohet nga veçori specifike në ushtrimin e saj. Në këtë punim do të evidentohen ndryshimet në kohë të konceptit të pronësisë në regjimet e ndryshme politike shqiptare, si dhe transformimin dhe abuzimin për dekada të tëra të pasurisë

truall, arë e lëndinë dhe vakumi i saj në jurisprudencën kushtetuese shqiptare në lidhje me këtë të drejtë zotëruese si dhe referuar nenit 9 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Pronësia, të drejtat reale të komuniteteve fetare dhe të drejtat që burojnë nga ajo lidhen ngushtësisht me realizimin e të drejtave themelore të njeriut dhe, si të tilla, duhet të analizohen në tërësinë e tyre, në mënyrë që secili prej nesh të ndërgjegjësohet dhe të njihet me to, si dhe me detyrimet që i burojnë nga e drejta e pronësisë e njohur me ligj.

1. Evoluimi i Konceptit të pronësisë.

Pronësia konsiderohet si e drejta e individit për të zotëruar një pronë apo send të caktuar brenda tagrave të përcaktuar nga e drejta. *“E drejta e pronësisë së individit apo e një kolektivi individësh si një e drejtë për të poseduar, gëzuar, disponuar pasurinë e tij, është një e drejtë universale dhe e pacenueshme, në kuptimin që çdo individ apo kolektiv individësh ka pushtetin absolut mbi pronën e tij”*¹. Çdokush ka të drejtë të fitojë dhe të ketë një pronë, sipas mënyrave të përcaktuar nga ligji. Në këtë kuadër është vetë individ i cili zgjedh “ta krijojë” apo mbajë atë personalisht, apo në formë “kolektive”, ose siç quhet ndryshme

në bashkëpronësi. E drejta e pronësisë e mbron individin nga çdo formë ndërhyrje, cenimi, përdorimi të padrejtë nga personat e tjerë.

E drejta e pronës nuk është një e drejtë e krijuar rishtazi, pasi siç e thamë ajo ka ekzistuar që në lashtësi, evolucioni i së cilës është trajtuar dhe mbrojtur në forma të ndryshme, në bazë të legjislacioneve të vendeve përkatëse. Referuar të drejtës së pronësisë në vendin tonë, ajo është njohur dhe parashikuar shprehimisht në aktin themelor të vendit, në Kushtetutë, e cila përbën garancinë kryesore për mbrojtjen e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kështu, neni 11/1 i saj sanksionon se *“sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private dhe publike...”*². Parashikimi i kësaj dispozite bën ndarjen e pronës në dy grupe të mëdha si: prona private, e zotëruar nga individ apo grup individësh, në varësi kjo të mënyrës së krijimit të pronësisë, si dhe pronë publike në zotërim të shtetit, i cili e ushtron këtë të drejtë nëpërmjet organeve të tij, si dhe enteve të tjera publike, në të mirë të interesit të përgjithshëm. Situata e pronave të klerit mysliman ka qenë më e goditur krahasuar me bashkësitë e tjera fetare, pasi koncepti i dhurimit apo i transferimit të pronësisë ka qenë më veprues te besimtarët e drejtimit mysliman

1. E drejta e pronësisë, e drejtë themelore e njeriut – Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, f. 33

2. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998.

me konceptin e bamirësisë dhe të shpërblimit në botën e amshueshme.

Ndërsa Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë na jep një kuptim më të gjerë dhe konkret të pronës. Konkretisht, në nenin 149 të tij përcaktohet se: “*Pronësia është e drejta për të disponuar dhe gëzuar lirisht sendet brenda kufijve të përcaktuar në ligj*”³. Edhe pse kjo e drejtë garantohet si nga Kushtetuta dhe Kodi Civil, nuk do të thotë se ajo është absolute dhe ka gjetur zbatim të drejtpërdrejtë apo dhe tërthorazi. Nga njëra anë shteti kujdeset për garantimin e saj, por nga ana tjetër kontrollon ushtrimin e kësaj të drejte gjithmonë në bazë të ligjeve në fuqi, me qëllim shmangien e abuzimeve të individëve. Nuk duhet harruar procesi i shtetëzimit dhe konfiskimit të pronave të komuniteteve fetare në Shqipëri pas vitit 1967 dhe censura e besimit fetar.

2. Vështrim historik mbi pronën e Institucioneve fetare në Shqipëri deri në ditët e sotme.

Pronësia përgjatë sistemit komunist 1944-1991.

Prona e klerit fetar, ka njohur koncepte e trajtime të ndryshme në periudha të ndryshme historike të vendit tonë dhe, për nga rëndësia, do ta fillojmë analizën me periudhën më të gjatë, atë të regjimit politik komunist, për vetë trajtimin specifik që i është bërë së drejtës së pronës gjatë kësaj periudhe, si dhe eliminimit faktik të ekonomisë së lirë. Në vitin 1944

Shqipëria hyri në rrugën e zhvillimeve dhe transformimeve rrënjësore me karakter komunist. “*Në etapën e parë të kalimit nga kapitalizmi në socializëm, krhas pronës socialiste ekzistonte dhe prona private*”⁴. Kjo gjë faktohej edhe në nenin 11, paragrafi 1 i Kushtetutës së vitit 1946, e cila konsiderohet si akti i parë bazë që rregullonte marrëdhëniet e pronësisë. Në të shpalleshin parimet e reja të rregullimit të tyre, ku shprehimisht thuhej se: “Sistemi ekonomik i Republikës Popullore të Shqipërisë bazohej në: pasurinë e përbashkët të popullit; pasurinë e organizatave kooperativiste popullore dhe në pasurinë e personave fizik”⁵.

Ajo çfarë është evidente në këtë trajtim, është fakti se akoma nuk e kemi të evidentuar haptazi përjashtimin nga qarkullimi civil të pronës private mbi pasuritë e institucioneve fetare, por kemi një bashkekzistencë të saj me pronën publike, ndonëse vetëm formalisht. Ndërsa kalojmë në paragrafin 2, të po këtij neni, ku cilësohej se: “*pronësia private mund të kufizohet e shpronësohet kur e lyp interesi i përgjithshëm në bazë të një ligji*”⁶. De-jure pronësia cilësohej si një nga të drejtat e individit, por de-facto gëzonte një mbrojtje të dobët dhe prirje për t’u kufizuar nga ana e organeve shtetërore. Një gjë e tillë ligjërohet në një tjetër dispozitë. Pikërisht neni 12, ku përveç të tjerash, thuhet se: “*toka u përket atyre që e punojnë dhe me ligj*

3. Ligji nr. 7850 datë 29.7.1994, i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

4. Dhima. Dh, “ E drejta kushtetuese e Republikës Popullore të Shqipërisë”, Tiranë, f. 117

5. Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1946.

6. Po aty.

caktobet maksimumi i tokës që mund të jetë tokë private". Në këtë rast është vetë shteti i cili vendos se sa pronësi do të posedojë një person, duke afirmuar në këtë mënyrë ndërhyrjen e tij mbi kufizimin e pronësisë⁷. Sa më shumë të shtetëzohej prona, aq më i fuqishëm bëhej ai dhe nga ana tjetër aq më i dobët dukej individi përballë tij.

Përgjatë viteve të diktaturës vërehej bashkekzistenca e regjimit me tipare kapitalizmi dhe socializmi, ku ky i fundit do të triumfonte në vitin 1976 me miratimin e Kushtetutës së re, në të cilën sanksionohej zhdukja e pronës private, konkretisht në nenin 16 të saj⁸. Me këtë kushtetutë u eliminua tërësisht domeni i pronës dhe i të drejtave reale të lidhura me të, e individi u zhvesh nga çdo e drejtë mbi pronën, pasi kështu i nevojitej "interesit të përgjithshëm" politik të vendit, duke cenuar, në këtë mënyrë, drejtpërdrejt ushtrimin e të drejtës së lirë të pronës private të individit.

Sipas Kushtetutës pronësia ndahej në "pronë socialiste, e cila përbëhet nga prona shtetërore dhe nga prona kooperativiste në bujqësi"⁹. Këto dy lloj formash të pronësisë janë të tilla në mënyrë që të përjashtojnë çdo mundësi të

përqendrimit të pasurisë shoqërore e të klerit në duart e individëve të veçantë dhe si pasojë bëjnë të mundur zhdukjen e shfrytëzimit të individit nga individi"¹⁰.

Sipas këtij idealizimi prona i përkiste të gjithëve, por askush nuk kishte të drejtë ta gëzonte atë individualisht. Modeli shqiptar karakterizohej nga eliminimi i të gjitha formave të pronës private nëpërmjet shtetëzimit të plotë të industrisë, tregtisë, në shumicë dhe pakicë, si dhe të kolektivizimit ekstrem të bujqësisë nga mbështetja e plotë në planifikim të centralizuar, sipas parimit të mbështetjes tërësisht në forcat e veta¹¹. Prandaj, kur flasim për aspektin ekonomik themi se transformimi ka hasur probleme, vështirësi, pasoja negative dhe një periudhë kohore të konsiderueshme, kohë e cila u nevojiti për decentralizimin dhe kthimin e saj në një ekonomi të lirë të tregut.

Pronësia pas vitit 1991.

Përmbysja e sistemeve politike, ekonomike dhe shoqërore, që ndodhi në Evropën Qendrore dhe Juglindore, përfshiu, gjithashtu, në mënyrë të pashmangshme edhe shtetin tonë në vitet '90. Bilanci i humbjes pasurore dhe pronësore ishte tepër i madh, ku rreth 1

7. E drejta e pronësisë, e drejtë themelore e njeriut – Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, f. 7.

8. Madhi. E, "Mbrotjtja e pronësisë dhe jurisprudenca", f. 45.

9. Grup autorësh, "E drejta kushtetuese", f. 116.

10. Dhima. Dh, "E drejta kushtetuese e Republikës Popullore të Shqipërisë", f. 19.

11. Prof. Dr. Anastas Angjeli, "Tranzicioni dhe liria ekonomike në Shqipëri", f. 30.

milion metra katrorë të Bashkësisë islame ishte keqpërdorur dhe dhunuar, ndërsa pjesa tjetër ndarë dhe degraduar. Vendi ynë, u ndikua nga ndryshimet politike që ndodhën në vendet e tjera ish-komuniste, duke pësuar ndryshime rrënjësore në qeverisje edhe, gjithashtu, për sa i përket konceptit e ushtrimit të pronësisë. Rruga e vështirë e Shqipërisë nga diktatura në demokraci, nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e lirë të tregut, është historia e një vendi, që tranzicionin e filloi nga një izolim ekstrem, nga një varfëri e madhe dhe pa asnjë lloj infrastrukture¹². Për të transformuar sistemin ekonomik ekzistues në një ekonomi të tregut të lirë janë miratuar një sërë ligjesh dhe VKM-sh, të cilat, në tërësinë e tyre, formuan atë që do të konsiderohet si jurisprudencë kushtetuese në kuadër të trajtimit të së drejtës së pronësisë dhe që shërbeu për vite me radhë për përmirësimin dhe mbrojtjen e kësaj të drejte. Ndër aktet më të rëndësishme mund të përmendim: Ligjin nr. 7501 datë 19/07/91 “Për Tokën”; Ligjin nr. 7652 datë 12/02/93 “Privatizimi i shtëpive”; Ligjin nr. 7698 datë 15/04/93 “Kthimi i pronës”; VKM nr. 190 datë 16/04/90 “Krijimi i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit”; VKM nr. 19 datë 16/04/93 “Rifillimi i procesit të privatizimit”; VKM nr.

12. Eduart, Kaca, “Shqipëria nga diktatura në demokraci (Teori dhe praktikë)”, f. 9.

386 datë 26/07/93 “Dhënia me qira e pronës shtetërore”; etj.

Pragu i viteve ‘90 shënon nisjen e reformave që lidhen me liberalizimin e tregtisë së lirë dhe sipërmarrjeve të lira ekonomike, ndër të cilat evidentoheshin të drejtat e lidhura me pronësinë. Hapi fillestar ishte miratimi i *Ligjit Kushtetues* më 29.04.1991, i cili sanksiononte të drejtën e pronës, në ndryshim nga Kushtetuta e 28 dhjetorit 1976, e cila e eliminonte atë. “Bujqësia ishte sektori i parë për t’u privatizuar, kryesisht përmes çmontimit të kooperativave bujqësore”¹³.

Ndërsa ligji Nr. 7512, Dt. 10.08.1991, në nenin 1 të tij, thuhet se: “Në Republikën e Shqipërisë sanksionohen dhe mbrohen prona private, nisma e lirë, veprimtaritë private të pavarura, afarizmi, investimet e huaja, e drejta për të marrë e për të dhënë kredi, e drejta për të punësuar e për t’u punësuar, privatizimi i pronës shtetërore dhe i gjithë procesi i kalimit të ekonomisë së Republikës të Shqipërisë nga një ekonomi e planifikuar dhe e kontrolluar nga shteti, në një ekonomi të tregut të lirë.” Në këtë prizëm, “Shqipëria filloi procesin e saj të privatizimit në masë të vogël”¹⁴ pikërisht me këtë ligj.

13. Vaughan-Whitehead, Daniel, “Albania in crisis: the predictable fall of the shining star”, f. 152.

14. Vaughan-Whitehead, Daniel, “Albania in crisis: the predictable fall of the shining star”, f. 154.

Regjimi aktual i pronës.

Me pronësi të autoriteteve fetare, në pikëpamjen juridike, do të kuptojmë marrëdhënien e zotërimit të sendeve, së cilës i referohen një sërë të drejtash reale. Në nenin 11 të Kushtetutës së Shqipërisë¹⁵ sanksionohen parimet kryesore të një shteti, i cili bazën e ka në iniciativën e lirë të ekonomisë së tregut¹⁶. Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të individit ka prioritet në shtetin demokratik. Shteti i së drejtës, kuadri ligjor në tërësi, dhe institucionet që ngrihen mbi këtë bazë kanë si synim dhe objektiv kryesor, pikërisht, garantimin dhe mbrojtjen sa më mirë dhe sa më efektive të të drejtave dhe lirive themelore të individit. Natyra e së drejtës së pronësisë është tepër komplekse, pasi në të përfshihen si prona private ashtu dhe ajo publike, të cilat mbrohen njëjloj me ligj¹⁷. Grupimi në këto dy kategori të mëdha evidenton dhe karakteristikat e secilës prej tyre, si dhe ndryshimet që ekzistojnë mes këtyre dy regjimeve. Tre janë tiparet bazë të pronës publike:

1. Është e pa tjetërsueshme; 2. E paparashkrueshme; dhe 3. Nuk

është objekt ekzekutimi.

Ndërsa sendet objekt i pronës publike përcaktohen nga tre kritere:

1. Shpallja si të tilla me aktet normative; 2. Nga natyra e tyre; dhe 3. Nga përdorimi i tyre.

Të gjitha sendet që përmbushin këto kushte dhe përfshihen në këtë kategori, përbëjnë objektin e pronës publike që i përket shtetit dhe njësive të qeverisjes vendore, përbëjnë përmbajtjen e pronës publike dhe arsyen e ekzistencës së saj.

3. Marrëveshjet ndërmjet Qeverisë shqiptare dhe komuniteteve fetare

Kushtetuta parashikon se marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare rregullohen me marrëveshje të veçanta, të cilat marrin vlerën e ligjit duke qenë se ratifikohen nga Kuvendi i Shqipërisë. Marrëveshja e parë e lidhur në zbatim të nenit 10 të Kushtetutës ishte ajo “Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”. Kjo ishte marrëveshja e parë mes shtetit shqiptar dhe një komuniteti fetar që i hapi rrugën edhe marrëveshjeve të tjera analoge mes komuniteteve dhe shtetit shqiptar. Duhet theksuar se kjo marrëveshje bazohet dhe në nenin 121 të Kushtetutës, duke qenë se është lidhur ndërmjet shtetit shqiptar dhe një shteti, subjekt i së drejtës ndërkombëtare, siç është

15. Në kuptim të këtij punimi dhe të faktit se, për sa i përket kufizimit të lirive dhe të drejtave themelore, Kushtetuta barazohet në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

16. Neni 11 i ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar).

17. Po aty.

Selia e Shenjtë, pra trajtohet nga e drejta ndërkombëtare publike. Vlen të ndalemi këtu në vendin e rëndësishëm që zënë marrëveshjet ndërkombëtare në sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë sipas Kushtetutës shqiptare. Në bazë të nenit 5 të Kushtetutës, Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të. Pjesa VII e Kushtetutës i kushtohet në mënyrë të posaçme marrëveshjeve ndërkombëtare. Sipas nenit 116/1 “marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara renditen, nga pikëpamja hierarkike e normave, menjëherë pas Kushtetutës.

Rëndësia ndërkombëtare e Marrëveshjeve sipas parimit pacta sum servantia

Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetë-zbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Ndërkohë, neni 121 i Kushtetutës rendit marrëveshjet ndërkombëtare që i nënshtrohen detyrimisht ratifikimit dhe që kanë të bëjnë me: a) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake; b) të drejtat dhe liritë e njeriut, si edhe detyrimet

e shtetasve, siç parashikohen në Kushtetutë; c) anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare; ç) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë; d) miratimin, ndryshimin, plotësimin ose shfuqizimin e ligjeve, ratifikuar me Ligjin nr. 8902, datë, 23.5.2002. Neni 122 i Kushtetutës mbi të Drejtat e Pronësisë së Komuniteteve Fetare në Shqipëri. Sa më sipër, duke qenë se marrëveshja me Selinë e Shenjtë ka të bëjë me të drejtat dhe liritë e njeriut dhe ka efekte financiare për shtetin shqiptar, ajo i është nënshtruar ratifikimit nga Kuvendi. Në bazë të kësaj marrëveshjeje shteti shqiptar njeh personalitetin juridik të Kishës Katolike. Ai merr përsipër të kthejë pronat e Kishës Katolike, në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe të asistojë në ri-regjistrimin e tyre në emër të Kishës Katolike në zyrat kompetente shtetërore. Prej kësaj marrëveshjeje lind detyrimi ligjor i shtetit shqiptar që t'i rikthejë pa asnjë kushtëzim të gjitha pronat e kishës katolike të shtetëzuara gjatë periudhës së sistemit komunist dhe t'i garantojë komunitetit katolik të gjitha të drejtat pasurore në lidhje me këto prona. Në vijim të kësaj marrëveshjeje, Kuvendi i Shqipërisë miratoi në vitin 2005 Ligjin “Për procedurat e njohjes së zotësisë juridike të personave juridikë kishtarë të kishës katolike”. Në bazë të marrëveshjes “personat

juridikë kishtarë gëzojnë të gjitha të drejtat dhe përmbushin detyrimet e parashikuara në dispozitat e Kodit Civil dhe në aktet e tjera ligjore në fuqi për të gjithë personat juridikë”. Pra, ligji i garanton komunitetit katolik në Shqipëri gëzimin e të gjitha të drejtave në fushën e pronësisë njësoj si personat e tjerë fizikë e juridikë. Në vijim, shteti shqiptar lidhi në vitin 2009 marrëveshje për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella me tre komunitete të tjera: Komunitetin Mysliman të Shqipërisë (KMSH), nenet 76, Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë (KOASH), neni 77, dhe Kryegjyshatën Botërore Bektashiane (KBB), neni 78, e më pas në vitin 2011 u lidh marrëveshja me Vëllazërinë Ungjillore të Shqipërisë, nenet 79. Neni 8 i Marrëveshjes. Ligji Nr. 9365, datë 31.3.2005. Neni 4 i Ligjit. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë “për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, ratifikuar me Ligjin nr. 10 056, datë 22.1.2009. Në nenin 77 marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë “për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, ratifikuar me Ligjin nr. 10 057, datë 22.1.2009. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshatës Botërore Bektashiane

Shqipërisë “për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, ratifikuar me Ligjin nr. 10 058, datë 22.01.2009. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Fetar “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”. Këto marrëveshje u bazuan në nenin 10 dhe 24 të Kushtetutës dhe morën fuqinë e ligjit pas ratifikimit nga Kuvendi i Shqipërisë.

Rëndësia kombëtare e Marrëveshjeve, sipas parimit ius loci

Qëllimet kryesore të këtyre marrëveshjeve janë: • garantimi i realizimit të të drejtave të sanksionuara nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë; • njohja dhe garantimi i respektimit të të drejtave të komuniteteve fetare, lidhur me të drejtat dhe detyrimet e besimtarëve, respektimin e riteve dhe praktikave tradicionale, të institucioneve dhe strukturave të tij, si dhe personave juridikë të themeluar prej tij, për të zhvilluar lirisht misionin e tyre fetar, edukativ e bamirës; • njohja dhe garantimi i paprekshmërisë së institucioneve fetare për aq sa veprimtaria e tyre nuk vjen në kundërshtim me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, me kushtetutën e ligjet në fuqi; • garantimi i lirisë së individit

për të ushtruar besimin fetar, për ta shfaqur atë individualisht ose kolektivisht në institucionet fetare ose jashtë tyre, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve përkatëse fetare; • sigurimi i lirisë së individit për të mos u ndaluar dhe as detyruar të bëjë pjesë në komunitetin fetar, • njohja e personalitetit juridik të tyre, etj. Këto marrëveshje sanksionojnë të drejtën e pronësisë së komuniteteve fetare ndërkohë që tre marrëveshjet e para vendosin shtetin para detyrimit për kthimin e kompensimin e pronave të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në të gjitha marrëveshjet përcaktohet se në rastet kur objektet e kultit të komuniteteve fetare nuk gjenden të regjistruara në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (sot Agjencia e Trajtimit të Pronës), si institucion përgjegjës për verifikimin, kthimin dhe kompensimin e pronave, merr përsipër detyrimin për ta vërtetuar pronësinë mbi objektin e kultit nëpërmjet dokumenteve të Arkivit Qendror të Shtetit. Në këto marrëveshje parashikohet, gjithashtu, që objektet e kultit, të cilat gëzojnë statusin e Monumentit të Kulturës, t'i kthehen në pronësi komuniteteve fetare dhe të mbrohen e trajtohen nga ligji për trashëgiminë kulturore. Neni 22 i marrëveshjeve të Qeverisë

me komunitetet fetare mbi të Drejtat e Pronësisë së Komuniteteve Fetare në Shqipëri. Është interesant fakti që marrëveshjet e lidhura me KOASH dhe me KBB parashikojnë kompensimin e të gjitha pronave, ndërsa marrëveshja me KMSH nuk është shumë e qartë mbi këtë çështje. Nga ana tjetër, marrëveshja me KMSH ka disa elementë që nuk janë parashikuar në dy marrëveshjet e tjera, si më poshtë: • Trajtimi me përparësi i kërkesave të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronave vakëf; • Kthimi i pronave “me të gjithë përbërësit e tyre”, dhe • Rinjohjen e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë si “trashëgimtar të pasurisë së tij”. Në zbatim të marrëveshjeve të lartpërmendura Këshilli i Ministrave ka miratuar disa vendime në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronave për të katër komunitetet fetare. Pavarësisht ekzistencës së këtyre marrëveshjeve, procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave të komuniteteve fetare ka hasur mjaft vështirësi edhe se zyra e Këshillit të Evropës në Shqipëri, dhe OSBE-ja ka monitoruar në vazhdimësi këtë proces, nuk mund të themi se e drejta e pronësisë së bashkësive fetare është zbatuar sipas parimit “strictum sensu”, nga ana e autoriteteve shtetërore dhe sistemi gjyqësor në Shqipëri.

Bibliografi

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Shtypshkronja Express, Tiranë, 2008.
- Kodi Civil 1994, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8902, datë 23.5.2002 për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.
- Dhima. Dh, “E drejta kushtetuese e Republikës Popullore të Shqipërisë”, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1963.
- Grup autorësh, “E drejta kushtetuese”, Shtypshkronja e Dispensave, 1981.
- Hana, L. & Telo, I., “Tranzicioni në Shqipëri, Arritje dhe Sfidë”, Mësonjëtorja, Tiranë, 2005.
- Koca. E, “Shqipëria nga diktatura në demokraci” (teori & praktikë), Tiranë, 2004.
- L. Omari & A. Anastasi, “E drejtë kushtetuese”, Shtëpia botuese ABC, Tiranë, 2008.
- Madhi. E, “Mbrojtja e pronësisë dhe jurisprudenca”, Shtëpia botuese Triptik, Tiranë, 2008.
- Ligji nr. 7501 Dt. 12.07.1991 “Për Tokën”.
- Ligji nr. 7512 Dt. 10.08.1991 “Për Sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarisë private të pavarura dhe privatizimet.
- Ligji nr. 7698 Dt. 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”.
- Ligji nr. 8561 Dt. 21.12.1999 “Për shpenzimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së pronës private”.
- Ligji nr. 9583 Dt. 17.07.2006 “Për disa ndryshime në Ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronave”.
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 27.08.1993.
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 31.07.1995.
- Marrëveshjet ndërfaqetare Qeveri & Komunitetet fetare, shkurt 2007.
18. Prof. Dr. Sabri Kadriu, Financat Publike, 2016.

Jeta e Ebu Mansur El-Maturidiut dhe konteksti socio-politik dhe teologjik në Azinë Qendrore në shekullin X -II-

Aref Chaker

Abstrakt

Ebu Mansur El-Maturidiu është një nga teologët më me influencë në botën islame. Ai u shfaq në shekullin e dhjetë në Azinë Qendrore dhe themeloi shkollën e tij teologjike, el-Maturidijje; një shkollë që luajti dhe vazhdon të luajë një rol qendror në formimin e lëvizjes teologjike sintetike sunite në botën myslimane. Duke parë studimet e deritanishme që janë marr me Maturidiun ato nuk e kanë shqyrtuar dhe analizuar ndikimin e kontekstit socio-politik dhe teologjik të Azinë Qendrore mbi Maturidiun. Ky punim fokusohet në studimin e këtij aspekti të anashkaluar në teologjinë sunite. Ai vlerëson ekzistencën e çdo ndikimi të faktorëve socialë, politikë, kulturorë dhe fetarë në veprat e Maturidiut dhe identitetin e tij akademik. Ai shqyrton natyrën e këtyre ndikimeve, pozitive apo negative, duke ndërmarrë një analizë cilësore të përmbajtjes së të gjithë literaturës biografike, historike dhe gjeografike të rëndësishme për Maturidiun dhe Azinë Qendrore. Studimi zbuloi ndikimin e fortë që këta faktorë kishin tek ai. Këto ndikime ishin të gjitha pozitive në shumë prej shkrimeve të tij. Më e rëndësishmja, këta faktorë ndihmuan në formësimin e paradigmes teologjike sintetike që Maturidiun adaptoi në pjesën më të madhe të punimeve të tij.

Kontakti i parë mysliman me rajonin filloi në vitin 675 të erës sonë, me një traktat paqeje që gjenerali mysliman Said Ibn ‘Uthman Ibn ‘Affan¹ nënshkroi

me qeverinë lokale. Në vitin 681 të erës sonë dhe pas betejave të ashpra, Salim Ibn Zijad, një gjeneral mysliman, mundi të hynte në rajon,

Zirkili, *El-Alam Kamus Teraxhim*, 4th ed., 8 vëll. (Beirut: Dar el-‘Ilm li el-Melajijn, 2002).

1. Ibn Kethir, *El-Bidaje ue en-Nibaje*, K. Ez-

pavarësisht rezistencës së fortë nga populli indigjen.² Rajoni mbeti nën sundimin e dinastisë Umejade derisa u përmbys nga dinastia ‘Abbaside në vitin 750 të e.s. Që atëherë, ai ishte nën qeverisjen qendrore të khalifatit ‘abasid në Bagdad deri në vitin 819 të e.s.³ Në këtë vit, khalifi El-Me’mun⁴ (q. 813-833 e.s.), një khalif ‘abasid, decentralizoi rajonin dhe dha mbretërimin e tij bijve të Asad Ibn Samanit, i cili vinte nga një familje sunduese fisnike perse nga qyteti i Belkhut dhe ishte pasardhës i Bihram Xhubinit.⁵ Ishin katër vëllezër dhe khalifi i dha secilit prej tyre një pjesë të caktuar të rajonit. Ai ia dha Semerkandin Nuhut, Farganahun Ahmedit, Tashkandin Jahjas dhe Harahun Isma’ilit.⁶ Kjo

shënoi fillimin e qeverive rajonale autonome për këto shtete deri në vitin 874 të erës sonë, kur ata shpallën pavarësinë e tyre të plotë dhe formuan shtetin e dinastisë Samanide.⁷

Ky ishte një moment historik i rëndësishëm pasi pavarësia e samanidëve pati një ndikim të madh në rajon dhe zhvillimin e tij akademik.

A i dha pavarësia e re stabilitet politik rajonit që u bë i famshëm për përlëshjet dhe kryengritjet e vazhdueshme? El-Kerkhi paraqet një rrëfim të mbretërimit të mbretërve samanidë dhe i përshkruan ata si “...më të mirët e sundimtarëve persianë”.⁸ Kjo është e dukshme edhe në dëshminë e Ibn Khalikan (v. 1373 e.s.), një historian dhe studiues i famshëm mysliman, i cili portretizon statusin e mbretërve samanidë. Ai thekson, “Mbretërit samanidë ishin sulltanët e ‘tokës përtej lumit’ dhe Khurasanit.”⁹ Ai thekson se “karakteristikat e tyre

2. H. Hassan, *Tarikhul Islam es-Sijasi ue ed-Dini ue el-Ixhtima’i ue eth-Thekafi*, 14th ed., 4 vëll. (Beirut: Dar el-Xhil 1996); Vambéry, *Tarikhul Bukhara Mundhu el-Kidem batta el-Asri el-Hadir*.

3. M. Rifa’i, *El-Khilafa el-‘Abbasijeh ue l-Harekatu el-Istiklalijeh fi el-Meshrik* (Amman: Dar eth-Thekafa li en-Neshr ue et-Tiba’ah ue et-Teuzi’, 1997); Narkhashi, *Tarikh Bukhara*.

4. Dhehebi, *Sijer A’alam en-Nubela’*; M. Taberi, *Tarikh err-Rusul uel-Muluk*, 2nd ed., 11 vëll. (Cairo: Dar el-Me’arif, 1967).

5. I. Kerkhi, *El-Mesalik ue el-Memalik* (Leiden: Brill, 1870), http://upload.wikimedia.org/wikisource/ar/5/54/%D9%85%D8%B3%D8%A7%D9%84%D9%83_%D8%A7%D9%84%D9%85%D9%85%D8%A7%D9%84%D9%83.pdf; M. Ibn Haukal, *Surat el-Erd* (Beirut: Mektebet el-Hajeh, 1992).

6. A. Emin, *Dhahere el-Islam* (Cairo: Hindavi

Foundation for Education and Culture, 2013); M. Rifa’i, *El-Khilafa el-‘Abbasijeh ue l-Harekatu el-Istiklalijeh fi el-Meshrik*.

7. M. Beshari, *Ahsen et-Tekasim fi Ma’rifet el-Ekalim*, 3rd ed. (Cairo: Mektebet Madbuli, 1991); Ibn El-Ethir, *El-Kamil fi et-Tarikh*, 8; Narkhashi, *Tarikh Bukhara*; Rifa’i, *El-Khilafa el-‘Abbasijeh ue l-Harekatu el-Istiklalijeh fi el-Meshrik*; Hassan, *Tarikhul Islam es-Sijasi ue ed-Dini ue el-Ixhtima’i ue eth-Thekafi*.

8. Kerkhi, *El-Mesalik ue l-Memalik*.

9. A. Ibn Khalikan, *Ufejat el-A’jan ue Enba’ Ebnai ez-Zaman*, vëll. 4 (Beirut: Dar Sedir, 1968), 245.

mbizotëruese ishin drejtësia, feja dhe dituria.”¹⁰ Ibn El-Ethir (v. 1233 e.s.) pajtohet me Ibn Khalikan dhe shtjellon se shumë nga mbretërit e tyre, si Ahmed Ibn Asad (v. 860 e.s.), ishin “të dashur nga njerëzit”¹¹ për sundimin dhe administrimin e tyre. Kështu, nën qeverisjen e samanidëve, rajoni gëzonte stabilitet dhe siguri, dhe të gjitha grushtet e komplotet politike kundër mbretërve samanidë u ndërprejnë me shpejtësi. Disa historianë myslimanë, si Bashari (v. 990 e.s.), besojnë se ky ishte rezultat i urtësisë hyjnore për udhëheqjen e samanidëve për shkak të drejtësisë dhe devotshmërisë së tyre.¹²

Nuk mund të mbivlerësohet rëndësia e stabilitetit dhe harmonisë politike për përparimin e dijes. Është thelbësore për përparimin dhe shkëlqimin akademik pasi krijon një mjedis paqeje, në të cilin mund të ndërtohet një qytetërim dhe dijetarët mund të punojnë dhe të përparojnë, duke shijuar patronazhin e mësimi islam.

Një karakteristikë tjetër e rëndësishme e mbretërimit të samanidëve, për sa i përket këtij studimi, është devotshmëria fetare. Ibn El-Ethir thekson se dinastia e tyre nuk dallohej vetëm nga qeverisja e shkëlqyer politike, por

po aq e njohur për devotshmërinë dhe drejtësinë e tyre. Ai thotë, “Nasr Ibn Ahmed, mbreti samanid, gjatë sëmundjes së tij të vdekjes, ndërtoi një kasolle të vogël përpara pallatit të tij dhe e quajti atë ‘shtëpia e adhurimit’ ku ai falej, lutej dhe përgjërohej.”¹³ Sipas Ibn Ethir, në ditët e fundit të këtij mbreti, ai vishte rrobën e pendimit.¹⁴ Devotshmëria e mbretërve samanidë pati një ndikim pozitiv në qeverisjen e tyre dhe bëri që ata të refuzonin korrupsionin dhe ryshfetet dhe të promovonin drejtësinë dhe fenë. Kjo forcoi marrëdhëniet e tyre me njerëzit dhe stabilitetin politik të mbretërisë së tyre, dhe bëri që ata të nderonin dijetarët myslimanë dhe të vlerësonin njohuritë islame që përfaqësonin. Kjo bëri që shteti të financonte dhe promovonte lëvizjet akademike dhe fetare në rajon, një praktikë e njohur gjerësisht në botën myslimane.¹⁵

13. Ibn El-Ethir, *El-Kamil fi et-Tarikh*, 8.

14. Kjo mund të nënkuptojë se ai, fizikisht, për të veshur, përdorte rroba modeste ose ai u sigurua që të ishte gjithmonë në një gjendje pendimi përmes veprimeve dhe lutjeve të tij.

15. Shembulli më i afërt i kësaj praktike të zakonshme është miratimi i khalifatit ‘abasid të shkollës mu’tezilite para dhe gjatë jetës së Maturidiut. Për më tepër shih, Rifa’i, *El-Khilafa el-‘Abbasijeh ue l-Harekatu el-Istiklalijeh fi el-Meshrike*; M. Khudari, *Tarikhu el-Umem el-Islamijeh*, 2nd ed., 2 vëll. (Cairo: El-Mektebeh et-Tixharijeh, 1936); Sujuti, *Tarikhu el-Khulafa’*; Uekil, *El-Asr edb-Dhebebi li ed-Deule el-‘Abasijeh*.

10. Po aty.

11. Ibn El-Ethir, *El-Kamil fi et-Tarikh*, 8, vëll. 7, 279-80.

12. Beshari, *Ahsen et-Tekasim fi Ma’rifet el-Ekalim*.

Rezultati më i vogël nga devotshmëria e mbretërve samanidë ishte toleranca ndaj studiuesve dhe lejueshmëria e lirisë për studime dhe kërkime fetare, të cilat do të kishin një ndikim të drejtpërdrejtë në mjedisin akademik, shkrimet dhe ambiciet e Maturidiut.

Stabiliteti politik është çelësi i suksesit për çdo komb, duke përfshirë sektorët ekonomikë dhe akademikë, veçanërisht në një vend që kishte fituar së fundi pavarësinë.¹⁶ Stabiliteti politik që vendosën mbretërit samanidë u mundësoi atyre të garantonin sigurinë e tregtarëve dhe të gjithë karvanëve që kalonin përmes tokës së tyre në udhëtimin për në Bagdad, kryeqyteti i Khalifatit. Ata u bënë të njohur si mbrojtësit e Rrugës së Mëndafshit dhe mëndafshit kinez në tregjet e Bagdadit.¹⁷ Si rrjedhim, Metz dhe El-Hameui (v. 1229 e.r.), një kronist

16. Për më shumë të dhëna rreth rëndësisë së stabilitetit politik, ekonomik dhe sektorit akademik shih, A. Alesina, S. Özler, N. Roubini, and P. Swagel, "Political Instability and Economic Growth," *Journal of Economic Growth* 1, no. 2 (1996); Ari Aisen dhe Francisco Jose Veiga, "How does Political Instability Affect Economic Growth?", International Monetary Fund, <https://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2011/wp1112.pdf>; Adam E. Nir dhe Bhojraj S. Kafle, "The Effect of Political Stability on Public Education Quality," *International Journal of Educational Management* 27, no. 2 (2013).

17. A. Metz, *Islamic Civilization in the Fourth Century of the Hegira*, prkth. M. Ebu Rajda, 5th ed., 2 vëll. (Beirut: Dar el-Kitab el-'Arabi, 1947).

mysliman, treguan se në vitin 941 të e.s. perandori kinez i propozoi vajzën e tij në martesë me djalin e Nasr Ibn Ahmed, mbretit samanid. Ky i fundit e pranoi propozimin dhe kjo martesë u hapi tregtarëve myslimanë një kalim të sigurt në tregjet kineze dhe një furnizim të pakufizuar mëndafshi kinez, një mall me kërkesë të lartë në Bagdad dhe botën myslimane.¹⁸ Kjo e përmirësoi më tej gjendjen ekonomike të rajonit. dhe ndryshoi perspektivën rreth tij nga një rajon i thjeshtë rural në një rrugë jetike për tregti dhe import.

Ky bum ekonomik forcoi stabilitetin dhe autonominë e qeverisë samanide dhe e fuqizoi atë të prodhonte monedhën e saj dhe të gëzonte marrëdhënie të forta politike me shtetet fqinje, siç tregohet nga martesja e djalit të Nasr Ibn Ahmed me vajzën e perandorit.¹⁹ Prosperiteti i dinastisë Samanide vazhdoi derisa

18. J. Hameui, *Mu'xbem el-Buldan*, 1st ed., 5 vëll. (Beirut: Dar Sedir, 1977); Metz, *Islamic Civilization in the Fourth Century of the Hegira*; I. El-Fiki, *Ed-Duelu el-Islamijeh el-Mustekil-leh fi esh-Sherk* (Cairo: Dar el-Fikr el-'Arabi, 1987).

19. Punimet arkeologjike në Evropën veriore zbuluan shumë monedha që erdhën nga bota islame gjatë shekullit të dhjetë gregorian, shekullit të katërt hixhri; dy të tretat e monedhave të zbuluara i përkisnin dinastisë Samanide në Azinë Qendrore. Metz, *Islamic Civilization in the Fourth Century of the Hegira*; El-Fiki, *Ed-Duelu el-Islamijeh el-Mustekil-leh fi esh-Sherk*; Rifa'i, *El-Khilafa el-'Abbasijeh ue l-Hareketu el-Istiklalijeh fi el-Meshrik*.

u rrëzua nga Sebuktigin, themeluesi i dinastisë Ghaznevid në vitin 998 të e.s.²⁰

Prosperiteti ekonomik i rajonit përforcoi mjedisin pjellor që kishte krijuar stabiliteti politik për zhvillimin akademik. Prosperiteti ekonomik ngriti standardet e jetesës në shoqëri dhe i lejoi qytetarët e saj të eksplorojnë interesa dhe objektiva të tjera në jetë, përfshirë arsimin akademik. Lidhja e këtyre faktorëve me devotshmërinë dhe fenë e dinastisë samanide do të kishte inkurajuar studimet fetare dhe do të kishte siguruar të gjitha mjetet e nevojshme për të krijuar një akademi të shquar islame që e bëri Azinë Qendrore një qendër të të mësuarit dhe zhvillimit në disiplinat islame.

Gjendja intelektuale, shkencore dhe kulturore në Azinë Qendrore të shekullit X

A ngjalli pavarësia e mbretërve samanidë në interesimin e tyre për ta manifestuar këtë pavarësi në nivele kulturore, fetare dhe akademike (Pavarësia e mbretërve samanidë në interesimin e tyre për ta manifestuar këtë pavarësi në nivele kulturore, fetare dhe akademike, a ngjalli ndonjë

interes të veçantë)? A i frymëzoi ata të provonin dallimin e tyre nga khalifati 'abasid në të gjitha fushat dhe të ndërtonin trashëgiminë e tyre si sulltanë të tokave përtej lumit?

Është e vështirë të shqyrtohen synimet e mbretërve samanidë, por analiza e politikave të tyre konfirmon se ata kishin interesa të qëllimshme për ta kthyer rajonin e tyre në një kryeqytet të dijes. Stabiliteti politik dhe bumi ekonomik që arritën, u hapi rrugën atyre për të ndjekur objektivat e tyre. Gjatë mbretërimit të tyre, veçanërisht në shekullin e nëntë dhe të dhjetë, periudha në të cilën jetoi Maturidiu, jeta intelektuale lulëzoi shumë në Semerkand, në disiplina laike, kulturore dhe fetare. Një nga politikat që ushtroi Dinastia Samanide ishte sponsorizimi i shumë intelektualëve, filozofëve, poetëve dhe shkrimtarëve të letërsisë. Historianët, udhëtarët dhe filozofët që gëzonin personalisht bujarinë monetare dhe intelektuale të këtyre mbretërve e dokumentuan këtë praktikë në veprat e tyre. Ibn Ebi 'Usajb'eh (v. 1269 e.s.), një mjek dhe kronist mysliman, regjistroi në librin e tij, *'Ujunu l-Enba' fi Tabakati el-etibba'* (Lajmi i vërtetë rreth klasave dhe brezave të mjekëve), dëshmi e mjekut dhe filozofit të shquar mysliman Ibn Sina (v. 1037 e.s.) për bujarinë dhe mikpritjen me të cilën e përfshiu mbreti samanid Nuh Ibn Mansur. Ibn Sina përshkruan se si atij iu dha akses i plotë në bibliotekën

20. El-Ethir, *El-Kamil fi et-Tarikh*, 8; A. The'alibi, *Jetijmetu ed-Debr fi Mehasin el-'Asr*, 1st ed., 5 vëll. (Beirut: Dar el-Kutub el-Ilmijeh, 1983); Khudari, *Tarikh el-Umem el-Islamijeh*; El-Fiki, *Ed-Duel el-Islamijeh el-Mustekil-leh fij esb-Sherk*; Narkhashi, *Tarikh Bukhara*; Vambery, *Tarikh Bukhara Mundhu el-Kidem Hatta el-'Asri el-Hadir*.

mbretërore në pallatin samanid. Ai e përshkruan bibliotekën si një pallat më vete, me shtëpi të ndryshme dhe çdo shtëpi të dedikuar për një shkencë specifike. Ai vëren: “Dhe unë kam parë në të libra për të cilët shumë njerëz nuk kanë dëgjuar dhe unë vetë nuk i kam parë kurrë më parë dhe nuk i kam parë të tilla as më pas...”²¹ Përveç kësaj, mbretërit samanidë ofronin poste ministrore për intelektualët jashtë respektit për dijen e tyre, siç ishte rasti midis mbretit Nuh (v. 997 e.s.) dhe Es-Sahib Ibn ‘Abadit (v. 994 e.s.), dijetarit dhe shkrimtarit të madh mysliman nga shekulli i dhjetë, i cili refuzoi postin e ministrit që mbreti Nuh i ofroi atij.²² Për rrjedhojë, këta ministra luajtën rol jetik në rritjen e veprave dhe shkencës nga kultura të ndryshme. Veçanërisht, Ebu el-Fadl Muhamed Ibn ‘Ubeidullah el-Bel’ami (v. 975 er) dhe Ahmed Ibn Muhamed el-Xihani (v. e panjohur) ringjallën letërsinë arabe dhe perse në Semerkand dhe në të gjithë rajonin. Sipas Sam’aniut (v. 1166 e.s.), një udhëtar dhe kronist i famshëm mysliman, El-Bel’ami ishte “më i miri i kohës së tij në intelekt, mençuri dhe nderim ndaj shkencës dhe studiuesve.”²³ Ai ishte me

prejardhje arabe dhe e përktheu librin enciklopedik historik të Taberit në persisht. Gjatë postit të tij, poezia lulëzoi dhe u kopjuan 100 vëllime me poezi perse, që përbëheshin nga më shumë se 1,300,000 vargje.²⁴ El-Xihani, ministri i mbretit Nasr Ibn Ahmed, ishte gjithashtu i njohur për shkrimet e tij. Hameui e përshkruan atë si “një autor të virtytshëm me shumë botime.”²⁵ Ai sponsorizoi një numër studiuesish dhe doktorësh, mes tyre disa figura mu’tezilite si Ebu Zejd El-Belkhi²⁶ (v. 934 e.s.). Kështu, akademikët dhe intelektualët ishin në gjendje t’i kushtonin të gjitha përpjekjet e tyre studimit dhe kërkimit pa pasur nevojë të shqetësoheshin për nevojat e tyre financiare. Kjo do të kishte ndikuar në komunitetin e dijetarëve dhe do të pasuronte të gjitha fushat e studimit, duke përfshirë disiplinat islame.

A mori Maturidiu ndonjë mbështetje shtetërore? Informacioni i kufizuar biografik për të nuk jep një përgjigje. Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë e tij në mesin e dijetarëve të rajonit, udhëheqjen e tij në shkollën juridike Hanefi dhe frontin teologjik sunit, si dhe vendbanimin e tij të përhershëm

21. A. Ibn Ebi Usab’eh, *‘Ujun el-Enbai fi et-Tabakat el-Etibba’* (Beirut: Dar el-Kutub el-‘Ilmijeh, 1998), 392.

22. Hameui, *Irshad el-Erib Ila Ma’rifeti l-edib*, vëll. 1, 455.

23. Es-Sem’ani, *El-ensab*.

24. E. Brown, *Tarikhu l-Edeb fi Iran*, përkth. Ibrahim Emin Esh-Sheuaribi, 1st ed. (Cairo: Mektebet eth-Thekafeh ed-Dinijeh, 2007).

25. Hameui, *Irshad el-Erib Ila Ma’rifeti l-edib*, vëll. 1, 455.

26. Po aty.

në Semerkand, është e vështirë të përjashtohen gjasat. Admirimi i punës së tij nga myslimanët e përgjithshëm dhe po aq studiuesit do të kishte çuar në mënyrë të pashmangshme në njohjen dhe, ndoshta, mbështetjen e tij nga shteti. Një praktikë tjetër që tregon interesin e mbretërve samanidë që ndikojnë në jetën akademike në rajon është ndërtimi i bibliotekave publike dhe private. Çdo xhami dhe qytet në rajon kishte një bibliotekë që përmbante libra nga shkenca, qytetërime, gjuhë dhe kultura të ndryshme. Për shembull, biblioteka e madhe e qytetit Merv mbante libra në greqisht dhe gjuhën siriane, si dhe në arabisht e persisht.²⁷ El-Hameui shënon habinë e tij ndaj bibliotekës, e cila përmbante libra që vinin nga koha e perandorisë Sasanide, veçanërisht mbreti i fundit sasanid Jazdagerd III. El-Hameui kaloi tre vjet duke jetuar në qytet, duke shijuar librat e bibliotekës që arrinte më shumë se 12,000 tituj. Qasja në libra ishte e hapur për të gjithë, deri në atë masë sa El-Hameui huazoi 200 tituj pa pasur nevojë të paguante asnjë tarifë ose të jepte ndonjë garanci.²⁸ Madhësia e këtyre bibliotekave dhe përmbajtja e tyre tregon se, megjithëse Azia Qendrore ndodhej në periferi, në qendrat e Lindjes së Mesme, intelektualisht

ishte shumë mirë e lidhur dhe pjesë e të gjitha debateve bashkëkohore. Për më tepër, disponueshmëria e titujve arabë në një tokë turke dhe perse dëshmon përdorimin e gjerë të arabishtes si një medium akademik i ngjashëm me rolin e latinishtes në Evropë. Kjo konstatohet më tej nga përkthimi i mijëra vargjeve nga persishtja në arabisht, siç është rasti i Bel'amit. Disponueshmëria e titujve në sirianisht dhe greqisht është një tregues se ka pasur përpjekje për ta kthyer rajonin në një Bagdad tjetër, në të cilin pasuria intelektuale e të gjitha qytetërimeve përkthehet dhe studiohet ngjashëm me shtëpinë e urtësisë në kryeqytetin e Khalifatit. Prandaj, Semerkandi nuk ishte një rajon rural i shkëputur plotësisht nga intensiteti i jetës urbane. Këto dëshmi historike kundërshtojnë deklaratën e Rudolfit, i cili pretendon se Semerkandi ishte periferik në krahasim me Bagdadin dhe beson se kjo nuk është befasisëse për shkak të largësisë së tij.²⁹ Përkundrazi, Semerkandi u bë qendra kryesore në zhvillimin e shumë disiplinave islame, duke përfshirë teologjinë dhe ekzegjzën, nëpërmjet duarve të shumë dijetarëve si Maturidiu, mësuesit dhe nxënësve të tij. Nga kjo rezulton se Maturidiu kishte qasje në shkrime nga shkolla filozofike me prejardhje të ndryshme.

27. Metz, *Islamic Civilization in the Fourth Century of the Hegira*.

28. Hameui, *Mu'xhem el-Buldan*, vëll. 5, 112.

29. Rudolph dhe Adem, *Al-Maturidi and the Development of Sunni Theology in Samarqand*, 73.

Diversiteti është termi më i mirë për të ilustruar një atribut themelor të shoqërisë në të cilën Maturidiu u rrit, mësoi dhe dha mësim. Ajo gëzonte, atë që është bërë e njohur në termat modernë, multikulturalizmin dhe lirinë e fesë. Bashari tregon se, "...shumë hebrenj, një pakicë të krishterësh dhe sekte të ndryshme nga mexhusët..."³⁰ jetonin në rajon. Në mënyrë të ngjashme, Ibn En-Nedim (v. 990 e.s.), bibliograf i njohur mysliman, në librin e tij *El-Fihrist* konfirmon praninë e fortë të dy besimeve dominuese në rajon: Judaizmit dhe Krishterimit. Megjithatë, ai këshillon ekzistencën e një sërë fesh gnostike gjithashtu, si Manikeizmi dhe El-Summanijje, të cilët ishin pakicë.³¹ Në fakt, Maturidiu u referohet atyre në citate në librin e tij *Kitabu et-Teehid* dhe adreson disa nga parimet e besimeve të tyre në diskutimet e tij teologjike. Kjo tregon se mësimet e këtyre besimeve gnostike u praktikuan, u mësuan dhe u diskutuan në rajon, megjithëse ato nuk paraqisnin një sfidë të drejtpërdrejtë ose të madhe për Maturidiun.³² Më e rëndësishmja, ajo thekson lirinë e mendimit dhe debatit midis feve të ndryshme në shoqëri. Prandaj, njohuritë e

Maturidiut nuk ishin të kufizuara në mësimet tradicionale të Islamit, siç ndodhte në qytetet tradicionale të Mekkes dhe Medinës. Përkundrazi, ai ishte i rrethuar nga fe dhe teologji të ndryshme që ndryshonin nga Islami dhe shumë herë i sfidonin parimet e tij. Mjedisi i diversitetit dhe i lirisë do të kishte ndikuar në perceptimet dhe shkrimet e Maturidiut në disiplinat islame dhe burimin kryesor nga i cili kërkohet besimi islam.

Diversiteti i shoqërisë së Maturidiut manifestohet edhe brenda shkollave myslimane. Shkolla dhe orientime të ndryshme islame bashkëjetonin në rajon. Bashari ofron një hartë të plotë demografike të përhapjes dhe ndikimit të shkollave dhe orientimeve të ndryshme islame në rajon; shi'ah³³, khavarixhët³⁴,

33. Shi'ah është një term i aplikuar për pakicën më të madhe në botën myslimane, të cilët besojnë se, pas vdekjes së Pejgamberit, imami (udhëheqja politike dhe fetare e komunitetit mysliman) duhet të kishte shkuar tek 'Aliu, kushëriri dhe dhëndrri i tij. -ligji i Pejgamberit dhe i pasardhësve të tij si një e drejtë hyjnore. Për më tepër shiko në, Muhammed Shehrastani, *El-Milel ue n-Nihal* (Beirut: Dar el-Fikr, 1997); Xhuhani, *El-Masu'ah el-Mujessera fi el-Edjan ue el-Medhabib ue l-Ahزاب el-Mu'asire*; Arzina R. Lalani and Studies Institute of Ismaili, *Early Shi'ii Thought: The Teachings of Imam Muhammad Al-Baqir* (London: I.B. Tauris, 2004); N.J. Coulson, *A History of Islamic Law* (Edinburgh: Edinburgh University Press, 1991).

34. Khauarixhët ose Khauarixh ishte një nga sektet më të hershme që u shfaq. Ata u rebeluan kundër të gjithë sundimtarëve

30. Beshari, *Ahsen et-Tekasim fi Ma'rifet el-Ekalim*.

31. M. En-Nedim, *El-Fihrist*, 1st ed. (Beirut: Dar El-Kutub el-Ilmijeh, 1996).

32. M. Maturidi, *Kitabu et-Teehid* (Beirut: Dar Sedir 2001).

mu'tezilitët³⁵, karamitët,³⁶ kaderitët³⁷

muslimanë të asaj kohe dhe tentuan t'i vrisnin. Ata ia dolën të vrisnin khalifin 'Ali, kushëririn dhe dhëndrin e Pejgamberit. Ata përfaqësojnë sektin e parë ekstremist në Islam. Ata shpallën apostazi ndaj të gjithë atyre që i kundërshtojnë. Sipas tyre, çdo person që kryen një mëkat të madh bëhet femohues dhe për këtë arsye duhet të ekzekutohet. Për më shumë shih, Xhuhani, *El-Masu'ah el-Mujessera fi el-Edjan ue el-Medhabib ue l-Abzab el-Mu'asire*; John L. Esposito, *The Oxford History of Islam* (New York, N. Y.: Oxford University Press, 1999); Andrew Rippin, *Muslims: Their Religious Beliefs and Practices* (London; New York: Routledge, 1990).

35. Mu'tezilitët janë një shkollë islame e teologjisë e bazuar në arsye dhe mendim racional. Lulëzoi në qytetet e Basrës dhe Bagdadit, të dyja në Irakun e sotëm, gjatë shekujve tetë deri në shekullin e dhjetë. Për më shumë shih, Xhuhani, *El-Masu'ah el-Mujessera fi el-Edjan ue el-Medhabib ue l-Abzab el-Mu'asire*; Shehrastani, *El-Milel ue n-Nihal*.

36. Karamitët është një sekt i themeluar nga Muhammed Ibn Kurram në shekullin e nëntë. Ai ishte një asket që e mbajti doktrinën e antropomorfizmit në një shkallë ekstreme dhe e përdori për të transmetuar atë që Dhehebi i përshkruan si tradita jashtëzakonisht të dobëta. Ai predikoi në Azinë Qendrore dhe kundërshtoi mësimet e mu'tezilitëve në rajon. Megjithatë, ai nuk ishte në përputhje të plotë me mësimet e sunnitëve të zakonshëm. Për më shumë shih, Edmund Bosworth, "The Rise of the Karamiyyah in Khurasan," *The Muslim World* 50, no. 1 (1960); Dhehebi, *Sijer A'lam el-Nubela*, vëll. 11; A. Ibn Tejmijeh, *Kitabu err-Rred 'Ala el-Mantikijjin* (Beirut: Mu'esesat Er-Rejan, 2005).

37. Kaderitët ishte një nga sektet e para që u shfaq në botën muslimane gjatë sundimit të khalifatit umejad. Ata pohojnë se "njerëzit posedojnë plotësisht kapacitetin për të

dhe xehmijet³⁸ ishin të gjitha sekte teologjike të rajonit. Ata jetuan në qytete të ndryshme dhe bashkëjetuan me dy shkollat kryesore të jurisprudencës sunnite, shafi'itët dhe hanefitët.³⁹ Ky diversitet ndërftetar

vepruar vullnetin e lirë dhe fuqinë efektive... ata pohojnë se qeniet njerëzore mbajnë iniciativën e plotë, pa asnjë përparësi në vullnetin e Allahut për veprimet e tyre, madje as në dijeninë e Tij për to." Ebu Ja'le, *Tabakat el-Hanabilah*, vëll. 1, 32. Për më tepër, shih L. M. Surhone, M. T. Timpledon, dhe S. F. Marseken, *Qadariyya* (Germany: VDM Publishing, 2010); Rippin, *Muslims: Their Religious Beliefs and Practices*; Esposito, *The Oxford History of Islam*; Michael Cook, *Early Muslim Dogma: A Source-Critical Study* (Cambridge; New York: Cambridge University Press, 1981).

38. Xehmijet janë pasuesit e Xhehm Ibn Safuanit, i cili tha: "...njerëzit janë të detyruar të bëjnë atë që bëjnë..." dhe ua mohojnë të gjitha aftësitë njerëzve. Ai pretendoi se Xheneti dhe Xhehenemi do të marrin fund. Ai gjithashtu pohoi se besimi përfshin vetëm njohjen e Allahut, ndërsa blasfemia përfshin vetëm mosnjohjen e Tij. A. K. Ibn Tahir el-Baghdadi, *El-Farku Bejne el-firak ue Bejanu l-Firka el-Naxhijeh Minhum*, 2nd ed. (Beirut: Dar el-Afak el-Xhedide, 1977), 199-200. Për më shumë shih, Xhuhani, *El-Masu'ah el-Mujessera fi el-Edjan ue el-Medhabib ue l-Abzab el-Mu'asire*; Shehrastani, *El-Milel ue n-Nihal*.

39. Bashari thotë, "Pasardhësit e 'Aliut atje janë shumë të nderuar... Khauarixhët gjenden në Sexhistan, pjesë të Harah, Krukh dhe Istribjan në një numër të madh. Mu'tezilitët kanë një prani të qartë, sado jo dominuese, në Nejsabur ku shi'itët dhe karamitët kanë njëfarë aktiviteti. Megjithatë, dominimi në rajon është i ndjekësve të Ebu Hanifes, me përjashtim të Kurat esh-Shash, Ilak, Tus, Nesa... ku mbizotërojnë pasuesit

hapi derën për shumë ndërveprime, debate, kërkime dhe studime. Publiku i gjerë në rajon, veçanërisht studentët e qarqeve fetare, u ekspozuan ndaj shumë koncepteve që ishin të paktën kundërshtuese, në mos kontradiktore. Në një mjedis të tillë, Maturidiu dhe studiues të tjerë do të ishin ekspozuar ndaj shumë shkollave që do të kishin ndikuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në formësimin e paradigmave të tyre ose qasjen ndaj mësimit të besimit islam. Dialogë dhe debate intelektuale e filozofike të fuqishme dhe nganjëherë ekstreme ndërmerreshin gjatë kohës së Maturidiut në këtë rajon. Bashariu hedh dritë mbi intensitetin e debateve që zhvilloheshin atje, veçanërisht midis shkollave shi'ite dhe karamije. Ai thotë: "Gjakderdhja mund të ndodhë si rezultat i debateve intensive dhe ndonjëherë do të kërkonte ndërhyrjen e sulltanit."⁴⁰ Sipas Ebu Zehras (v. 1974 e.s.), një dijetar i shquar mysliman, simpoziumet dhe debatet publike ishin praktika të shpeshta shoqërore dhe intelektuale. Disa u drejtuan nga publiku i gjerë dhe shkolla të veçanta të mendimit, por disa u mbajtën nën kujdesin e sulltanit dhe familjes mbretërore.⁴¹

shafi'itë... shumica e njerëzve në Tirmidh janë xhehemitë, banorët e Rakas janë shi'itë dhe njerëzit e Kandarit janë kadarije." Për më shumë shih Beshari, *Absen et-Tekasim fi Ma'rifet el-Ekalim*, 156.

40. Po aty; Ibn Haukal, *Surat el-Erd*.

41. Ebu Zehra, *Tarikh el-Medhabib el-Islamijeh*.

Në një masë të veçantë, kjo është e ngjashme me praktikën moderne të thirrjes së konferencave dhe debateve ku një temë e caktuar është studiuar nga këndvështrime të ndryshme dhe nga palë të ndryshme. Bashariu pajtohet në heshtje me Ebu Zehran në këtë mendim. Në transmetimet e Bashariut se si kalonin netët gjatë muajit të Ramazanit në rajon, ai shprehet: "[Sulltani] kishte simpoziume specifike gjatë muajit të Ramazanit, në të cilat zhvilloheshin diskutime midis shkollave të ndryshme. Ai do të propozonte një temë specifike dhe do ta hapte atë për diskutim para palëve të ndryshme, pastaj të gjitha do të kontribuojnë."⁴² Edhe një herë, raportet historike të regjistruara nga Ebu Zehra, Bashariu dhe të tjerët mohojnë mendimin e Rudolfit, i cili pretendon se: "Temat teologjike që mbizotëruan në Bagdad u shfaqën me forcë të ngjashme në Transoksani në mbi pesëdhjetë vjet më vonë."⁴³

Rrjedhimisht, në një klimë debatesh të zjarrta, shkollave të ndryshme, koncepteve kontradiktore midis orientimeve të ndryshme islame, konkurrencës së fortë në të gjitha disiplinat dhe një rajoni me shumë besime, Maturidiu hapi sytë mbi botën. Ai jetoi, studioi dhe mësoi

42. Beshari, *Absen et-Tekasim fi Ma'rifet el-Ekalim*.

43. Rudolph dhe Adem, *Al-Maturidi and the Development of Sunni Theology in Samarqand*, 73.

në rrethana të tilla dhe padyshim që ato ndikuan në mendjen, mësimet dhe perceptimet e tij për botën dhe Islamin, veçanërisht teologjinë dhe ekzegjezën e Kur'anit.

Debatet më madhore teologjike gjatë kohës së Maturidiut

Një vështrim i afërt i traktateve që Maturidiu shkroi në disiplinën e teologjisë islame zbulon se ai i kushtoi një pjesë të konsiderueshme të kontributit të tij akademik debatit mbi ideologjitë e shkollave dhe sekteve jomyslimane dhe myslimane në rajonin e tij. Kryesisht, shkolla mu'tezilite dhe 'Abdullah el-Ka'bi⁴⁴ (v. 931 e.s.) dukej se tërhoqën vëmendjen e tij më shumë se të tjerët.⁴⁵ Prandaj, Maturidiu e diskutoi këtë dijetar dhe shkollë në gjashtë nga titujt e tij në fushën e teologjisë.

Shkolla mu'tezilite është një nga shkollat kryesore me të cilën u përballën Maturidiu dhe pasuesit e tij në tokën përtej lumit.⁴⁶ Disa dijetarë si Khamisi, një teolog bashkëkohor mysliman, dhe Xuhani (v. 2002 e.s.), një akademik mysliman, argumentojnë se Maturidiu dhe shkolla e tij u shfaqën

si një shkollë teologjike intelektuale sunite për të kundërshtuar kryesisht përhapjen e mu'tezilitëve në rajon.⁴⁷ Megjithatë, kjo pikëpamje është e pasaktë. Përpyekjet e Maturidiut nuk u ndalën në kundërshtimin e mësimave të mu'tezilitëve, megjithëse ato u fokusuan shumë në shkrimet e tij. Përkundrazi, ai shkoi më tej për të studiuar të gjitha parimet e teologjisë islame dhe shkroi të kuptuarit e tij për të në dritën e një paradigme të veçantë që ai krijoi, në të cilën ai sintetizoi arsyen dhe shpalljen, dhe themeloi një shkollë teologjike të pavarur sunite që vazhdon të formësojë doktrinën e miliona myslimanëve në mbarë botën.

Prania e titujve të tillë teologjikë në veprat e Maturidiut është dëshmi se ai ishte i ndikuar nga debatet e fuqishme dhe, në disa raste, armiqësore teologjike që pushtuan botën myslimane dhe, veçanërisht, rajonin e tij. Në veçanti, debatet e mu'tezilitëve, të cilët riformësuan plotësisht disiplinën e teologjisë islame, detyruan dinamika të reja në disiplinë dhe dominuan debatet filozofike dhe teologjike në botën myslimane për shekuj me radhë. Ndikimi i mu'tezilitëve ishte një nënprodukt i ndërveprimit që kishin myslimanët me qytetërimet e ndryshme përtej Gadishullit Arabik. Këto ndërveprime ideologjike dhe kulturore i ekspozuan ata

44. Ka'bi është një dijetar i njohur mu'tezilit dhe bashkëkohës i Maturidiut.

45. Rudolph dhe Adem, *Al-Maturidi and the Development of Sunni Theology in Samarqand*.

46. Ebu Zehra, *Tarikh el-Medhabib el-Islamijeh*; K. El-Bejadi, *Isbat el-Meram 'an Ibat el-Imam* (Beirut: Dar el-Kutub el-'Ilmijeh, 2007); Khamis, "Maturidijeh Rabibat el-Kalabijeh".

47. Xuhani, *El-Masu'ah el-Mujessera fi el-Edjan ue el-Medhabib ue el-Ah'ab el-Mu'asire*; Khamis, "Maturidijeh Rabibat el-Kalabijeh".

ndaj shkollave të ndryshme filozofike që nuk përputheshin me metodat tradicionale islame, të cilat mbështeteshin në provat tekstuale nga Kura'ni dhe Suneti për të vërtetuar ekzistencën e Zotit dhe të të dërguarve (rusul) dhe për të kuptuar parimet e ndryshme të besimit. Kjo kërkonte një qasje të re në vendosjen e ekzistencës së Zotit dhe shpjegimin e teologjisë islame⁴⁸, e cila ishte e nevojshme për debatet që zhvilloheshin ndërmjet myslimanëve dhe jomyslimanëve. Më vonë, u bë e nevojshme të shpjegohej paqartësia e disa prej aspekteve të besimit islam, duke përfshirë natyrën e Zotit, atributet e Tij hyjnore dhe veprimet e Tij.⁴⁹ Kjo çoi në lindjen e lëvizjeve të ndryshme myslimane dhe dy rrymave intelektuale, me dy paradigma të dallueshme, të cilat filluan të përplasen në arenën intelektuale islame. Rryma e parë ishte tradicionale dhe e miratuar nga shumica e dijetarëve sunitë. E dyta ishte e re, filozofike dhe e promovuar e miratuar nga filozofët myslimanë dhe shkolla mu'tezilite. Qëndrimi i shkollës tradicionale ishte të deklaronte thjesht rëndësinë e të besuarit në parimet e besimit pa

kërkuar ndonjë hetim të mëtijshëm për natyrën e tij. Nga ana tjetër, filozofët dhe mu'tezilitët myslimanë, të cilët u bënë përfaqësuesit më të fortë të rrymës filozofike, kërkuan të studionin, analizonin dhe t'u përgjigjeshin pyetjeve të tilla jomyslimanëve dhe myslimanëve që kërkonin shtjellim.

Në mungesë të përgjigjeve të drejtpërdrejta dhe të qarta për këto çështje në tekstet tradicionale, mu'tezilitët filluan të përdorin aftësinë e arsyes dhe logjikës. Ata kërkuan të vendosin besimin islam duke përdorur metoda, të konsideruara joortodokse, të bazuara në parime dhe argumente racionale dhe logjike. Megjithatë, mu'tezilitët, veçanërisht në kohën e Maturidiut, nuk ishin të imunizuar kundër qasjes filozofike. Ata, me vetëdije ose pa vetëdije, u ndikuan shumë nga vepra e filozofëve grekë, veçanërisht të Platonit dhe Aristotelit.⁵⁰ Rrjedhimisht, logjika dhe intelektu njerëzor, të cilin mu'tezilitët synonin ta përdornin si mjet për të mbrojtur dogmën islame, u bënë kriteret që përcaktuan çfarë mund të klasifikohet si mënyrë islame e saktë. Ata e shihnin intelektin si autoritetin e vetëm që mund të provonte çdo gjë që lidhet me Zotin. Emin shpjegon: "Mu'tezilitët

48. M. Es-Sejjid, *Asalat 'Ilm el-Kelam* (Cairo: Ed-Dar eth-Thekafa li en-Neshr ue et-Tevzi', 1987).

49. R. El-Bendar, *Medbheeb el-Mu'tazile min el-Kelam Ila el-Feksefe Diraseh fi Nesh'atibi ue Mebadi'ibi ue Nadharijjatihi fi l-uxbud* (Beirut: Dar en-Nubugh li et-Tiba'ah ue en-Neshr ue et-Teuzi', 1994).

50. Për më tepër, shih Tash Kubra Zadeh, *Miftahu es-Se'adeh ue Misbabu s-Sijadeh*; Z. Xharullah, *El-Mu'tezileh* (Beirut: El-Ehlijeh lin-Neshr ue et-Teuzi', 1974).

besonin se intelektit njerëzor i është dhënë autoriteti dhe gjerësia përfundimtare për t'i mundësuar atij të vendosë gjithçka që lidhet me Zotin. Prandaj intelekti i njeriut nuk njeh kufij përveç asaj që vendos si provë.”⁵¹ Emin, më pas, shton: “Kjo tendencë... manifestohet... në të gjitha kërkimet e tyre... ata ndjekin arsyetimin logjik deri në fund... pasi të arrijnë atë që e perceptojnë si zgjidhje që do të interpretonin ajetet... në një mënyrë që përputhet me arsyetimin e tyre logjik.”⁵² Në fakt, mu'tezilitët besonin se intelekti ishte prova kryesore dhe më e mirë në Islam. ‘Abdul Xhebbar (v. 1025 e.s.), një dijetar i shquar mu'tezilit, rendit rendin e provave dhe pohon: “... dhe lloji i parë i provës është ‘akl-i... sepse ‘akl-i është themeli i të gjithëve.”⁵³ Kështu, bota myslimane u kap në një dikotomi (vu përballë ndarjes në dy pjesë) midis ithtarëve të ‘akl-it, intelektit njerëzor dhe përkrahësve të nakl-it, teksteve të shpallura, të cilët e shohin nakl-in si burimin kryesor të të gjitha të vërtetave në Islam dhe ‘akl-in si të nënshtruar ndaj tij, dhe besojnë se myslimanët duhet të pranojnë pa kushte atë që *nakl*-i dikton pavarësisht nga arsyetimi apo

interpretimi racional.⁵⁴

Maturidiu u ballafaqua me mu'tezilitët dhe studioi mësimet e tyre. Ky përfundim nuk del vetëm nga literatura e tij, në të cilën ai u përgjigjet atyre, por edhe nga dëshmitë historike që vërtetojnë se ata kanë jetuar në rajonin e tij. Në fakt, mu'tezilitët gëzonin një prani të fortë dhe lulëzuan në tokën përtej lumit. Studiues dhe historianë të ndryshëm, si Ebu Zehra, Bashari dhe Ibn Haukal, e konfirmojnë këtë fakt.⁵⁵ Dominimit të tyre në Semerkand dhe Khurasan i parapriu dominimi i tyre në zemër të khalifatit ‘abasid, Bagdad, ku ata detyruan komunitetin e dijetarëve dhe popullsinë e madhe sunite për të ndjekur mësimet e tyre përmes shtypjes së shtetit ‘abasid.⁵⁶ Megjithatë, shkëlqimi i tyre në rritje në Bagdad u eklipsua gjatë sundimit të khalifit ‘abasid Muteuekkil (v. 861 e.s.), i cili nxori një rezolutë që ndalonte lëvizjen mu'tezilite dhe hoqi anëtarët e saj kryesorë nga të gjitha funksionet kryesore publike. Rrjedhimisht, shumë dijetarë mu'tezilitë nga fundi

51. A. Emin, *Duha el-Islam* (Cairo: Mektebet el-'Usra, 1997), 39.

52. Po aty, 42.

53. A. ‘Abdul Xhebbar, A. Balkhi dhe H. El-Xheshami, *Fadl el-I'tizal ue Tabakatu el-Mu'tezile* (Tunisia: Ed-Dar et-Tunisijjah lin-Neshr, 1973), 139.

54. A. Emin, *Duha el-Islam*, 39.

55. Ebu Zehra, *Tarikh el-Medhabib el-Islamijeh*; Beshari, *Ahsen et-Tekasim fi Ma'rifet el-Ekalm*; Ibn Haukal, *Surat el-Erd*; En- Nedim, *El-Fibr*.

56. Rifa'i, *El-Khilafe el-'Abbasijeh ue el-Harekatu el-Istiklalijeh fi el-Meshrike*; Shehrastani, *El-Milel ue n-Nibal*; Ibn Tahir el-Baghdadi, *El-Farku Bejne el-firak ue Bejanu l-Firka en-Naxhijeh Minhum*; Dhehebi, *Sijer Alam en-Nubela*.

i shekullit të nëntë emigruan në rajonin e Maturidiut për t'i shpëtuar syrit të khalifit të ri dhe reagimit të dijetarëve tradicionalë të Hadithit, të cilët gjetën te khalifi i ri një aleat të fortë kundër mu'tezilitëve dhe e përdorën për t'u hakmarrë ndaj tyre.⁵⁷

Ky emigrim përkoi me ngritjen e një numri dijetarësh karizmatikë dhe të shquar mu'tezilitë, si Ebu 'Uthman el-Xhahidh (v. 868 e.s.), Ebu el-Husejn el-Khajjat (v. 912 e.s.), Ebu 'Ali el-Xhubba'i (v. 915 e.s.) dhe djali i tij Ebu Hashim 'Abduselam (v. 933 e.s.). Ata qëndruan përballë fushatës së tradicionalistëve kundër shkollës së tyre, mbrojtën me forcë parimet e tyre dhe vazhduan të debatojnë dhe t'u dëlnin për zot ideve të tyre. Përveç këtyre dijetarëve, dy dijetarë të shquar mu'tezilitë u vendosën në rajonin e Maturidiut dhe u bënë udhëheqës të lëvizjes atje: Ebu Kasim el-Ka'bi⁵⁸ (v. 931 e.s.) dhe Ebu Zejd el-Belkhi (v. 934 e.s.). Ata luajtën një rol kyç në përhapjen e mësimave të shkollës mu'tezilite dhe jetuan në qytetin e Belkhut, në afërsi të vendlindjes së Maturidiut. Shumë debate u zhvilluan midis tyre dhe Maturidiut, i cili u kushtoi tituj

të plotë për t'iu përgjigjur mësimave të tyre.⁵⁹

Përpjekjet e Muteuekkilit mund t'i kenë dhënë fund ndikimit politik të mu'tezilitëve, por nuk i dhanë fund ndikimit të tyre akademik.⁶⁰ Nedui zbulon, në sytë e shumë akademikëve të rinj, se shkolla mu'tezilite u perceptua si e vlerësuar me “vëzhgime të mprehta, debate shkencore dhe mendje të hapur.”⁶¹ Ky perceptim u përforcua nga mungesa e dijetarëve të shquar tradicionalë sunitë për të paraqitur një front akademik të kundërt në një kohë kur udhëheqësit mu'tezilitë, të përmendur më lart, po duronin fushatën politike kundër tyre dhe po drejtonin me qëndrueshmëri front akademik. Pas vdekjes së Ahmed Ibn Hanbelit⁶², pasuesit e shkollës së tij tradicionale nuk ishin të interesuar në zhvillimin e argumenteve racionale përballë mu'tezilitëve. Në vend të kësaj, ata

59. Khamis, “Maturidijeh Rabibat el-Kalabijje”.

60. 'Ali Nedui, *Rixhahu el-Fikri ue ed-Da'ueh fi el-Islam* (Damascus: Dar el- Kalem, 2002).

61. Po aty, vëll. 1, 221.

62. Ahmed Ibn Hanbel lindi në Bagdad në vitin 780 të erës sonë dhe vdiq atje në vitin 855 të erës sonë. Ishte teolog mysliman, jurist dhe figurë e shquar e Islamit. Ai përpiloi traditat e pejgamberit Muhamed dhe formuloi shkollën Hanbeli, më tradicionaliste nga katër shkollat juridike ortodokse të ligjit islam. Për më tepër, shih G. Makdisi, “Ahmad Ibn Hanbal,” <http://www.britannica.com/EBchecked/topic/10121/Ahmad-ibn-Hanbal>.

57. A. Ebu 'Izze, *Inhijar el-Hadare el-'Arabije ue l-Islamijeh ue Sebil en-Nuhud* (Amman: 2008); Ebu Ja'le, *Tabakat el-Hanabilah*; M. Ebu Zehra, *Ibn Hanbal Hajatuhu ue 'Asruhu* (Cairo: Dar el-Fikr el-'Arabi, 1947).

58. Maturidiu shkroi disa tituj duke i hedhur poshtë ato, duke përfshirë mendimet e Ka'bit.

iu përmbajtën qasjes tradicionale të nakl-it të papërpunuar, që është thjesht transmetimi i transmetimeve tekstuale nga Kura'ni dhe tradita e Pejgamberit, pa ofruar një shpjegim stimulues apo kundërshtim të mirëndërtuar ndaj mësimëve të mu'tezilitëve. Ata iu shmangën debateve me mu'tezilitët dhe, kur i angazhuan ato, u shfaqën jashtë kontaktit me shkencat moderne dhe metodologjinë akademike bashkëkohore.⁶³

Kështu, klasa intelektuale brenda sferës sunite vazhdoi të ndikohej nga mu'tezilitët dhe kishte nevojë për një udhëheqje dhe shkollë të re që do të revolucionarizonte qasjen tradicionale ndaj teologjisë, dijetarisë së projektit dhe bashkëkohësisë, dhe do të luftonte mu'tezilitët me stilin që ata shpallnin. Në një kohë kaq kritike, Maturidiu dhe, pas tij, Esh'ariu u shfaqën si reformatore të teologjisë islame sunite dhe pionierë të shkollave të reja teologjike sintetike, secili në rajonin e tij përkatës.

Epoka në të cilën jetoi Maturidiu ishte thelbësore dhe me ndikim për sa i përket evolucionit të shkencave islame. Shumë disiplina islame ishin ende në fazat e tyre të formimit, gjë që ishte shumë e përshtatshme për dijetarët e kalibrit të Maturidiut që të përfshiheshin në proces dhe të kontribuonin. Shfaqja e

shkollave polarizuese, si mu'tezilitët dhe tradicionalistët, e inkurajuan Maturidiun të përfshihej në një studim, debat dhe analizë të plotë të teksteve hyjnore, Kura'nit dhe Hadithit, për të kërkuar prova për të hedhur poshtë mësimet joortodokse të së parës dhe interpretimet ekstreme radikale të së dytës.

Përfundim

Është e qartë se mjedisi, rrethanat e rajonit dhe epokës ndikuan në edukimin, motivimet dhe kontributet akademike të Maturidiut. Rajoni në të cilin ai u rrit dhe studioi ishte ekonomikisht i begatë dhe i pasur. Përveç kësaj, ai gëzonte një gjendje të përhershme stabiliteti dhe sigurie politike, prandaj ishte një mjedis i përshtatshëm për Maturidiun dhe të gjithë studiuesit për të studiuar, hulumtuar dhe dhënë mësim. Devotshmëria fetare e mbretërve samanidë dhe nderimi i tyre ndaj dijes siguroi që komuniteti i dijetarëve dhe intelektualëve të inkurajohej dhe të mbështetej nga shteti. Politikat që ata aplikuan, jo vetëm që promovuan lirinë e studimit dhe kërkimit fetar, por gjithashtu kujdeseshin për nevojat e të gjithë studiuesve dhe intelektualëve, qofshin ata vendas apo vizitorë. Multikulturalizmi dhe liria e fesë, që rajoni gëzonte, hapi portën e takimeve dhe ndërveprimeve të shpeshta kulturore, intelektuale dhe fetare midis myslimanëve

63. Nedui, *Rixhalu el-Fikri ue ed-Da'ueh fi el-Islam*.

dhe jomyslimanëve. Angazhimi ndërmjet orientimeve myslimane dhe jomyslimane brenda së njëjtës shoqëri dhe ekspozimi ndaj burimeve të reja të dijes dhe arsyes i nxiti studiuesit myslimanë të kërkonin instrumente të reja debati dhe të improvizonin metoda të reja për t'iu kundërvënë tregimeve jo tradicionale. Maturidiu ishte në ballë të kësaj lëvizjeje në rajonin e tij dhe në botën myslimane. Kjo e bëri të nevojshme që ai të jepte kontribute të rëndësishme në teologji dhe ekzegjezën Kura'nore, sepse ai do të ndërtonte argumentet e tij të reja teologjike mbi këtë të fundit për të mbrojtur retorikën konvencionale që zbatohet nga myslimanët në qytetet tradicionale. Ai promovoi më tej përdorimin e *'akl-it*, intelektit dhe logjikës, në mendimin dhe debatet teologjike. Kështu përpjekja e tij i pasuroi myslimanët me argumente të reja për të mbështetur besimin e tyre.

Në mënyrë të ngjashme, diversiteti i shkollave dhe orientimeve myslimane, që rajoni gëzonte, e ekspozoi Maturidiun ndaj perspektivave të ndryshme myslimane për të kuptuar besimin islam. Për më tepër, ajo e detyroi atë të ndeshej me kuptime kontradiktore brenda qarqeve islame, të cilat ndikuan në zhvillimin e tij të një paradigme teologjike që merrte parasysh të gjitha mendimet dhe orientimet. Rritja e lëvizjeve teologjike ultra-rationale, të tilla si

mu'tezilitët, dhe lëvizjet e çuditshme, si karamitah, e shtynë Maturidiun të mbronte teologjinë tradicionale sunite në një qasje bashkëkohore dhe gjetjen e një shkollë të re dialektike sunite në një përpjekje për t'i dhënë fund konfliktit ndërmjet *'akl-it* dhe *nakl-it*. Informacioni personal i kufizuar i disponueshëm tregon se ai i parapriu shfaqjes së shkollës teologjike esh'ari me rreth 25 vjet. Kjo i bën kontributet e tij teologjike më të hershmet në akademinë sunite dhe shkolla e tij mbetet më e rëndësishmja në themelimin e një shkolle teologjike të plotë sintetike. Një tjetër përfundim i rëndësishëm nga studimi i moshës së tij është se ai është një bashkëkohës i Taberit, një prej studiuesve më të shquar të ekzegjezës kura'nore. Kështu, ai jetoi gjatë fazave evolucionare të disiplinës dhe kontributet e tij ekzegjetike, nëse vërtetohen, janë themelore për këtë fushë. Hulumtimi i edukimit të Maturidiut tregon se ai kryesisht përvetësoi njohuritë e shkencave islame nën orientimin e shkollës Hanefi, gjë që do të kishte ndikuar në perceptimin e tij për marrëdhëniet ndërmjet *'akl-it* dhe *nekl-it*, veçanërisht pasi shkolla Hanefi është e famshme për përdorimin e saj të analogjisë dhe logjikës në jurisprudencë. Megjithatë, do të ia vlente të hulumtohej, në një studim të veçantë, nëse Maturidiu ishte një ndjekës i verbër i shkollës apo një novator që rimodeloi qasjen

e shkollës ndaj ekzegjezës teologjike.

Maturidiu ka treguar, nëpërmjet studimit të shkurtër të titujve të tij, se ai ka ndikuar vazhdimisht në çdo disiplinë në të cilën ai shkroi dhe në gjeneratat pasuese përmes shkrimeve të tij. Ai shpiku metoda dhe pikëpamje të reja për të kuptuar këto disiplina sipas dëshmisë së të gjithë biografëve. Përveç kësaj, zhanret e ndryshme të titujve teologjikë që ai prodhoi, si dhe interpretimi i tij, pohojnë ndikimin reciprok të mjedisit akademik të

rajonit të tij në veprat e tij. Kështu, gjetjet e mësipërme konfirmojnë se konteksti social, politik, kulturor, personal dhe fetar i Azisë Qendrore kishte efekte pozitive në kushtetutën akademike të Maturidiut.⁶⁴

Përshtati Haki Sahitaj

64. Burimi: Aref Chaker. "The Life of Abu Mansur Al-Maturidi and the Socio-Political and Theological Context of Central Asia in the Tenth Century." *Australian Journal of Islamic Studies* 1, no. 1 (2016): 39-64.

Haxhi Vehbi Dibra (Agolli) (1867-1937)

Komentuesi më i mirë i Kur'anit në gjuhën shqipe, Kryetari i parë i Kuvendit (1912), Kryetari i Parë i Komunitetit Mysliman, personalitet e dijetar i madh.

Abstrakt

Gjithë vepra e Vehbi Efendiut mbetet si një mal në fushën e diturisë dhe kulturës sonë teologjike. Të paharruara e frymëzuese mbeten gjithmonë para nesh vetitë e tij të larta e njerëzore: thjeshtësia, ndershmëria, fisnikëria shpirtërore, dashuria për risinë e për të rinjtë, të cilëve u jepte zemër që po të kishin një shkëndijë, të ndiznin zjarr.

Te Vehbi Dibra ishin mishëruar në mënyrë më të plotë organike bindjet e thella të një teologu, filozofi islam, të cilat në çdo rast, sipas parimeve të shenjta kur'anore, janë në një unitet të plotë me parimet e botëkuptimit atdhetar. Veprimtaria klerikale dhe atdhetare e Vehbi Dibrës janë në unitet dhe kanë ecur paralelisht në një rrugë, çka dëshmon se të qenit klerik nuk bie në kundërshtim me të qenit atdhetar, përkundrazi i shërbyen më mirë dhe më shumë çështjes kombëtare.

Haxhi Vehbi Agolli (Dibra) lindi në Dibër të Madhe më 12.03.1867, në një familje të nderuar, në familjen e Agollëve, të njohur për veprimtari fetare dhe atdhetare. Ishte djali i Ahmed Efendi Agollit, hoxhë i respektuar, Myfti i Dibrës së Madhe.

Mësimet fillestare dhe ato të mesme i kreu në Dibër, ndërsa studimet e larta në Stamboll, ku përveç studimeve fetare, merrej edhe me veprimtari atdhetare-kombëtare. Ai zotëronte arabishten dhe osmanishten.

Ai jetoi në një kohë kur akoma ishte e freskët Lidhja e Prizrenit.



Ai u frymëzua nga libri “Dhe shkronja” e Sami Frashërit. Qyteti i tij, Dibra e Sipërme, aty nga viti 1900 përfshinte 3 fshatra dhe nuk ishte më pak i dëgjuar se qytetet e tjerë si: Shkupi, Prishtina, Tërana, Korça e Preveza, me një popullsi prej 136.000 banorësh.

Cila është veprimtaria e tij për Shqipëri?

Në vitin 1908, mori pjesë në Kongresin e Manastirit.

Në vitin 1909, mori pjesë në Kongresin e Dibrës, ku u zgjodh kryetar i Kongresit.

Në vitin 1912, mori pjesë në Kuvendin e Vlorës, në Ditën e Flamurit, Ditën e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, më 28

Nëntor, ishte përfaqësues i Dibrës.

Në Qeverinë e Parë të Shqipërisë, Haxhi Vehbi Dibra zgjidhet Kryetar i Pleqësisë, zgjidhet edhe nënkryetar i Qeverisë.

Kur Ismail Qemali për ndonjë arsye, mungonte, ishte Haxhi Vehbi Dibra që e zëvendësonte.

Në vitin 1913, Qeveria e Përkohshme e Shqipërisë e ngarkon Haxhi Vehbi Dibrën me detyrën e Myftiut të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman Shqiptar të mbarë Shqipërisë.

Në vitin 1916, nuk qe e rastit kur ngarkohet me detyrën e Kryetarit të Gjyqit të Naltë të Sheriatit.

Në vitin 1923, Haxhi Vehbi Dibra u zgjodh Kryetar i Kongresit të Parë të Myslimanëve Shqiptarë, detyrë të cilën e vazhdoi deri në vitin 1929.

Gjatë kësaj kohe Komuniteti Mysliman mori ngjyër kombëtare dhe zgjidhi shumë probleme. Sistemoi të gjitha pronat e vakëfeve, i evidentoi këto me dokumentacionin përkatës të përpiktë, normalizoi shërbimin fetar në qytete e fshatra, realizoi një varg reformash centralizuese, sidomos në drejtim të vartësisë së faltoreve dhe kuadrove, ai gjithashtu hodhi edhe idenë për formulimin e statutit.

Komuniteti që fitoi njohjen juridike, filloi të botojë revistën e përmuajshme “Zani i Naltë”. Ai ndikoi në hapjen e “Medresesë së Naltë” në Tiranë. Në këtë mënyrë

autoriteti i Komunitetit Mysliman Shqiptar u rrit shumë dhe vendosi lidhje me shumë vende islame. Më 1935 H. Vehbi Dibra shkon për herë të dytë në Qabe, ku u afirmua si një dijetar islam i kohës.

Në vitin 1924, ishte Haxhi Vehbi, ai që e përuroi Medresenë e Naltë në Tiranë.

Përveç këtyre detyrave me shumë rëndësi, me shumë përgjegjësi, Haxhi Vehbi Dibra është marrë edhe me krijimtari.

Ka shkruar, ka botuar shumë punime, studime, krijime e përkthime, që janë botuar në shtypin e kohës, kryesisht në revistën “Zani i Naltë”, që botohej në Tiranë prej muajit tetor 1923 deri në prill 1939.

H. Dibra ishte një nga komentuesit më të shkëlqyer të Kur’anit në gjuhën shqipe. Këto ligjërata të mbajtura në xhami janë botuar në revistën “Zani i Naltë”. Ndërsa në vitin 1993 botohen të plotat në Harper Woods, të Detroitit, në Michigan, SHBA nga Imam Vehbi Ismaili, nën titullin “Ç’urdhëron Kur’ani?”

Të gjitha cilësitë e teologut mysliman personifikoheshin te Vehbi Dibra, imam dhe haxhi, kryemyfti dhe kryetar senati, vaiz dhe komentues i Kur’anit. Kryesoi dhe drejtoi për vite me radhë teologët më të shquar shqiptarë. Haxhi Vehbiu, me mendimet e tij të larta e progresive, i ftonte njerëzit ta shfrytëzojnë inteligjencën e tyre.

Në komentin që i bënte Haxhi Vehbiu disa citateve kur’anore thoshte:

“Me zgjedhë të aftin e të meritueshmin dhe me e vu në krye të detyrës, e pastaj ky me veprue e me gjykue me arsye, me drejtësi...”

Në planin politik te Haxhi Vehbiu gjejmë një propagandist të shkëlqyer, që punonte gjithmonë për mbarëvajtjen e kombit e të atdheut. Në unitetin dhe bashkimin e gjithë shqiptarëve shihte të vetmen rrugë për të siguruar të ardhmen tonë. Ai do të thoshte në Kuvendin Kombëtar të Vlorës më 28 nëntor 1912 se “Kristiani e myslimani janë vëllezër shqiptarë të pandarë”. “Armikut të atdheut i pritet hovi e guximi në qoftë se na shef të bashkuar e të lidhur për një qëllim të naltë”; “Naltësimi e përparimi i një vendi varet në sigurimin e qetësisë së brendshme. Atje ku mungon qetësia, nuk mund të përparojë industria, tregtia e burimet e tjera ekonomike që e lumturojnë një popull”.

Si mendimtar dhe bartës i vizionit të Islamit ndër shqiptarët, Haxhi Vehbiu kuptoi qartë problemet dhe vështirësitë para të cilave gjendej Komuniteti Mysliman Shqiptar, të cilin ai e kryesonte. Ai kuptoi se Islami në Shqipëri duhej t’i hynte një rruge të re për të vazhduar misionin dhe rolin e tij mirëbërës e civilizues në ndërtimin e të ardhmes së atdheut. Ai theksonte se: “Injorancën s’mund ta justifikojmë

me pleqërinë tonë, as me mungesën e shkollave në atdheun tonë... pse jemi urdhnue për të studiue deri kur të vdesim, jemi urdhnue me udhtue deri në vendet më të largëta për të studiue”. Sipas tij trashëgimia islame e mbetur prej të parëve duhej të bëhej e vazhdueshme në mënyrë që të barazohej me arritjet moderne, “duke i shtyrë kufijtë e diturisë në horizonte më të largëta se ç’kanë parafytyruar teologët dhe dijetarët e parë të trevave tona”.

Sa herë që fatet e Shqipërisë ishin në rrezik, ai frymëzohej nga porosia e Muhammedit (a.s.) “Dashuria për atdheun është pjesë e besimit”.

Gjithë vepra e Vehbi Efendiut mbetet si një mal në fushën e diturisë dhe kulturës sonë teologjike. Të paharruara e frymëzuese mbeten gjithmonë para nesh vetitë e tij të larta e njerëzore: thjeshtësia, ndershmëria, fisnikëria shpirtërore, dashuria për të renë e për të rinjtë, të cilëve u jepte zemër që po të kishin një shkëndijë, të ndiznin zjarr. Kemi besim se brezat e ardhshëm, në vazhdimësi të mësimave të fesë do të studiojnë gjithnjë e më thellë veprën e shquar të H. Vehbi Dibrës me mirënjohje dhe nderim të thellë.

Mbas vitit 1880, monarkitë fqinje, si Serbia, Mali i Zi dhe Greqia kërcënonin ekzistencën e shqiptarëve si komb, për të copëtuar trojet e tij të banuara nga shqiptarët. Pikërisht, Vehbi Dibra, duke qenë i ngarkuar me detyrën e Myftiut të Dibrës, i

fliste popullit se nderi i atdheut nuk mbrohet vetëm me lutje, por edhe me përpjekje dhe sakrificë.

Vehbi Dibra ishte për bashkimin e kombit shqiptar dhe ishte luftëtar i zjarrtë për hapjen e shkollës shqipe me alfabetin e Manastirit. Dhe pikërisht për këtë ai thirri Kongresin e Dibrës (Korrik 1909). Në këtë Kongres morën pjesë 36 delegatë nga të gjitha trevat e banuara nga shqiptarët si: nga Kosova, Ismail Pashaj, Riza Beu, Rexhep Hoxha Myftiu i Dibrës (vëllai i Vehbi Agollit), nga Elbasani ishin delegatë Aqif Pashë Elbasani, Dervish Beu, Myderriz Ali Efendiu etj. Fillimisht, Kongresi zgjodhi për kryetar të tij, Vehbi Dibrën dhe sekretar: Halit Gjirokastritin dhe Islam Selanikun. Vehbi Dibra mbajti një fjalim të zjarrtë teologjik e filozofik, falë kulturës së gjerë që kishte dhe si orator i mirëfilltë. Në historinë e Shqipërisë, Vëllimi i II, Tiranë 1984, fillon devijimi, që e konsideron këtë Kongres si xhonturk, gjë që nuk është e vërtetë dhe s’i përgjigjet realitetit! Këtë e bazojmë në diskutimet e delegatëve, si dhe në kujtimet e tyre të lëna me shkrim si, Hafiz Ali Korça, të Kenan Manastirliu etj., të cilët e hedhin poshtë këtë vlerësim që i bën Historia e Shqipërisë. Po t’i referohemi të vërtetës historike, tonin këtij Kongresi ia dhanë shqiptarët, siç pasqyrohet nga vendimet që mori: -Hapja e shkollave fillore dhe të mesme në gjuhën shqipe. -Ndarja

e shkollës nga kisha dhe xhamia. -Zhvillimi i ceremonive fetare në gjuhën shqipe. -Njohja e zakoneve nga pushteti në gjuhën shqipe dhe vendosja e rregullit dhe sistemit në ushtri.

Të gjashtë seancat e Kongresit u kthyen në përpjekje të ashpër dhe kjo u duk në fjalimet e Vehbi Dibrës dhe në fjalimet e një pjese nga delegatët si: Abdyl Ypi, Rexhat Voka, Haxhi Ali Elbasani etj.

Midis delegatëve për shpalljen e Pavarësisë (28 Nëntor 1912) u nisën në Vlorë, H. Vehbi Dibra bashkë me Hafiz Sherif Langun. I takon Vehbi Efendiut të nxjerrë fetvanë për shqiponjën e zezë dy krenare në mes fushës së kuqe të flamurit. Në kujdesin e Vlorës 28.XI.1912, ndër vendimet e rëndësishme, ishte edhe ai i krijimit të Senatit (Pleqësisë) prej 18 anëtarësh, Kryetar i së cilës u zgjodh Vehbi Dibra, kurse Ismail Qemali u zgjodh kryetar i qeverisë së përkohshme.

Vehbi Dibra për çdo veprim mbështeti Ismail Qemalin. Kur u nis në krye të delegacionit, Ismail Qemali, la në krye të Qeverisë së Përkohshme Vehbi Agollin (Dibrën), i cili nga data 30 mars 1913, për dy muaj rresht kryesoi qeverinë në mbledhjet e saj, madje përballoi lakmitë serbe e malazeze dhe organizoi kryengritje shqiptare në mbrojtje të trojeve, që udhëhiqeshin nga Bajram Curri, Elez Isufi, Hasan Prishtina etj. dhe se mbajtja e tërësisë tokësore

mund të bëhet vetëm me armë dhe se kryengritësit patën mbështetjen e qeverisë së përkohshme dhe veçanërisht të Vehbi Dibrës. Këtu le të ndalemi dhe të përmendim fjalët e N. Cirkoveç: “Kryengritjen pa ndonjë (fjalë e pakuptueshme) ka mundur ta përgatisë vetë Vehbi Efendiu, nën urdhrin e të cilit janë të gatshëm të ngrihen të gjithë të uriturit! Ai është dhe Shejhul Islami i Shqipërisë. Kryengritja u përhap nga muaji Shtator 1913, por mjerisht kish mungesa në municione dhe armë...” Serbët ushtronin terror të paparë. Në lumin Drin nuk shikoje gjë, përveç trupa të pajetë fëmijësh, grash e pleqsh si dhe hi.

Edith Durham këtë terror e përcakton në këtë mënyrë: “Fuqitë e Mëdha po kryejnë një veprim kriminal, duke e shtyrë ardhjen e komisionit të caktimit të kufijve”. Nga ana e tij, Vehbi Dibra e çmonte mjaft rendin, mungesa e të cilit – thoshte ai – sjell anarkinë dhe situata të papëlqyera me të cilat Shqipëria është ndeshur mjaft herë. Vlen të theksohet se pas vitit 1925, Vehbi Dibra i përkushtohet tërësisht punëve të Komunitetit Mysliman dhe u shkëput nga veprimtaria e drejtpërdrejtë politike, sido që deri në frymën e fundit ai pati për moto Fe – Atdhe, këtë binom.

Vehbi Dibra që në marsin e vitit 1920 i drejtohej zyrave të myftinive me një qarkore, tani e tutje të mos përdoren vulat dhe aktet zyrtare në

turqisht, por të mbaroni sa më parë një vulë me shqiponjë, duke futur kështu në institucionet fetare simbolin e flamurit tonë kombëtar.

Haxhi Vehbi Dibra u nda nga kjo jetë, kaloi në jetën e vërtetë, më 24 mars 1937, në moshën 70 vjeçare, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë shqiptare...¹

Në fjalën e Imzot Vissarionit, kryetar i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, mbajtur me rastin e ceremonisë mortore të Haxhi Vehbi Dibrës, shihet vlerësimi maksimal që i bën lideri ortodoks një lideri mysliman, duke e thënë edhe vetë, se mund të jetë ndoshta rasti i vetëm dhe unik në botë, sidomos për atë kohë, kur një kryepriift mban një ligjëratë në varrimin e një kryehoxhe:

“Haxhi Vehbiun e kam njoftun si një nga të parët Kryetarë Shpirtnuer, aj që i pari që u dha dorën të Krishterëve tue u thanë se e ndjekim, po besimin që na kanë lanë të parët, porse kudo, në jetën tonë, jemi vllazën të pandashëm. Unë sot po e thyej pengesën e mosmarrjeve pjesë, nga ana e jonë, në ceremoninë të tilla: na jemi vllazën. Myslimanizmi Shqiptar duhet të jetë krenar që pati në gjirin e vet burra si i ndjeri: uroj nga zemra që të vazhdojë të ketë të tillë. Aj po ju len juve, shokë të Klerit Mysliman, idealin e tij që po forcohet dita ditës: Haxhi Vehbiu

asht nga ata që i pjellë rrallë koha, Aj tashti prehet i sigurt se misioni i tij atdhetaro-fetar qindron ndër duer të mira si të juejat.

Haxhi Vehbi Efendi Dibra do të mbesi i pa harruem në Historinë e zhvillimit të Shqipnis së Re edhe në pikpamje tjetër: asht i pari Kryetar i fes Muhamedane në Shqipni i cili tue qenë prej origjinit të Shqipnis s’Epërme, respektohesh dhe simpathizohesh si prej Shqiptarve t’Jugut ma të largtë të Shqipnisë ashtu edhe prej atyne të Veriut ma t’epërmë si të Krishterë edhe Muhamedanë.

Kohnat, në të cilat jetojë dhe sundojë punët e fes Muhamedane në Shqipni, ishin kohnat e atyne sëmundjeve shoqnore që kalojnë të gjithë Kombet kur janë formue rishtas si shtet, dhe personalitetet e ndershëm ose prinjësit e Fes ndodhen në pozitë të vështirë shumë, pse fiset ose Bajraktarët e Kombit janë në përpjekjet e tyre me ba për vehte të parin e fesë për me realizue qëllimin e vet. Sa punë e vështirë, sa punë e madhe asht që të qëndrojë i pari i fesë i pa anshëm, por edhe që t’i bajë të gjithë ta nderojnë e ta duan por edhe të gjithë ta ndigjojnë! Lipset të pranojmë se duhet një diplomaci dhe politikë e fortë, një ideal ose dashuri Atdhetarije e madhe, që vetëm feja e ka ose e jep, me mujtë prinjësi i fesë t’jetë dhe të qëndrojë i patundun. Sa i nalt e sa i math ishte edhe në çdo rast prezantimi miku i Ynë i dashtun

1. Për më tepër shih: Xhelili, Qazim, “Vehbi Dibra, personalitet dhe veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare”, Tiranë, 1998.

Haxhi Vehbi Dibrall Kur ecte, kur bisedonte, kur qëndronte në mes të miqëve dhe misafirve i bante të gjithë pa ndryshim feje ta duan e ta respektojnë; nuk bani kurrë dimagogji as reklamë, por vetëm detyrën e tij Fetaro-Kombëtare si një Muhamedan i mirë, por edhe si një Shqiptarë i mirë, si një fillosof i zoti i punëve shoqnore; jo se ishte miku i jonë personal, por pse ishte edhe një njeri i tillë, edhe neve e pamë t'arsyeshme me mos u kërsoje por me kuxue dbe me çqetsue pak këtë mbëledhje të hirëshme me fjalë tona,

në këtë vend shumë të ndershtëm ku prehen eshtnat e të dashtunve t'onë vllazër në kombësi, sa do që për të parën herë ndofta jo vetëm në Shqipni por ndofta edhe në të gjithë botën, për të parën herë flet një Kryepriift Kristijan Orthodhoks në varrin e një Kryehoxhe Muhamedan Mysliman.”²

2. Zani i Naltë, “Flet Imzot Vissarioni”, nr. 4, prill 111-1937:109; Kruja, Genti, “Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfeitar”, Prizmi, Tiranë, 2006: 201-203.

Njeriu dhe Gjithsia II

Abstrakt

Njeriu ka kapacitet me gjyke e me arsyetue; pra është i lirë me zgjedhë e me veprue e për këtë shkak është përgjegjës për veprën e tij.

Fisnikërin e një krijese nuk e shkaktajnë cilsit e përbashkëta që e shoqërojnë me inferiorët e saja, por cilësia karakteristike që e dallon nga këta inferiorë. Njeriu pra me fuqin e arsytimit e të vullnetit të lirë ka një jetë të mbrendëshme, një jetë tejsbqisore që quhet “jeta njerzore”.

Në ka një të vërtetë të provueme edhe ajo është që “as gjá në botë s’është kot më kot, por ka një qëllim” është destinue për një qëllim të parapamë mbas një projektit eternel.

Të gjithë dijetarët kanë pranue një të vërtetë, por janë ndà më dysb: disa pretendojnë se “e vërteta është dhe njeriu vetëm e zbulon” e disa të tjerë thonë se “e vërteta s’është por e krijon njeriu me mendjen e tij”.

E kuptojnë lexuesit e ndershëm vetvetiut se sa të drejtë ka pjesa e parë e sa gabim ka pjesa e dytë, sepse në qoftë se nuk ka një të vërtetë atëherë edhe njeriu vetë është një gënjeshtër, një rrenë, një e pa vërtetë. E si bâhet pra, që një i pavërtetë, një rrenë, një gënjeshtër të mundet me krijue një të vërtetë. Këjo gjá është absurd dhe ato që janë në këtë mejtim kanë gabim.

Prandaj dalim në përfundim e themi se “e vërteta është dhe njeriu vetëm e zbulon”. Misioni i njeriut pra është vetëm “me zbulue të vërtetën që është e që ka qenë para se të dalë në shesh njeriu”.

Ndjeksit e rrugës së Hazreti Muhammedit besojnë plotësisht dhe s’kanë asnjë dyshim në Kur-an e në predikimet e Hazreti Muhammetit;

prandaj mundohen dhe përpiqen që t’i pajtojnë veprat, sjelljet dhe moralin e tyre me atë të Profetit të naltë dhe luftojnë çdo vepër ilegale që është kundër parimeve të nalta të

Profitit. Lufta kundra djallit është më e shenjtë luftë e muslimanit, i cili e din fort mirë se djalli shumë herë vepron edhe nëpër dorë të njerezve që i ka bërë miq.

Muslimani i sinqertë din me i dallue njerzit që janë miqsue me djallin e që i shërbejnë propagandës së tij të mallkueme. Prandaj ruhet tepër nga influenca e tyre dhe përpiket me e nxjerrë në shesh lakuriq propagandën e tyre.

Në kohët e fundit kanë marrë guxim të madh këta miq të djallit dhe janë verbue aqë tepër, sa që guxojnë me luftue edhe kundra Zotit edhe si për lavd i kanë vënë vetvehtes emnin *atheistë*.

Ne këtu nuk do të merremi me personalitetin e këtyre atheistëve, por do të shohim doktrinën e tyre për t'i kallzue elementit besnik të komunitetit musliman si edhe rinis shqiptare se doktrina atheiste është e gabueshme dhe nuk i afrohet të vërtetës e logjikës.

Pretendimet e atheistit dhe përgjigjet t'ona

- Zoti është një krijesë e mendes njerzore!

Gjegje - Jo! Zoti s'është krijesë e mendes njerzore, por Krijuesi i mendes njerzore, krijuësi i njerzís edhe Krijuesi i gjithësis.

Këtë doktrinë t'onë nuk e kanë predikue vetëm Profetët e Shenjtë, por edhe gjithë filosofët e naltë qysh në kohët e vjetra e derin në

kohët e soçme. Termat, me të cilat e shprehin këtë doktrinë filosofët, i kallzon historia e filosofis e ne këtu s'na lejon vendi që t'i riprodhojmë.

Atheistëve i u themi se, idhylli i tyre është krijesa e mendes së tyre e jo Zoti i vërtetë, i cili është, se po të mos ishte nuk do të ishte as atheist që predikon rrugën e djallit.

- Njeriu, sa më tepër të zhvillohet, aqë më pak e ndin nevojën e Zotit!

Gjegje - Këtë gjë e përgënjeshtrojnë faktet historike. Historia na tregon një qytetnim të shkelqyeshëm grek; por grekët jo që s'ishin atheistë por ishin politheistë edhe Sokratin monotheist e dënuën me vdekje. Platoni dhe Aristoteli kanë qenë gjeni të pakontestuëm, që edhe sot mbas kaqë mij vjetësh dominojnë në shumë pika mbi opinionin publik të elitës intelektuale. Pra këta gjeni kaqë të zhvilluëm intelektualisht kanë besue në Zotin krijuës.

Atheistët t'onë vallë a janë më të zhvilluëm se Sokrati, Platoni, Aristoteli, që jetuën në kohët e lashta edhe se Dekarti e Spinoza që jetuën në kohët e vona?

Ky fakt historik na dishmon se nevoja e Zotit është në natyrë të njeriut dhe nuk mund të zhduket me zhvillimin intelektual, por forcohet më tepër, kur arsyetimi është i parreshqitshëm.

- Përparimi i Shkencës do t'a thyjë autoritetin e institucioneve fetare?

Gjegje – E dijmë edhe ne se autoriteti i Shkencës do t'a thyjë autoritetin e institucioneve fetare të pathemelta por me të bashkë do t'a thyjë edhe autoritetin e Atheistit e atëherë do të triumfojë autoriteti i fés së vërtetë me institucionet e saj shkencore e logjike.

- Fuqija lëvizëse e motorëve s'është një dhuratë e fés, por rezultati i luftës që i u bâ asaj.

Gjegje - Davidi ka qenë Profit, ka qenë mbret, ka qenë edhe hekurpunuës, farkatar. Nuhi ka qenë Profit e me të bashkë ka qenë edhe kapedan anije, të cilën e pat ndërtue vetë... Këto fakte historike dishmojnë se fuqija lëvizëse e motorëve edhe në mos qoftë një dhuratë e fés, sigurisht nuk është as rezultati i luftës që i u bâ fés; por mund të jetë rezultati i luftës që i u ka bâ mentalitetit të gabuar të fanatizmit që është konsiderue fé.

- Një grusht baltë e marrun nga varri i martirëve të mendimit të lirë u bâ teleskop me të cilin shifen të gjitha thellësinat e qiellit, mbrenda të cilave nuk po duket Perëndija krijuëse e fetarëve primitivë.

Gjegje - Këjo shprehje poetike dhe alegorike po të analizohet s'ka asnjë kuptim; sepse edhe atheisti vetë që e shpreh këtë hiperbolë, nuk beson të gjindet një teleskop, me të cilin të shifen thellësinat e pasosuna të qiellit. Rajoni deri ku mbrin teleskopi më i madh, po të krahasohet me thellsinën kurë të pasosun të qiellit, mbetet zero. Po j'a lamë opinionit publik

që t'iu caktojë pozitën që meritojnë atheistët, të cilët t'armatosun me një zero kërkojnë me pushtue thellsinën e pambarueshme të qiellit!... Një trû kaqë i ulët nuk mund të formojë idé mbi krijuesin, të cilin kërkon me e gjetë në qiell, të ulun në një fron. Harron atheisti i shkretë se Zoti s'ka nevojë për vend, por është në ndërgjegjen e tij (t'atheistit), sadoqi ky s'e shef, pse e ka verbue materja.

- Shkenca po zavendëson të mbinatyrshmin.

Gjegje - Feja është dija e Zotit e shkenca është vepra e Zotit. Pra shkenca nuk mund t'a zâvendësojë të Mbinatyrshmin, por e provon edhe më mirë.

- Edhe fetari vet kur e zanë ethet merr barna e nuk lutet përpara altarit!

Gjegje - Fetari e din fare mirë se edhe bari që shëron është krijuë prej Zotit që të shërojë; prandaj për fetarin e vërtetë edhe bari shëruës është një fakt që dishmon të Mbinatyrshmin, i cili asgjâ s'ka krijuë kot por çdo gjâ e ka dhënë për dobí të njeriut. Si kinini, është edhe repat e sheqerit, gruni e çdo bimë tjetër del prej të njajtit brumë që e quejmë dhé, e me gjithë këtë kinini është helm i idhët, sheqeri është i ambël e gruni është i ushqyeshëm. Ç'është ky konfuzion i natyrës materjale që adhuron atheisti. Kurse natyra s'ka as mend as dije, as vullnet, si i rregullon të gjithë punët për dobí të njerzís? A e mendon ndonjë herë atheisti këtë çashtje?

- Vetëm Shkencëtari do të prodhojë kryeveprën t'imagjinatës njerzore dhe atëherë profiti dhe artisti do të mbeten të turpëruar.

Gjegje - As Shkencëtari vetë nuk e beson këtë triumf që j'a uron avukati i tij atheist. Shkencëtari e din fare mirë kompetencën e tij të varfër. Shkencëtari sod hala s'ka mundë me e njoftë identitetin të elektrikut as atë të magnetit; por flet vetëm mbi ligjët e tyne. Imagjinata njerzore hala s'ka mund me e caktue kryeveprën e saj e jo me e prodhue; sepse po t'a prodhojë këtë kryevepër atëherë merr fund misjoni i njeriut e kur të marrë fund ky mision ç'i mbetet njeriut!

Ne themi se është e pamundur që imagjinata njerzore t'a prodhojë kryeveprën e saj, si kur pretendon atheisti, i cili vetë në një pikë këtua më poshtë thotë se njeriu do t'a sundojë natyrën e me qenë se natyra apo gjithësia është e pasosun, që të sundohet këjo gjë e pasosun, duhet t'ja dijmë kufit; kurse njeriu si kur të ketë edhe jetë eternale e një mjet më të shpejt se elektrike e se drita e diellit, prapë se prapë nuk do të mundet me e shetitë vetë njëherë hapsirën pa-kufi, mbassi është e pasosun, pasosmenin e së cilës kujtojmë se e pranon edhe atheisti; se për ndryshe ky atheist i shkretë duhet të na diftojë se ç'ka m'at anë përtej hapsinës.

Kur se çashtja qendron kështu, të jetë i sigurtë atheisti se kurrë s'ka

me u turpëruar Profiti e Artisti, por ka me u turpëruar materialisti i gabuar me fuqin e shkurtun të trûvet të vet.

Një pikë na çudit këtu, se atheisti, që në pikën (23) thotë se mund të diskutojë, të këndojë dhe të admirojë shumë fjalë e vepra të themelonjësve gjenialë e superiorë të fëvet, në pikën (8) të cilës po i përgjigjemi në këto rrjeshta, thotë se do të turpërohet Profiti dhe Artisti.

Ne i themi këtij atheisti mendeshkurtë, se kur të vijë koha që të turpërohet Profit – që s'ka me u turpëruar kurrë – do t'a botojmë me germa të mëdha pikën (23) të atheistit e atëherë të shofim se kush ka me u turpëruar.

Sa për turpërimin e Artistit duhet t'i dalin zot vet artistët e soçëm edhe ata – mbrenda të cilëve jemi edhe ne – që admirojnë veprën e tyne dhe i u këndojnë lëvdata.

- Mekanizma është universale dhe sundon më të thellat kufi të shpirtit.

Gjegje – Papandehun i shkreti atheist e shembi me dorë të vet doktrinën e tij, mbassi absolutisht pranon qenëjen e Shpirtit. Tani duhet të na diftojë ky atheist i shkretë se shpirti që beson aj a është abstrakt apo konkret? Në qoftë se është abstrakt edhe mekanizma që e sundon atë duhet të jetë abstrakte; përndryshe duhet një fuqi e tretë që t'u sigurojë kontaktin.

Në qoftë se beson që shpirti është konkret atëherë duhet të na shkoqisi atheisti me trût e tij, për të cilët ka respekt.

- Jeta s'është e errët, sepse shkencëtarët kanë përgatitur farë artificiale që po të mbillet lishon degë e fletë.

Gjegje - Nuk e dijmë si do t'a bëjë ky shkencëtar i uruar me hudhrë, fjerin e bimë tjera që s'kanë farë!...

- Shkencëtarët prej materjes pa jetë prodhojnë celule të gjalla që lëvizin, ushqehen, ndahen dhe do të vijë dita që shkenca të fabrikojë njerëz gjeni e jo idiotë.

Gjegje - Këta Shkencëtarë që prej materjes pa jetë mundkan me prodhues celule të gjalla, pse nuk prodhojnë edhe materjen e vet, e cila kujtojmë se është punë më e lehtë për ta mbassi s'ka nevojë për gjallni. Këta shkencëtarë kanë të naltë që s'kanë nevojë për Zotin s'duhet të kenë nevojë edhe për materjen e Zotit, por le të krijojnë edhe materjen e vet që të jenë të sigurtë në punën e tyre, që kështu të mos mbeten ngushtë në qoftë se një ditë Zoti e tërheq materjen që ka krijuar vetë dhe i le me dorë thatë.

Edhe sikur të realizohet një sukses i këtillë, ne nuk i kundërshtojmë, pse e dijmë që njeriu është përfaqësuesi i Zotit e pra edhe vepra tij është vepra e Zotit.

Vetëm na mbetet t'a pyesim atheistin t'onë për një pikë: Si është e mundur që njeriu idiot do të mundet me fabrikuar njeri gjeni e si do të marrë fund lufta që do të pëlcasë midis tyre, kur sicili do të pretendojë

se është më i mençëm se shoku? Puna më e vështirë është se njeriu gjeni do të ketë të bëjë me një idiot që zemrohet shpejt dhe mund t'a masakrojë aty për aty. Do me thanë se Shkencëtarë i urtë që përpiqet me i bënë një të mirë njerëz është tue përgatitë me dorë të vet katastrofen e njerëz vetëm për të kenaqë egoizmin e atheizmit.

Ç'janë këta prralla more zotni?

- Njerëzit janë organizma të riprodhuara, pa vleftë e pa rëndësi përpara madhësisë së natyrës.

Gjegje - Vlefta dhe naltësia e njeriut nuk matet mes sasin e organizmave materjale të riprodhuara por me fuqinë intelektuale dhe shpirtnore të tij që i jep superioritet mbi natyrë.

- Kur të marrë mendja pozitën e gjykatsit suprem do të harohen Perënditë e vjetra.

Gjegje - Ku ka hy predikimi i Kur'anit janë harruar krejt Perënditë e vjetra dhe adhurohet vetëm Zoti Krijues, e, atje ku s'ka hy ky predikim jetojnë akoma Perënditë e vjetra dhe Perënditë e reja të atheizmit.

Në qoftë se do të marrë pozitën e gjykatsit suprem mendja e njeriut natyral do të dalë në shesh e vërteta; por po e zënë këtë pozitë mendja e gjeniut të fabrikuar, ç'do të bëhet halli i atheistit t'onë?

- Aktivitetet marrëdhënëse midis celuleve të gjalla që mvaren nga lëngjet koloidal prodhojnë jetën!

Gjegje - Përsëri atheisti na parashtron një send abstrakt,

aktivitetin! Aktiviteti e celulet a janë një gjâ a dy gjâna. Në qoftë se janë një gjâ, pse nuk thotë celulet prodhojnë jetën; në qoftë se aktiviteti është tjetër gjâ, atëherë le të na spiegotet ç'është dhe ku e gjeti shkencëtari që prodhoi celule të gjalla.

- Vdekja është ngrimja e langjeve colloidale!

Gjegje - Shkencëtari që din me fabrikue langje colloidale, pse nuk përpiket t'i shkrin këta langje të ngrimë që kështu t'a ngjallë, në mos tjetër, munde bare të dashurin e vet, nga vdekja e të cilit është pikëllue aqë tepër dhe palë sa lotët i ka derdhë.

- Në qoftë se ka ndonji gjâ të mshefët e të paspieguar në termat e forcavet fizike dhe kimike, ay fakt nuk na intereson dhe s'ka asndonji rëndësi, sepse këjo gjâ e msheftë mund të nulifikohet shumë lehtë nga forcat e shkencës.

Gjegje - Perëndija natyrën e sundon me anë të ligjëve që ka caktue vetë; pra edhe forcat e shkencës janë të natyrës; porse këta ligjë nuk kanë ndonji fuqi, në qoftë se nuk pajtojnë me vullnetin e amshuem të Zotit. Nuk duhet të shkojmë larg për këtë gjâ; mjafton të vizitojmë një teqe të sektit Rufai, ku kemi me pá se zjarri s'ka fuqi me djegë lëkurën e dersvishit. Ç'i thue kësaj ore atheisti! Prandaj duhet të pranojsh se edhe nulifikimi i gjâsë së msheftë me forcën e shkencës është një ligjë që ka caktue vetë Perëndija, vepra e të cilit është Shkenca.

- Mâ sa është e mundun që një e bardhë e vesë e zjerë të këtheth në cilësit e para aqë është e mundun për një kufomë të ngjallet.

Gjegje - Për atheistin me të vërtetë është gjâ e pamundun këjo punë, por për Perëndinë është gjâ fare e lehtë. Që të besohet se ka posibilitet të ngjallet një kufomë e vdekun duhet mâ para të besohet se ka një Perëndi që është i zoti me ngjallë, sikurse që i zoti mâ para me e krijue, Perëndija nuk pati vështirësi në krijimin e parë, tash që e ka modelin gati pse mos të mundet me e ringjallë?

Pula, që është një kafshë e ulët, nga ushqimi i pagjallë që han mundet me trajtue një vezë me celule të gjalla, si mund të pretendohet se Krijuesi i çdo gjâje, Perëndija s'mundka me ringjallë një kufomë të vdekme? Ketë guxim të gabueshëm e ka vetëm atheisti.

- Në qoftë se ka ndonji fuqi mistike të panjohur në punën e gjallëris, ajo fuqi as është e zonja t'a ndalojë vdekjen, as t'a çdukë!...

Gjegje - Në qoftë se nuk ka ringjallje mbas vdekjes, as ne nuk humbim gjâ, as atheisti nuk fiton gjâ; të dy lagjet hangrëm, pimë, jetuëm dhe vdiqëm. Por në qoftë se do të ringjallemi, si kur na kallzojnë Profitët ç'do të bâjë atheisti i shkretë me krënin e tij? Në qëlloftë rasti i parë asnjani s'fituëm, e në qëlloftë rasti i dytë, cili del i fituar?

- Duhet çdukur emosjoni i vdekjes që u çel rrugë fetarëve për një

antiklimaks (rrojtje e shpirtit edhe mbas vdekjes).

Gjegje - Çduke po munde emosjonin (frikën, telashin) e vdekjes; por kurrë s'do të mundesh me e çdukë, se e ke në natyrën t'ande; t'a ndin ndërgjegjia e jote se do të thirresh me dhanë llogarën e veprave të tua; prandaj të këshillojmë t'i rrëgullojsh veprat e sjelljet e tua si mbas porosis së fës; se ke për t'u pendue një ditë, por do të jetë vonë!...

- Pse shpresojmë nuk do me thanë se është e sigurtë jeta mbas vdekjes.

Gjegje - Jeta mbas vdekjes është e sigurtë për arsyet që parashtrojmë në pikën (19) e pse na kanë lajmëruar Profitët e ndershëm e jo pse shpresojmë si kujton ateisti.

Nuk është e sigurtë jeta mbas vdekjes pse shpresojmë ne, por se është e sigurtë jeta mbas vdekjes, ne shpresojmë. Jetën mbas vdekjes na e provon Kur-ani. Ateisti flet në t'errët dhe s'ka asnjë fakt që të provojë mohimin e tij.

- Njeriu nuk rron pse shpreson, por pse në celulet e tij ndin një qejf, një kënaqësi një gëzim kur është i gjallë.

Gjegje - Kur qenka çashtja kështu përse idealisti sakrifikon jetën?

Nga kjo frazë merret vesht se ateisti deri sa të ndijë në vetvehte një qejf, një kënaqësi, një gëzim për jetën e kësaj bote nuk mund të vdesë për Atdheun e Shtrenjtë. Atëherë pra Shteti që mbështet shpresën në

ushtarë atheistë qenka në dërrasë të kalbur.

Sepse ata vetë po e thonë se deri sa të ndijnë në vehten e tyre qejf, gëzim e kënaqësi për jetë nuk mund të vdesin.

Fetari vdes për atdhë se bije dëshmor e si shpërblim të sakrificës që bën gëzon lumtëri të pasosuna e të paspieguëshme me gjuhën e kësaj bote.

Pra le t'a gjykojë opinioni publik se kush është rrezik për atdhë, feja apo ateizma?

- Ka ardhë kohë që edhe në gjuhë Shqipe të thohet se organizimet fetare, me gjithë supersticionet e tyre, me sistemet e tyre filosofike e fiskale janë anakroniste dhe nuk i përgjigjen më kohëve.

Gjegje - Ndofta ka fé që, si organizimet fetare është edhe sistemet filosofike t'i kenë anakroniste; por këjo nuk do me thanë se të gjithë fét janë një. Sa për fé'n islame ateisti duhet të studiojë Kur-anin e në qoftë se s'e kupton duhet të pyesë kompetentët dhe nuk duhet t'a luftojë një fé pa ja ditur bazën.

Në qoftë se organizimet fetare nuk i përgjigjen më kohëve, duhet të na këshillojnë mënyrën e përmirsimit, me qenë se organizimi i ynë nuk është fiskal e dogmatik, por administrativ edhe pranon ndryshime po të gjindet një sistem më i mirë.

- Mund të diskutoj, të këndoj dhe të admiroj shumë fjalë e vepra të

themelonjësve gjenialë e superiorë të févet, por urrej spekulatorët dhe degeneronjësit e sotëm.

Gjegje - Këtu atheisti gënjen, se me një anë i pranon themelonjësit e févet për gjenin e superiorë edhe admiron shumë fjalë e vepra të tyre e më anë tjetër mohon Zotin Krijues që kanë predikue të tănë me një gojë këto Profitë të naltë, Zot, për të cilin shumë Profitë sakrifikuën edhe jetën.

- Organizimet fetare, format e tyre, methodat e tyre, mësimet e tyre nuk u përgjigjen kohëve, origjinën e kanë te fantazija e dobët e njeriut primitiv, janë të damshme dhe të rrezikëshme.

Gjegje - Opinioni publik le t'a çmojë vlerën intelektuale të këtij atheisti që në këtë frazë thotë se mësimet fetare e kanë origjinën te fantazija e njeriut primitiv, kurse në pikën (23) pranon gjenialitetin dhe superioritetin e themelonjësve të févet e shumë fjalë e vepra të tyre i admiron.

Profitët e ndershëm ose kanë qenë gjenin superiorë ose njerës primitiv me fantazi të dobët; sepse që të dyja këta cilësi nuk mund të bashkohen në një person. Prandaj edhe gjykimi i atheistit mbi damin e rrezikun e fës është i gabueshëm.

- Qytetërimi i shoqëmi i detyrohet luftës që iu bënë feve.

Gjegje - Qytetërimi i shoqëmi nuk i detyrohet luftës që iu bënë feve, por i detyrohet luftës që feja e vërtetë iu bënë fevet pagane edhe ateizmit

edhe shpërdoruesve të feve. Asnjë forcë barbare s'ka mundur me shtypë ndergjegjen fetare, sado që është përpjekje me e zhdukë lirin e kësaj ndergjegjeje. Nuk mund të meritojë me u quajtur qytetërim një forcë që prek në lirin e ndergjegjes.

- Premisa arbitrare "që bota është kurdisur dhe ikën mbas një koncepti të një fuqije të mbinatyrshme" nuk mund të pranohet aspak prej asnjë njeriu që ka pak respekt për trutin e vetë.

Gjegje - Shumë fjalë me vend kërkojnë që thotë atheisti. Me të vërtetë ata që kanë respekt për trutin e vetë dhe kujtojnë se vetë materia e trunit është mendë, nuk kanë si e pranojnë që bota është kurdisur dhe ikën mbas një koncepti të mbinatyrshëm. Porse ata që e kanë njoftë vetveten dhe e kanë çmuar se truni nuk është vetë mendja, por sheshi ku mendja ushtron kompetencën e saj, as pasqyra ku mendja eprë dritë, e besojnë pa vështirësi këtë gjë; pse e shohin me sy projektin etern të këtij fakti. Edhe atheiste vetë e din fare mirë se automobili pa shofer nuk mund të bëjë asnjë hap; prandaj me pretendimin e tij të thatë veçse gabon veten, se fuqinë që ushtron i mbinatyrshmi në natyrë nuk mund t'a ç'dukë fjalë e thatë e atheistit.

- Njeriu si çdo gjë e gjallë tjetër në faqe të këtij dheu, është përmirsimi i një forme më të ulët qenëjeje.

Gjegje - Mjekësia që dita me ditë vjenë tue gjurmue më tepër

trajtimin fizjologjik të njeriut, s'ka mundë deri sod me u kënaqë nga teorija e Davinit; prandaj ka qenë e shtrënguëme me pranue theorinë biblike të Adamit.

Për ne qi njofim një Krijues të Minatyrshëm, teorikisht ka posibilitet qi krijimi i njeriut të rrjedhë si mbas theoris së Darvinit, sikurse thotë atheisti; pse Krijuesi ka pushtet të madh, din e mundet me veprue si mbas çdo sistemi qi dëshron vetë.

Por për atheistin teorija e Darvinit është imposibël. Sepse natyra pa mend, pa vullnet e pa parapamje duhet t'a vijonte veprën e saj qi e rregulloi papandehun. Mjerisht, për fat të keq të atheistit nuk shifet mâ sod qi natyra t'a përmirësojë një formë mâ të ulët qenëjeje dhe t'a plotësojë e t'i japë formën njeri. Pse vallë e harroi natyra mjeshttrin e saj, apo edhe ajo e urren atheistin dhe don t'a turpërojë.

- Edhe njerzit e mëdhej të Carlyle-it nuk janë lajmtarë të qiellit, por njerëz mâ të zgjuar, mâ të zhvilluar nga shokët qi kanë ditur ose me violencë ose me magjira të ndryshme si mbas kohës të vihen në krye të një turme dhe t'a dominojnë!

Gjegje - Ateisti me këtë frazë vret vetvehten, si me thanë, me armë të vet. Sepse tue qenë atheist e materjalist pranon magjin qi s'hyn n'asnjë thes të materjalizmit. Kjo frazë dishmon se atheisti s'ka parim e princip, por flet kot më kot. Nuk kemi pra si ndjekim porosin e

atheistit, i cili më një anë ka pranue për mistikë "arsyetimin objektiv" e m'an tjetër beson magjin e njerëzve të mëdhej të Carlyle-it, sado qi të gjithë këta njerëz të mëdhej të Carlyle-it kanë qenë kundërshtatë të magjis.

- Problemi i përrjetshëm i njerëzve është "me sundue natyrën".

Gjegje - Edhe Islami këtë qëllim ka; prandaj nuk i ep vlerë e rëndësi natyrës, por kërkon t'a sundojë, t'a shtypë, qi t'a ketë të bindun për t'a përdorë është si dëshiron vetë. Veçse Islami këtë gjë nuk e pret nga rruga e atheistit, se e shef qi ajo rrugë është pa krye. Kjo rrugë, rruga me sundue natyrën, Islamit i është përgatitë me instruksionet e Kur'anit. Rruga e materjalizmit e bân njerin skllavin e natyrës, të materjes.

- Ekzaltimet e botë shpirtnore, hyjnizimet, adhurimet e verbta, mistika e paarsyetuar, dishmojnë se jemi akoma në a-b-c-ën e qytetërimit të vërtetë.

Gjegje - Ekzaltimet e botës shpirtnore, hyjnizime, si mbas fës Islame, kanë për qëllim me edukue vetvehten, me i vû frë ambicjes e me shtypë egoizmin. Njeriu qi e ka edukue ndergjegjen si mbas këtij sistemi nuk pajton aspak me qytetrimin e atheistit e të masonit qi nxjerr në shesh Skandale Staviskore e sisteme komuniste qi thithin pa mëshirë djersën e popullit të shkretë e të pafajshëm.

Në qoftë se ky popull do të pajoset me edukatën dhe me moralin

e Profitit të Madh dhe do t'i shtrohet urdhnit të të Mbinatyrshmit, të jetë i sigurtë atheisti mason e komunist se shumë shpejt do t'ja mbrimë ditës qi të çduket edhe a-b-c-eja e qytetnimit falso qi ka adoptue aj.

- Bota qi ka një qytetërim mendor të shëndoshë dhe të natyrshëm ka vetëm një mistik: arsyetimin objektiv, llogarín e qëruar, përfundimin e logjikshëm dhe natyral.

Gjegje - Në qoftë se atheisti e quën vetvehten e shokët e tij “botë me qytetrim mendor të shëndoshë dhe të natyrshëm” e pohojmë edhe ne se mistika e tij është vetëm arsyetimi objektiv dhe jo llogarija e qëruar dhe përfundimi i logjikshëm e natyral qi j'a mbështet vehtes e shoqëris dhe e monopolizon.

“Llogarija e qëruar, përfundimi logjik dhe natyral edhe arsyetimi subjektiv e objektiv bashkë” janë mistika e botës qi me të vërtetë ka një qytetërim mendor të shëndoshë e natyral. Porse në këtë botë s'ka aspak pjesë atheisti me shoqërin e tij, për arsye qi provuam më sipër. Llogarija e qëruar dhe përfundimi logjik e natyral nuk rrjedh nga një trû, gjykimet e të cilit kundërshtojnë midis tyre, mbassi bota e kësaj dore nuk kanë qytetërim mendor të shëndoshë natyral, por një të ashtuquajtur qytetërim falso dhe passionall.

- Të gjitha dogmatizmat e së shkuarës, të gjitha mithologjit, qi nga njeriu primitiv qi e përfytyronte perëndinë si një viç e gjer ke njeriu

modern qi e kupton si shpirtë të kulluar, janë Opium i Popujve.

Gjegje - Dogmatizmat e njeriut modern qi e kupton Perëndin si Shpirtë, nuk janë Opium i Popujve, Opium i atyne atheisteve demagogë qi kërkojnë me monopolizim pozitën e elitës intelektuale, nën maskën e së cilës të ushtrojnë djallzin e klikës së tyne.

Rezultati

Nga sa spieguëm derikëtú, merret vesht se atheistët e materjalistët nuk janë të arsyeshëm në gjykimet e tyne edhe luftojnë kot me fé, të cilën e kanë keqkuptue.

Qi të evitohet rreziku i këtij keqkuptimi po shënojmë këtu poshtë shkurtaz bazën e fés Islame:

- Me besue Perendin e Amshuëm, në mënyrë qi e spieguëm sipër.

- Me besue ringjalljen për t'i dhënë Perëndis llogarin e veprave t'ona.

- Me besue dërgatën profetike.

- Me besue Kur-anin e naltë.

- Me besue Engjëllit.

Mbassi t'i kemi besue këta duhet të edukojmë vetvehten si mbas etikës fetare qi na njofton Kur-ani.

Njerzit e dijes e të mendes e kuptojnë të vërtetën.

Detyra e jonë është t'a shpallim të vërtetën e të lutemi qi Perëndija t'i drejtojë edhe ata qi s'e kuptojnë.¹

1. Marrë nga revista “Zani i Naltë”, nr. 13-14, viti 9, shtator-tetor 1934, f. 406-440.

Abstracts in English

Editorial

1. The Muslim community of Albania, 100 years in the light of historical evidence

H. Bujar Spahiu

The independence of the Muslim Community of Albania is among the most important national acts, after the independence of Albania. The Muslim clergy, in general, but also prominent scholars and imams, have their decisive role in the Independence of Albania. In this regard, they did not stop only with the independence of the country, but, on February 24, 1923, they started the irreversible path for the independence of the Muslim Community.

Islamic Sciences

2. The Qur'anic golden mean cure of extremism

Prof. dr. hfz. Hajredin Hoxha

The Qur'anic and prophetic texts have elaborated in different forms and ways the issue of embracing and practicing the principle of "golden mean" and its manifestations in the Qur'an and Sunnah. The ummah unanimously affirms the obligation to maintain moderation in religious matters. A group of people, believing they were doing the right thing, went astray and lost because of deviating from the 'golden mean' and clinging to it.

Islam, our religion, is a religion of peace and security; it is a religion of life, a religion of development and culture. This religion has come for the benefit of people in this world and the next world, and Islam is not a religion of death, killing, destruction, fear and worry. This is the secret of Islam in its fight against radicalism and extremism with different means and methodologies. Based on this historical truth, Islam invites us to return

to the golden mean, to prudence, to return to the essential bases for us, the Qur'an and the Sunnah, so that we can take the healing medicine right there, and thus realize ideological unity, social and religious of the ummah.

Competent scholars of this ummah, past and present, have unanimously concluded that the objectives of the legislation of our religion are set to preserve human life and the things on which it depends. These objectives are: preservation of religion, being (body), mind, honor and wealth, and as such they are sacred, therefore no one has the right to violate their sanctity. In the dictionary of great scholars, these five objectives are known as "the five indispensable things (ed-darurat al hams or al kul-lijjat al hams.)"

This study tries to find the answer to the following questions:

- 1. What is the position of moderation and prudence in Islam?*
- 2. What are the manifestations of the golden mean Qur'an and Sunnah?*
- 3. What do the Quranic and prophetic texts tell us about the golden mean?*
- 4. What consequences can the individual and society face in the event of the eventual disregard of the principle of moderation and prudence?*
- 5. How to get out of the crisis of extremism?*

Since childhood is the first stage in human life, the Islamic religion takes great care of it and pays great attention to it. Islam is the first to deal with children's rights since the Middle Ages and predates modern times by more than fifteen centuries. This is due to the fact that children are the future and the hope of tomorrow. Islam has laid down a comprehensive constitution for the rights of the child, which contains his rights before his birth, when he is an embryo, and thereafter at the various stages of his childhood. Islam considers as a child the one who has not reached puberty (the age of maturity) and this does not exceed the age of fifteen.

Qur'an and Science

3. Al-Qurtubi – the well-known Andalusian Mufessir Kurra hfz. doc. dr. Xhevad Shoshiq

The well-known scholar of Andalusia, Abu Abdullah Muhammed b. Ahmed al-Qurtubi, the follower of the Maliki legal school, has made a well-known contribution to the development of various Islamic sciences, especially the development of Qur'anic commentary. His work "Al-Jami'u li 'abkamil-Qur'an", written in more than twenty volumes, is considered one of the most valuable achievements of tafsir. It deals with not only the normative aspect of the Qur'an (fiqh), but also other aspects of the engagement of the Qur'anic text, such as: linguistics, stylistics, semantics, qira'et, hadith, etc. In addition to

Tafsir, Qurtubi also wrote other works, of which the most famous work is "At-Tedbkire bi 'abuali'l-meuta wa 'umuri'l-'abire."

Studies

4. 100 years since the establishment of the Muslim Community of Albania

Dorian Demetja

The declaration of independence found the Albanian Muslim leaders and scholars at the head of the historical moments of our country and it was precisely these leaders who would unify the Islamic institutions in our country through the development of several national congresses. Thus, the Muslim Community of Albania was founded by revivalists and signatories of independence, as a community that would represent the voice of Muslim believers in Albania, the Albanian lands, and even, in many cases, the voice of all Albanians.

In order to have a more accurate picture of the religious relations between Albania and the Ottoman Caliphate, and especially about the process of independence of the Albanian mosque, it is necessary to take a retrospective look, because this process actually started much earlier from the first congress of the Muslims.

The one that marked the starting point towards the institutionalization of the Islamic Community, was the First Congress held on February 24 to March 12, 1923, which also laid the foundations for the formation of the Muslim Community of Albania. Since that time, Albanian Muslim believers would be represented by themselves and would be responsible for the spread and preservation of the beautiful tradition of the Islamic faith.

Social sciences

5. Elderly people - The importance of participation in social systems - addressed from the point of view of social work

Skender Mustafi, Bsc. Social Works

In this paper, will be discussed the importance of being part of social systems for the elderly. The paper leaves aside the other dimensions of the life spaces of this social group. In this research, the situation of elderly people has been treated only from the point of view of social work. This topic will be elaborated by approaching the consequences of non-participation in social systems and the causes that may lead to non-participation. The purpose of this work is to make a kind of professional encouragement of constructive and productive thinking about the condition of the elderly, a dimension that is completely ignored

and not treated professionally in our society.

Elderly persons in this paper will also be known by the term 'elderly', a term which I consider synonymous with 'elderly persons'. In the everyday vocabulary for this group of people, 'elderly people' is also used, which I estimate to be an unfair and not comprehensive identification for the condition of this social group. At the same time, the term 'elderly' in this paper includes the female gender, since the paper is dedicated to all elderly people.

The research addresses the current streams of thinking about this social group, the factors that influence the level of participation in social systems, the consequences of non-participation in systems and, finally, the paper suggests some of the ways of mitigating the degree of loneliness and the intensity of non-participation in social developments.

6. Children and their rights

Mr. sc. Bahri Curri

The family is the nucleus of society and its success is the success of society. In addition, children are the fruit of the family, and the hope for the future of the family and the entire nation.

Of course, having children is a priceless gift from God to man, an honor and privilege that makes you feel happy, but it is also a burden and responsibility that requires extra care.

Both girls and boys are priceless assets who, without distinction, are important and have their own vital rights. Although among Albanians, but not only, there is their desire and tendency towards boys rather than girls, this is abhorrent in Islam and this is also condemned by the Qur'an, telling us the bad practice of people before Islam, so in the time of ignorance, when the girl was deprived of all rights, often even the right to life.

Jurisprudence

7. The legal development of the right of ownership of Religious Institutions in Albania

Prof. asc. dr. Saimir Shatku, Faculty of Law, University of Tirana

The property constitutes one of the oldest rights, born together with humanity, which consists in the right of the individual to freely enjoy and dispose of things, within the limits determined by civil law and divine jurisdiction.

The property right of religious communities represents one of the most important legal institutes of real property rights, in general, and also constitutes the main form of exercising human rights over things, turning into the catalyst of all economic development of a country.

Throughout the years of the dictatorship, the coexistence of the regime with features of capitalism and socialism was observed, where the latter would triumph in 1976 with

the adoption of the new Constitution, in which the disappearance of private property was sanctioned. With this constitution, the domain of property and real rights related to it was completely eliminated, and the individual was stripped of any right to property, as it was needed for the political "general interest" of the country, thereby violating, in this way, directly exercising the individual's free right to private property.

The balance of wealth and property loss was extremely large, where about 1 million square meters of the Islamic Community was misused and violated, while the rest was divided and degraded; and as a result, despite the existence of various agreements with the state, the process of restitution and compensation of the properties of religious communities has encountered many difficulties and obstacles.

Translations

8. The life of Abu Mansur Al-Maturidi and the socio-political and theological context in Central Asia in the tenth century - II - Dr. Aref Chaker

Abu Mansur al-Maturidi is one of the most influential theologians in the Muslim World. He emerged in the tenth century in Central Asia and established his own theological school, alMaturidiyyah; a school that played and continues to play a pivotal role in the formation of the Sunni synthetic theological movement in the Muslim world. A review of the studies undertaken concerning al-Maturidi demonstrates the influence of the socio-political and theological context of Central Asia on al-Maturidi has not been studied, examined or analysed. This paper focuses on studying this overlooked aspect in Sunni theology. It evaluates the existence of any influence of the social, political, cultural and religious factors on al-Maturidi's works and his academic identity. It examines the nature of these influences, positive or negative, by undertaking a qualitative content analysis of all biographical, historical and geographical literature relevant to al-Maturidi and Central Asia. The study uncovered the strong influence these factors had on al-Maturidi. These influences were all positive in many of his writings. More importantly, these factors helped shape the synthetic theological paradigm al-Maturidi adopted in much of his literature.

Personality

9. Hajji Vehbi Dibra (Agolli)

The entire work of Vehbi Efendi remains like a mountain in the field of our theological knowledge and culture. Unforgettable and inspiring, his high and human qualities always remain in front of us: simplicity, honesty, spiritual nobility, love for innovation and for young

people, whom he encouraged to light a fire if they had a spark.

In Vebbi Dibra were embedded in the most comprehensive organic way the deep convictions of a theologian and an Islamic philosopher, which in any case, according to the principles of the holy Quran, are in complete accordance with the principles of the patriotic worldview. The clerical and patriotic activity of Vebbi Dibra are compatible with each other and have developed parallelly in the same direction, what indicates that being a cleric is not inconsistent with being a patriot, rather it served better and fully to the national issue.

Retrospective

10- Man and the Universe - II -

Man has the capacity to judge and reason; that is, he is free to choose and act, and therefore he is responsible for his actions.

The nobility of a creature is not caused by the common qualities that associate it with its inferiors, but by the characteristic qualities that distinguish it from these inferiors. Man, with the power of reasoning and free will, has an inner life, a transcendental life, which is called human life.

If there is a proven truth, it is that nothing in the world is in vain, but has a purpose, is destined for a predetermined purpose, according to an eternal design.

All scholars have accepted one truth, but they are divided into two parts: some claim that the truth exists and man only discovers it, and some others say that the truth does not exist but man creates it with his mind.

Honest readers automatically understand how right the first part is and how wrong the second part is, because if there is no truth then the person himself is a lie, an untruth. Then how is it that an untruth, a lie, can create a truth? This is something absurd and those who are of this opinion are wrong.

Therefore, we reach the conclusion and say that the truth is and man only discovers it. Man's mission is therefore only to discover the truth that is, and that was before man came to life.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.

